MILAZIM KRASNIQI

FOTOGRAFITË E KUJTIMEVE
roman

MILAZIM KRASNIQI

FOTOGRAFITË E KUJTIMEVE
Botim i dytë

---

Copyright © 2003
Të gjitha të drejtat e botimit, të ribotimit apo të përkthimit i mban ekskluzivisht autori
---------------

MILAZIM KRASNIQI
FOTOGRAFITË E KUJTIMEVE
roman

---

Kosova Online Botime Shqiptare per Shqiptaret qe flasin dhe mendojne SHQIP

# I

Mjaftoi një telefonatë e Ismetit, megjithëse e ardhur si nga fundi i botës, dhe unë të nesërmen e hyrjes së trupave të KFOR-it në kryeqytet, u ndodha në terren si përkthyes i një ekipi të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, të cilët ishin në mision të vëzhgimit të gjendjes së shtëpive para se të ktheheshin banorët e dëbuar gjatë luftës.

Është e pabesueshme se çfarë parandjenje pata atë paradite, para se telefonata e Ismetit të rilidhte fijet e jetës sime me botën. M'u ngulit në mendje se nga çasti në çast dikush do të vinte në shtëpi e do të më jepte një kumt të pazakonshëm. Figura që vinte të më jepte kumtin ishte e mjegullt, një si kokë njeriu, e parruar, me vetulla të gjelbëra, me një mjekër të bardhë e me disa vrima të frikshme në vend të gojës e të hundës. Atë kokë e lëvizte një karrocë invalidësh, e errët dhe me disa tela që nxirrnin shkëndija e përcëllonin. Lëvizja shoqërohej nga një zhurmë e nëndheshme, nga ciatje macesh e qensh dhe nga zëra të panjohur, që më fusnin tmerr.

Kishte disa ditë që po më ngushtohej hapësira dhe po më merrej fryma nga një përzierje inatçore e përfytyrimeve dhe ëndrrave, e kujtimeve dhe e frikës. Figura që vinte për të më dhënë kumtin, sado e frikshme, ishte e vetmja gjë që më mbante me një shpresë se do të shpëtoja gjallë. Shikoja tinëz nëpër dritaren që binte nga rruga, po asgjë nuk pipëtinte.

Unë ende nuk e dija se lufta kishte përfunduar, por zemra ma ndiente se një ndryshim po ndodhte.

Plot tre muaj ndenja i fshehur në bodrumin e shtëpisë. U mësova të jetoja ashtu, as zgjuar as fjetur, as i gjallë as i vdekur. U mësova, si kurrënjherë në jetën time, me veten, edhe pse ky zbulim i jashtëzakonshëm nuk më jepte mundësi që të kënaqesha me të. Në atë shtjellë midis realitetit e ëndrrës, midis jetës e vdekjes, zbuloja një dashuri të fuqishme për veten time, për jetën. Në çastet e turbullta të pikëllimit, në thellësinë e errësirës ngulfatëse, në të ftohtit që më mpinte gjymtyrët, unë ndieja pulsin e dashurisë për veten, si të ishte një rrymim i ngrohtë ajri. Zbuloja me habi se në vitet e kaluara, gjithnjë i rrëmbyer pas studimit e pas punëve, pothuajse asnjëherë nuk kisha menduar për veten time. Vitet e studimeve kishin qenë vite për të njohur të tjerët dhe për të nxënë dije. Gjithçka kishte pasur rrjedhë gati mekanike: ligjërata e ushtrime, afate të provimeve, ecejaket nëpër korridoret e gjata të fakultetit, dashuritë kalimtare dhe prapë e prapë ligjërata, ushtrime, konsultime dhe pritje para kabineteve të profesorëve. Pas mbarimit të shkollës pasuan vitet e ngarkuara me punën e mërzitshme në zyrë, me nëpunës të mërrolur, të cilët gjithnjë më dukeshin si personazhe të Çehovit. Dhe gjithë ato udhëtime në fundjavë për në Mitrovicë, për të vizituar prindërit. Tërë jeta më ka shkuar si të isha një servis që u ofron njerëzve shërbimet e veta, pa pasur kohë të merret me veten. Dhe përnjëherë, në fatkeqësinë më të madhe, kur mbeta fillikat, në bodrumin e errët,

bëra zbulimin më të madh të jetës: zbulimin e unit tim dhe të dëshirës për ta shpëtuar atë unitet të zbuluar të shpirtit e të trupit tim. Ishin puqur e bërë krejt harmonik, gjë që edhe ishte vendimtare për të mbijetuar në atë hata. I armatosur me atë zbulim fantastik, imagjinoja shpëtimin në lloj-lloj variantesh. Kur binte nata (kjo merrej vesh lehtë, sepse fillonin të godisnin bombat në ndonjë pjesë të kryeqytetit ose në rrethinat e tij), një kohë të gjatë lutesha. Pëshpërisja ato lutje që m'i kishte mësuar nëna në fëmijëri dhe të cilat në ato ditë të vështira ishin rishfaqur në mendjen time, pas një harrese të gjatë. Ato lutje ishin arma më e fortë që kisha. Lutjet më trimëronin më shumë se shpërthimet e raketave që trondisnin qytetin, teksa qëllonin mbi objektet ushtarake të armikut. Lutjet i shoqëroja me një lëvizje ritmike të trupit, e cila e forconte frymëzimin më të thellë shpirtëror. Ndieja se si ma përthekonte trupin një qetësi dhe një këndellje e lehtë.

Pas dorëzimit në valët e atij frymëzimi për një kohë të pacaktuar, mbuloja kokën me një rrobë të trashë dimri dhe përpiqesha të flija. Dhe, gjumi më merrte. Po gjumi më dilte shpesh nga gjëmimet e mëdha që më dukej se po e shkulnin edhe shtëpinë me rrënjë e po e përplasnin kushedi se ku. Dhe, sërish ulesha në gjunj dhe pëshpërisja disa lutje, që ma qetësonin shpirtin sërish. Në ato ditë të vështira, kur më dukej se vdekja çmbështillte thimthat e saj nëpër errësirë, ishte e mrekullueshme se si lutjet m'u kthjelluan në kujtesë, krejt të freskëta e me të njëjtin ritëm melodik e qetësues. Nuk më mbanin mëri për

harresën që u kisha bërë. Më dukej se edhe ato ishin të gëzuara e të lumtura që po më qetësonin e më mbushnin me shpresë se do t'i shpëtoja vdekjes. Sa e sa herë kam ndjerë një mirënjohje nga thellësia e shpirtit për nënën time, e cila m'i pati mësuar lutjet në fëmijëri, një nga një dhe me një vullnet të jashtëzakonshëm. As që guxoja ta merrja me mend se çfarë do të bëja në atë bodrum të errët, krejt i vetmuar, duke u fshehur nga sytë e vrasësve, po të mos i dija ato lutje. Në atë rast, vetmia ime do të ishte e pashpresë. Mendimi nuk do të mund të përqendrohej në kujtimet e së shkuarës, në ëndërrimet për një trup femre apo për përparim në karrierë. Me dorën e saj shkatërrimtare, si të një tufani, lufta e kishte shkatërruar shtratin e atyre ëndërrimeve dhe iluzioneve. Kishte mbetur vetëm mundësia e ruajtjes së mendjes së kthjellët dhe e shpëtimit nga syri i gjuetarëve të vdekjes, të cilët ditë e natë e përshkonin lagjen duke u hakërryer si bisha. Ndoshta as që do të mund ta përballoja presionin e frikës, i mbërthyer në darët e përfytyrimit të momentit të takimit me ata gjuetarë të vdekjes. Dhe do të dilja nga strofulla ime e në atë rast do të më përlanin plumbat ose thikat e tyre.

Orë e çast bëja përpjekje të mendoja për të afërmit. Nuk e dija as ku ishin tretur as në ishin gjallë. Me gjithë përpjekjet e mëdha që bënte truri im, fotografia e tyre më fshihej shpejt nga kujtesa, si një film i pazhvilluar kur i ekspozohet dritës së fortë. Shfaqej ndonjë sy që sakaq shndërrohej në tytë automatiku ose një gojë që shndërrohej në flakë. Balli i ndonjërit prej tyre sa ravijëzohej, shfytyrohej

në pamjen e frikshme të ndonjë filmi të parë kushedi se kur. Fytyra e plotë e nënës a e babës, e ndonjërit prej vëllezërve ose e motrës së vetme, nuk krijohej kurrsesi. Vetëm kur përsërisja disa lutje me plot afsh shpirtëror, fotografitë e tyre më kthjelloheshin e i njihja të gjithë me radhë, edhe me rrudhat rreth syve e ballit.

Vetëm koha më ishte ngatërruar në mënyrë të pakorrigjueshme. Ditët e para u tregova i pakujdesshëm për numërimin e ditëve, e pastaj ishte bërë një ngatërrim i përhershëm i datave e i ditëve. E dija se më 25 mars ishte fillimi i fshehjes sime në bodrum, po pastaj a ishte pasojë e gjumit të çrregullt, apo thjesht një ngatërrim, nuk e mora vesh. Kur hyri maji, e vërejta nga ajri më i rëndë në bodrum, por se cila ditë ishte, kjo ishte e pamundur ta dija. Mirëpo, dalëngadalë u mësova me atë matje kohe pa data e pa ditë. Koha ishte një fushë e gjerë e ndarë me kufij të hollë, të cilët nuk pengonin të shihja një fushë të gjerë dhe unike. Nga një lutje, kuptimin e së cilës e dija edhe shqip, e dija se çfarë rëndësie ka koha për njeriun dhe se njeriu i shpëton humbjes vetëm nëse është besimtar dhe bën vepra të mira. Me atë rast ai ka shpërblim të pandërprerë. Prandaj edhe u pajtova që të mos e lodhja kokën shumë se a ishte data pesë apo shtatë maj. Kjo nuk kishte asnjë rëndësi për mua që isha i fshehur në bodrum dhe që i kisha shpëtuar syrit të xhelatëve, të cilët kishin hyrë në bodrum një ditë dhe kishin plaçkitur gjërat me vlerë që i kishim ruajtur aty.

Kur ata hynë në bodrum me rrapëllimë e duke ungëruar lloj-lloj sharjesh në gjuhën e tyre, isha i fshehur mirë, pas disa dërrasave dhe thasëve të çimentos, në njëfarë shpelle që e kisha sajuar më herët. Ata nuk e kishin syrin te dërrasat e te thasët e çimentos, po te pakot ushqimore që i kishim futur në bodrum në ditët para se lufta të ashpërsohej. Dhe derisa ata po plaçkitnin në shtëpinë tonë, unë, fshehur, isha i koncentruar në lutje. Kjo më ndihmoi që të ruaja mendjen dhe të mos bëja ndonjë gabim që do të më rrezikonte kokën. Pas asaj dite, më nuk u ndie frymë njeriu në shtëpi.

Ndërsa, atë paraditen që m'u shfaq parandjenja se do të ndodhte diçka e jashtëzakonshme, trupi po e humbte qetësinë dhe po më shtynte të lëvizja me hapa më të sigurt nëpër bodrum, pa e mbajtur këmbën pezull për t'ia dobësuar peshën kur ta hidhja në dysheme. Edhe zemra disi më rrahte më ndryshe, me më pak frikë, thuajse nga kushedi ku ishte futur brenda saj një zemerek i ri. Për herë të parë pas sa e sa kohësh, ngjita shkallët dhe pa menduar fare se çfarë po bëja, rivendosa kontaktin e aparatit telefonik, të cilin e kisha shkyçur atë ditë që u fsheha në bodrum. Dy-tre herë më bëri dora ta shkyçja sërish, po as vetë nuk e di si u bë që në fund vendosa ta lë. Dhe deri sa unë po ecja nëpër korridor, cingëroi telefoni me një tingull të frikshëm, të cilin m'u duk se nuk e kisha dëgjuar kurrë. E ngrita receptorin me frikë, dora më dridhej dhe fryma më zihej, mendtë më merreshin dhe këmbët mezi më mbanin. A mos ishte një ëndërr kjo që po më ndodhte? Mezi ngrita receptorin, të cilin

e mbaja mjaft larg nga lapra e veshit. Megjithatë, pas përsëritjes disa herë të thirrjes alo, e njoha zërin e Ismetit. Fjalët e tij më dukej se po ngritnin një urë gjigante, e cila po rilidhte brigjet e një lumi të gjerë e me ujëra të turbullta. Por dallgët e atij lumi ishin aq shurdhuese, sa unë nuk i kuptoja fjalët që më vinin nga ana tjetër. Nuk di sa ka zgjatur ai turbullim, po më dukej se dallgët e turbullta më gërryenin dheun nën këmbë. Po pas njëfarë kohe, dallgët gërryese u tërhoqën dhe unë fillova të kuptoja jehonat e fjalëve të Ismetit.

Ai më kishte uruar për mbarimin e luftës!

Urime, Muhamet, se lufta mbaroi! Urime, vëlla, se fituam lirinë! Më dëgjon? Urime vëlla! Ai ishte i lumtur që po ma dëgjonte zërin dhe që kisha shpëtuar nga rrokopuja e luftës, sepse nuk e kishte ditur se ku jam. Pastaj ai më kish folur për një ekip të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të Gjysmëhënës së Kuqe dhe më kishte ofruar që unë të punoja me ta si përkthyes. Këtu sërish ndjeva një turbullim dhe një alivani. Mos ishte ndonjë provokim? Mos ishte ndonjë lojë? Mos ishte ndonjë halucinacion?! Një dridhje e mprehtë ma përshkoi trupin. Mbylla telefonin pa thënë asnjë fjalë. Thashë disa lutje me zë të ulët. Pastaj dora më shkoi vetë dhe e formova numrin e Ismetit, të cilin e gjeta me vështirësi në bllokun që ishte aty pranë dhe që ishte mbuluar nga një shtresë e hollë pluhuri. I tregova drejt. I thashë se nuk e dija a ishte e vërtetë që më kishte folur ai, apo ishte ndonjë halucinacion. Nga biseda e dytë me Ismetin kuptova më shumë. Ai më tregoi se forcat e NATO-s tashmë po e merrnin nën

kontroll kryeqytetin, ndërsa forcat pushtuese po largoheshin me shpejtësi, sepse u ishin diktuar afatet se kur duhej ta braktisnin Kosovën. Banorët e pakët që ishin brenda kryeqytetit, kishin zënë të dilnin në rrugë dhe të kremtonin fitoren, megjithëse me frikë. Ismeti më ftoi që të dilnim bashkë, po unë u arsyetova se më dhimbte koka. Pastaj ma përsëriti se ku do të duhej të takoheshim të nesërmen në mëngjes me ekipin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, që të filloja punën me ta si përkthyes.

- Ky ekip shkon në terren për të regjistruar gjendjen e shtëpive.

- Cilave shtëpi?

- Po të atyre që kanë shpëtuar nga djegiet e rrënimi. Aty duhet të strehohen të kthyerit.

- Cilët të kthyer, o Ismet?

- Paj ata që kanë qenë të dëbuar, o burrë. Ata do të kthehen nga Shqipëria, nga Maqedonia e nga Evropa. Po ti nuk je i informuar.

- Mezi po kuptoj diçka.

- Ky ekip bën edhe evidencimin e vendeve të minuara. Po ti s'ke pse frikësohesh. Ata kanë ekspertë me vete.

- Pas kësaj që kam përjetuar, asgjë më nuk më gjen.

- Megjithatë, kujdesi është i domosdoshëm në këtë ekspeditë. Thonë se ka shumë vende të minuara.

- Me rëndësi është që të shporret pushtuesi prej këtuhit, Ismet. Për të tjerat është më lehtë.

- Ata ikën, o vëlla. Për hajr na qoftë!

- Unë ende po kam frikë se mos jam në ëndërr, o Ismet.

- Nuk je në ëndërr, o burrë! Na qoftë për hajr liria!

- Të lumtë goja.

- Shihemi nesër, pra!- e mbylli Ismeti.

- Truri im tashmë po i regjistronte të gjitha fjalët dhe kuptimet e tyre, si dikur. U binda se e kisha ruajtur mendjen.

# II

Kur mbërrita në ora nëntë te Hoteli Grand, ata më prisnin aty ku e kishim lënë. Edhe Ismeti ishte me ta. U përqafuam me mall. Ai më shikoi me habi dhe unë e shikova me habi, po ashtu. Nuk e dija pse ai më shikonte me aq habi, po unë isha i habitur nga pamja e tij, që e tregonte shumë më të mplakur se para tre muajve. Ishte thinjur i tëri, mollëzat i ishin thelluar si të kishin qenë nën presionin e një gërryerjeje të vazhdueshme të ujit të rrëmbyeshëm. Sytë i kishin marrë një ngjyrë si të verdhëzës dhe bebëzat i ishin zgjeruar si t'u kishte vënë dikush doza të mëdha të atropinës. Habitesha se si shihte me ato bebëza aq të zgjeruara dhe pothuaj të shformuara. Nga pamja e dikurshme e Ismetit, kishte mbetur vetëm ajo prerja e fortë në mjekër, e cila e bënte disi të hareshme figurën e tij. Sigurisht edhe ai vërente ndryshime të frikshme në pamjen time, përderisa më thoshte një fjalë dhe pastaj heshtte, e më shikonte hetueshëm, duke rrudhur vetullat gjithnjë më shumë. Ato shtatëdhjetë e tetë ditë të strehimit tonë nëpër bodrume, në ankth se mos na gjenin xhelatët, duket se kishin pasur një rrjedhë tjetër në kalendar. Nuk kishin qenë ditë e net të zakonshme, po shekuj e

mileniume, të cilat ndryshojnë edhe faqen e gurit e lëre më të njeriut. Më vonë Ismeti ma pati pranuar se nuk më kishte njohur plotësisht dhe se vazhdimisht më kishte shikuar për t'u bindur në isha unë Muhameti, apo mos i kishte ndodhur ndonjë ngatërresë në memorie.

Ata të ekipit po shfaqnin padurimin e tyre për t'u nisur në ekspeditë. Ekipi i tyre përbëhej nga pesë veta, katër burra dhe një grua. Secili ma tha emrin e vet, po do të kalonin disa ditë deri sa t'ua kisha mësuar emrat.

Që nga çastet e para m'u fiksua bindja se ata ishin një ekip i mësuar me ekspedita të tilla të rrezikshme. Gëzimi i tyre që po nisnin një mision të ri vërehej në gjeste, në fjalë dhe veçmas në shikimet e tyre, që ishin më shpjeguese se vetë fjalët që thoshin. As që më pyetën gjë se si kisha mbetur gjallë. Me traumat që i kisha, m'u duk absurde gjithë ajo hare e tyre, dhe disa herë më vajti mendja që të prishja marrëveshjen e të ikja para se të niseshim në terren. Ç'u duhej gjithë ajo hare, kur po bëheshin gati të hynin në zona që ishin shkretëruar nga lufta? Nganjëherë nuk e dalloja në ishin ata njerëz të vërtetë, apo vetëm më faniteshin pamje të ndonjë filmi të shikuar kushedi se kur. Njëri prej tyre, më vonë mora vesh se ai ishte shefi dhe quhej Hans, i përngjante shumë Çarls Bronsonit, me atë fytyrë të vrazhdtë, sy depërtues dhe shikim të ngrirë. Pati dhe ndonjë çast kur unë kisha edhe njëfarë frike prej tyre. Gruaja holandeze me flokë të shprishura, Ana, më dukej si një kallakangjë, e cila bëhet gati të të fusë thonjtë në fyt. Shoferi, i cili quhej Naser, fliste

më një zë gazmor, dhe vetëm zëri i tij disi më qetësonte në fillim. E fliste një anglishte të çalë, sa mezi e merrja vesh. Por, e folura e tij disi më qetësonte, ndoshta pse ishte ashtu e çalë. Ndërsa, eksperti i minave, ishte anglez i natyralizuar, me prejardhje nga Nepali. Atë nuk e dëgjova asnjëherë të fliste, ai lëshonte vetëm klithma kur evidentonte vendet e minuara dhe asgjë më shumë. Për doktor Moamerin nga Xheda, që në fillim m'u duk një burrë hijerëndë, nuk munda të formuloj asnjë mendim as pas përfundimit të ekspeditës sonë.

Komunikimi me njerëz të huaj dhe në gjuhë të huaj, për mua ishte bërë shumë i vështirë, pas tërë atyre ditëve që kisha ndenjur fshehur në bodrum në lagjen Vellusha. Në fakt, mezi po e merrja veten në jetën mbi tokë. Më ishte prishur sërish ai uniteti i vetes sime. Zbulova me trishtim se brenda meje po ngrihej një dyzim i frikshëm, njëri që ishte i dërrmuar dhe nuk po e përballonte ndryshimin dhe tjetri i lumturuar që po riniste një jetë të re. Më dukej se e ndieja se si po zbrazej ajo vetja e dërrmuar dhe e thyer dhe se si po mbushej me përmbajtje ajo vetja tjetër. Uniteti po prishej sërish.

Kur mbërritëm te Kroni i Mbretit, Naseri u ndal pak dhe më pyeti në duhej të merrnin rrugën djathtas dhe unë ia pohova me kokë. Tha se përtonte të shikonte hartën. Mandej plotësoi veten duke thënë me të qeshura se nga harta as që do të mund të orientohej, sepse fshatrat ishin bërë njësoj. Të gjitha rrafsh me tokë. Pastaj dy veturat tona morën kthesën dhe unë ndjeva të më përziheshin zorrët. Vetëm më

vonë e kuptova se nuk ishte nga kthesa, po nga pamja që më doli befas përpara, shtëpitë e djegura në të dy anët e saj. M'u errësua shikimi. Era e shkrumbit m'u fut thellë në fyt dhe unë ndieva brenda vetes hidhëtinë e tij si një helm që ta hedh dikush me dhunë në grykë. Anëtarët e ekipit e kishin humbur harenë e nisjes dhe tash lëshonin ndonjë klithmë habie e tmerri. Njëri prej tyre, më vonë mora vesh se ai ishte doktor Hansi, tha që duhej të ndaleshim te lagjja që na doli përpara sapo dolëm nga kthesa. Ishin ndokund nja njëzet shtëpi, më saktë ish-shtëpi, sepse që të gjitha ishin të djegura që nga themeli e deri në kulm. Eksperti i minave doli i pari dhe filloi të bënte matje me njëfarë instrumenti të çuditshëm. Pastaj ngriti dorën e majtë lart dhe e lëvizi poshtë- lart, duke mbyllur e hapur shuplakën, në një mënyrë të çuditshme. Doli se shenja e tij tregonte se në atë vend nuk kishte mina dhe ekipi menjëherë u nis nëpër oborret e shtëpive të djegura, po gjithnjë duke shkuar pas eskpertit të minave, i cili asnjë hap nuk e bënte pa bërë matje andej këndej. Ana mbante një procesverbal, ndërsa Hansi i diktonte se si ishte gjendja e shtëpive të banimit dhe çfarë masash mendonte se duheshin ndërmarrë. Doktor Moameri mbante shënime në fletoren e tij dhe miratonte fjalët e doktor Hansit.

- Më habit ky pasion për të rrënuar gjithçka deri në themele - tha Hansi, pasi u përpiluan procesverbalet dhe ekipi u grumbullua në njërin nga oborret.

- Është pasion i njohur në histori- tha Dr. Moameri.

- Po, mund të thuhet ashtu. Vërtet njihen shembuj të shkatërrimit të kryeqyteteve, të qyteteve në përgjithësi, po shkatërrimi i një vendi të tërë, kjo është krejt e veçantë. Kjo ka të bëjë më shumë me një urrejtje të shfrenuar, sesa me një strategji ushtarake. Çfarë roli mund të ketë ky fshat në një strategji ushtarake?! Shiheni si e kanë bërë! - tha doktor Hansi, duke luajtur me një guralec që e mori nga toka.

- Shkatërrimi i vendbanimeve dhe dëbimi i popullsisë është një krim dhe një mëkat i vjetër i njerëzimit. Lidhet me krimin e Faraonit për shkatërrimin biologjik të një populli për zhdukjen e farës mashkullore të tij. Është e habitshme se edhe këtu është aplikuar vrasja në masë e meshkujve, zhdukja sistematike e meshkujve - konkludoi doktor Moameri.

- Vërtet ka të bëjë me një urrejtje të vjetër dhe të shfrenuar - u futa edhe unë në bisedë. Serbët kanë një pretendim se kjo tokë është djep i kulturës së tyre dhe në emër të kësaj ata përligjin krimet më të errëta.

- Unë nuk kuptoj si kanë mundur të vrasin fëmijë me aq gjakftohtësi- ndërhyri Ana.

- Pasioni i Faraonit ishte vrasja e fëmijëve. Duket se ka një përsëritshmëri të destruksionit të qenies njerëzore nëpër kohë, në rastet kur ajo mohon urdhërat e All-llahut - tha Dr. Moameri. Vërtet, kjo prirje bëhet zotëruese në periudhat e degjenerimit moral të një populli.

- Mendja e njeriut normal nuk e përthekon këtë gjë. Si është e mundur që një popull i tërë të identifikohet me krimin dhe të mburret me veprat mizore? I kam shikuar në televizion protestat e serbëve nëpër urat e tyre dhe jam shokuar nga pasioni me të cilin thërrisnin për hakmarrje kundër shqiptarëve - tha Ana.

- Mbi të gjitha mua më habit pasioni për t'i rrënuar këto fshatra të humbura. Kjo duhet të studiohet me kujdes nga ekspertë të të gjitha fushave, përfshirë edhe neuropsikiatrinë dhe gjenetikën. Në themel të këtij krimi ka diçka që nuk është krejt e lehtë të zbulohet.

Dr. Hansi e hodhi guralecin që e mbante në dorë. Fytyra i mori një tis më të nxirë, thuajse në çast e preku bloza e shtëpisë së djegur, nën strehën e së cilës qëndronte. Vura re se sytë i morën një vezullim më të fortë, si vezullimi i kaltëremë i flakës së gazit nëntokësor.

- Krimet në përgjithësi janë të nxitura nga forca djallëzore, prandaj edhe janë të errëta motivet - tha Dr. Moameri.

Pastaj ra heshtje. Shikoja herë njërin herë tjetrin, po të dy burrat rrinin si të ngrirë, të tretur në mendime dhe thuase ishin shkëputur nga kjo botë. Heshtjen e prishi Dr. Hansi.

- Tash pesëdhjetë e katër vjet përpiqem të zbus pasojat e krimit. Dikujt mund t'i duket e pabesueshme dhe madje edhe një gjë e krisur.

- Pse? - ndërhyra unë me një kurreshtje të papërmbajtur.

- Është vetë historia e jetës sime.

Doktor Hansi heshti sërish. Vezullimi i kaltremë u shndërrua në një gri të shtrirë në tërë hapësirë e syve të tij. Vura re se rrudhat në ballë iu ntrashën më shumë, duke u përplasur si retë para një shtrëngate. Më shikoi drejt në sy disa çaste, sa më hutoi shumë. Ngadalë në fytyrë iu formësua një buzëqeshje, ndoshta më shumë një ngërdheshje, si ajo kur njeriu ndien ndonjë dhembje të topitur.

- Në dimrin e vitit 1945 isha fëmijë dhjetë vjeç dhe pashë me sytë e mi tmerret e luftës në vendlindjen time, në Berlinin e pushtuar. Shtëpia jonë ka qenë afër lagjes së njohur Leipzigestrasse, sepse babai im ishte tregtar i njohur. Në lagjen tonë ishin selitë e bankave, zyrat e firmave më të mëdha kombëtare dhe sallonet më luksoze. Por kur ne dolëm nga bodrumi, pas një muaji të bombardimeve të parreshtura, unë nuk e njihja lagjen time dhe qytetin tim. Berlini ishte bërë një gërmadhë gjigante, nga themelet e të cilës dilte tym i dendur dhe shpërthime granatash të mbetura. Derisa kalonim nëpër parkun Tiergarten, me nënën dhe me motrën, një granatë shpërtheu para këmbëve tona dhe unë pashë trupat e nënës e të motrës si u ngritën pezull mes flakëve e tymit, si zunë të copëtohen në ajër dhe të bien si re të pëgjakura. Mua më qëlluan veçse disa cifla të vogla në shpinë, sepse në atë çast u gjenda prapa trungut të një pishe gjigante. Pastaj më ra terr para syve dhe ndieva se si po rrëzohesha përtokë, njëherë duart më prekën dheun, pastaj gjoksi, pastaj fytyra dhe unë sharrova në një llucë të errët e të

ftohtë. Nga larg vinin gjëmimet e panjohura, si të vinin nga një botë e nëndheshme, e mbytur në gjak dhe lot. Nuk di pas sa kohësh kam ardhur në vete, po e di që kam ndeshur në trupin e gjymtuar të nënës. Fytyra nuk i njihej, po ia njoha këmbët dhe fustanin e leshtë, të zi, i cili ishte ngjyer nga gjaku. Një hënë e verdhë pehatej në qiell dhe unë shihja qartë trupin e bërë copë-copë të nënës sime. Pastaj nuk e di si m'u kujtua dhe fillova ta kërkoja trupin e motrës mes drurëve të parkut të madh Tiergarten, sa andej sa këndej, po nuk e gjeta asnjë shenjë të saj. Sot e atë ditë nuk e di në ka mbetur aty e copëtuar apo çka ka ndodhur saktë me të, vetëmse trupin e saj e kam parë kur ka fluturuar në ajër në çastin e goditjes së granatës. Nuk di. Po bombat binin andej këndej nëpër parkun gjigant, shqyenin degët e pishave, rrënonin përdhe trungjet e mëdhenj dhe ngritnin dheun deri në kupë të qiellit. U largova nga parku me një vrap që nuk e dija në ishte imi apo dikush vraponte në vend timin dhe unë isha hija e tij. Disi dola në lagjen Aleksanderplatz, e cila ishte shndërruar e tëra në një gërmadhë. Aty më gjetën ushtarët amerikanë dhe më dërguan në një kamp në Manhajm, ku mbeta dy vjet e gjysmë. Mund të them se pamjet tmerruese të asaj nate në parkun Tiergarten, kur i pashë si fluturonin në ajër trupat e nënës dhe të motrës, më kanë shtyrë që tërë jetën të jem në ekspedita humanitare në vatrat e luftës. Më duket se kryej një obligim ndaj nënës dhe ndaj motrës. Edhe sot në këtë fshat të humbur e të rrënuar, më duket se zëri i nënës më thotë vazhdo më tutje,

ndihmoji, ndihmoji, bir. Dhe ky nuk është halucinacion akustik vërtet, po është një zë i dhembjes sime, që buron nga thellësitë e shpirtit tim e nuk shteron kurrë.

- Histori e dhimbshme, - foli i pari doktor Moameri. Lufta juaj ka qenë shumë e përgjakshme, po edhe hakmarrja po ashtu ka qenë shumë e egër ndaj njerëzve të pafajshëm. Ndërsa, sa i përket misionit tuaj, gjithmonë ekziston një shkak që na shtyn në veprimet tona.

- Nuk e dija këtë pjesë të biografisë suaj, megjithëse ka kaq vite që punojmë bashkë, - tha Ana me një zë të dridhshëm.

- Ky shkatërrim i egër këtu, ma kujtoi fëmijërinë time, sesi m'u duk vetja si në atë çast kur po ikja nga parku Tiergarten - foli ankueshëm doktor Hansi.

- Më vjen keq, tha Ana, si të ishte ajo fajtore për hidhëtinë e fjalëve të doktor Hansit.

- Edhe unë kam vendosur t'i kushtohem këtij misioni pas masakrës që pashë në Sabra e Shatilla, - foli doktor Moameri, duke bërë një hap më afër doktor Hansit, i cili tashmë ishte mbështetur për murin e shtëpisë-gërmadhë dhe po pinte duhan. - Isha mjek i ri stazhist në vendlindje, po u paraqita si vullnetar që të ndihmoja të plagosurit e masakrës së tmerrshme. Ajo ngjarje ma ndryshoi jetën. Kështu ka qenë e shkruar.

- Ajo po ashtu ishte një masakër e tmerrshme, foli doktor Hansi, duke ngritur kokën drejt qiellit, si për të evituar kryqëzimin e shikimeve me të tjerët.

- Në kampet e rrënuara të Sabrës e të Shatillës, kam parë trupa të copëtuar më dhjetëra pjesë dhe ishte e pamundur që të rikrijohej trupi me gjymtyrët e veta. Mund të gjeje një dorë e një këmbë, po mungonte dora e këmba tjetër ose koka. Më së vështiri ishte me trupat e fëmijëve. Shumica ishin djegur e bërë hi dhe kishin mbetur vetëm pjesë të trupit që nuk mund të bashkoheshin, të krijonin formën e një trupi. Ishte e tmerrshme përpjekja e disa nënave që kishin shpëtuar gjallë që të gjenin gjymtyrët e fëmijëve të tyre. Ndodhte që ziheshin mes vete për gjymtyrët e gjetura! Që nga ajo kohë kam mbetur në misione humanitare edhe unë dhe as që mund ta imagjinoj si do të dukej jeta ime jashtë dhimbjeve e të papriturave të këtij misioni. Më duket se më shtyjnë përpara zërat e atyre fëmijëve të shkrumbuar në zjarrin e granatave.

- Domethënë edhe ju u duket se dëgjoni zëra? - pyeti doktor Hansi.

- Po ai është zëri që na shtyn të ecim përpara, sipas vullnetit të Zotit të Gjithëmëshirshëm. Dhe ja ku jemi në këtë fshat të shkrumbuar të Kosovës.

- Unë nuk mund ta kuptoj motivin për ta shkatërruar një fshat të humbur si ky ku jemi në këtë cast. Hajt Berlini ishte një kryeqyet i një shteti në luftë dhe hakmarrja e përbindshme ndaj tij ushtarakisht mund të imagjinohet. Po ky fshat i shkretë, kujt i ka zënë udhën? Kjo është një urretje iracionale dhe asgjë tjetër. Nuk mund të shpjegohet.

Ra një heshtje e thellë. Disa herë u mundova të formuloja një mendim, po aq e shterruar më ishte

mendja nga ato që dëgjova sa nuk dija se çfarë duhej të thosha.

I pari u ngrit doktor Moameri, e pas tij të gjithë të tjerët. Hymë brenda nëpër një zgavrinë të nxirë nga tymi. Aty mbase ishte vendi ku dikur ka qenë dritarja në katin përdhesë të shtëpisë. Ishte deformuar edhe muri, sigurisht nga temperaturat e larta dhe presioni deri sa ka shpërthyer tymi e flaka jashtë. Brenda kishin mbetur të padëmtuara vetëm pllakat e qeramikës në pjesën ku ishte dikur kuzhina. Në një komodinë të vogël, të mbyllur hermetikisht, për çudi kishte shpëtuar një album i fotografive. Fillova t'i shikoja ato fotografi që kishin mbetur të padëmtuara për shkak se që të gjitha ishin të mbështjella me folio të mbyllura. Pranë meje ishte edhe Naseri, ndërsa të tjerët i dëgjoja si endeshin nëpër dhomat e tjera. Fotografia e parë ishte portreti i një djaloshi dhjetëvjeçar i ulur në një karrige të drunjtë, në mes të kopshtit. Djaloshi buzëqeshte dhe bënte me dorë, sigurisht drejt atyre që po e shikonin çastin e fotografimit në ndonjërën nga ditëlindjet e tij. Ishte bjond, flokëkaçurrel dhe me faqe të mbushura. Në njërën faqe kishte një si njollë, që dukej të ishte një ngjitje e copëtortës së ditëlindjes.

Tjetra ishte një fotografi e përbashkët: burrë e grua në moshë ndoshta rreth të tridhjetave, në mes tyre po ai djaloshi i fotografisë së parë dhe një vajzushë rreth tre vjeçe, të cilën e ëma e mbante në krahë. Tre më të mëdhenjtë buzëqeshnin, ndërsa vajza e vogël ishte e frikësuar dhe me buzën në vaj. Djaloshi përballë tortës së ditëlindjes, në të cilën

ishin ngulur disa qirinj të vegjël: ai u frynte qirinjve ndërsa e ëma ia mbante njërën dorë në qafë, duke e motivuar që të frynte më shumë. Në prapavijë shihej burri dhe pak më larg një çift i ri, duke përplasur duart. Në fotografinë tjetër, e cila ishte më e zbehtë, djaloshi flokëverdhë ishte duke shkruar në një makinë shkrimi, pranë e ëma dhe motra e vogël, duke tërhequr të ëmën për mënge dhe me buzë në vaj. Pastaj ishte një jë fotografi e vajzës së vogël, me tortën përpara saj dhe me dy qirinj të ngulur në mes të saj. I ati shihej duke e nxitur që të frynte e të fikte qirinjtë, ndërsa e ëma e ndalonte djaloshin me njërën dorë që ai të mos i fikte qirinjtë.

Eksperti i minave hyri në dhomë nga ana tjetër, andej nga dukej të kishte qenë dera e shtëpisë. Pas tij hyri doktor Hansi, duke folur diçka me ata që ende ishin jashtë. Nuk vonoi e hynë brenda edhe doktor Moameri dhe Ana. Albumi i vogël i fotografive më ngeli në dorë, kur Hansi u gërmuq dhe kapi një gjë që në fillim m'u duk si një urë e shuar zjarri.

- Ky është femuri i një fëmije! Mund të jetë i moshës rreth dhjetëvjeçare!

- Çudi e madhe si paska shpëtuar!- belbëzoi Moameri dhe u afrua edhe më shumë.

- Mund të ketë edhe shenja të tjera të njerëzve që janë djegur këtu brenda!- tha doktor Hansi me një zë të mbytur.

- Oh, Zot!-klithi Ana, e gërmuqur mbi një grumbull të nxirë në njërin skaj të dhomës. Hansi e Moameri iu afruan dhe u gëruqën edhe ata, si për t'i dhënë një ndihmë Anës.

- Këta janë eshtra të një fëmije edhe më të vogël, më së shumti tre-katër vjeç!- foli doktor Hansi me zë të të përvajshëm. Edhe doktor Moameri tha diçka për moshën e njomë të viktimës, po unë nuk e dëgjova qartë. M'u errësuan sytë dhe ndjeva se si po bija në një rrëshirë të zezë të harrimit.

# III

Shtëpia duket e djegur vetëm pjesërisht, ndërsa disa dhoma të saj ishin vetëm të përzhitura nga flakët e të nxira nga tymi. Në njërën prej atyre dhomave vura re se kishin shpëtuar disa libra që ishin në një vitrinë të vogël. Fillova t'i kërkoja titujt e librave, po në disa nga kopertinat nuk dalloheshin shkronjat. Ishin të nxira nga tymi ose të shkrumbuara nga flaka. Ashtu edhe filloi një aventurë e imja, e cila m'u bë edhe gëzim edhe torturë shpirti. Kërkimi pas librave të djegura m’u bë një obsesion, në gjithë ekspeditën që zgjati disa javë.

Në shumë shtëpi gjysmë të djegura, gërmoja nëpër vitrina gjysmë të djegura, duke shikuar titujt e librave. Këtë obsesion timin e hetoi edhe doktor Hansi, i cili shfaqi njëfarë habie për prirjen time. Kur i tregova se tërë jetën kisha jetuar mes librave, ai qeshi dhe tha: Ti ke jetuar mes librave, ndërsa unë mes gërmadhave. Tërë jetën kam jetuar nëpër gërmadha. Ha ha ha. Pastaj heshti. Vura re se nuk e kishte freskinë e ditës së parë kur u nisëm në ekspeditë. M’u duk se lodhja dhe mërzia i rrinin varur në vetulla si re të shprishura në një qiell të ndryshueshëm. Fshiu ballin me shuplakën e dorës së

djathtë dhe pastaj vëzhgoi shtresën e blozës e të pluhurit që iu vizatua në të. Derisa unë po mundohesha ta lidhja disi bisedën, doktor Hansi vazhdoi me një zë melankolik:

- Kam qenë në Kamboxhë, në Laos, në Palestinë, në Tibet, në Ruandë, në Kongo, në Guatemalë, gjithkund ku ka pasur gërmadha. Askund nuk kam gjetur dikë që kërkon libra në gërmadha. Interesant! Më kanë thënë se ju shqiptarët jeni dashamirë të librave dhe e gjeta një shembull të mirë.

- Tërë jeta jonë si komb është një kërkim tragjik pas librave të djegura, i thashë, megjithëse nuk isha i sigurt se arrita ta formuloj mirë mendimin.

- Si tërë jeta? - u bë kurreshtar Hansi.

- Gjithmonë na i kanë djegur edhe librat. Bashkë me djegien e kështjellave, kullave e shtëpive, bashkë me dëbimin nga vendi ynë, na i kanë zhdukur edhe gjurmët, na i kanë djegur librat. Ka shumë dëshmi.

- Kam mbledhur mjaft informacione para se të vija këtu, po për këtë punën e librave nuk kam ndonjë shënim - ma ktheu Hansi i mërzitur.

- Ka sa të duash.- i thashë. Ka lënë shënime për djegien e librave shqipe edhe një murg i quajtur Guilielm Adae, qysh në vitin 1332

- Kur, kur?!- më ndërpreu i tmeruar Hansi.

- Në vitin 1332, pra. Ai ishte një udhëpërshkrues dhe ka lënë një dëshmi të fortë se shqiptarët në librat e tyre përdornin alfabetin latin. Por, asnjë libër i asaj kohe kurrë nuk është gjetur. I kanë djegur pushtuesit.

- Kush kanë qenë ata pushtues? -pyeti Hansi me zë pak më të qetë.

- Kanë qenë romakët, bizantinët, normanët, kryqtarët, anzhuinët, mandej sllavët, mandej osmanët dhe tash sërish sllavët.

- Më duket tepër tragjike - tha në fund doktor Hansi.

- Nga ai çast me Hansin u miqësuam dhe ia kaluam mirë, edhe pse ai ishte mjaft i rreptë në punë.

# IV

Tashmë jemi thellë në zonë dhe procesverbalet janë trashur shumë. Ana dallohet me një vullnet të pashoq që të shënojë gjithçka shihet me sy. Mbështetet me fletoren e madhe në njërin gju dhe bën procesverbalet për gjendjen në të cilin janë vendbanimet e shkatërruara. Habitem si nuk i mpihet këmba që e mban ashtu shtrembër dhe duke e mbështetur tërë peshën e saj mbi të. Ana thotë se është mësuar tërë jetën ashtu, në ekspedita humanitare, duke bërë procesverbale nëpër vende të shkatërruara nga lufta. Ana shpesh e përmend Laosin, ku ka qëndruar dy vjet, duke shpërndarë ushqime. Tregon edhe për Afganistanin, ku ka qëndruar tri vjet, pas tërheqjes së armatës ruse.

Pas qëndrimit të ftohtë të ditës së parë, tash i admiroj këta njerëz që tërë jetën e kalojnë nëpër vende të botës, duke iu ofruar ndihma njerëzve të katandisur nga lufta. Në vend të rehatisë në vendet e veta, ku mund të punonin në spitale moderne, këta kanë zgjedhur të bëjnë një jetë të vështirë e plot me rreziqe. Ndoshta ky shpirt luftarak dhe i gatshëm për sakrifica të panumërta, i ka bërë kombet e tyre të fuqishme. Mbyllja në vete, izolimi dhe ikja nga

ballafaqimi me të keqen, ndoshta janë shkaku kryesor i rënies së një kombi dhe i robërisë së tij. Tek i shoh si punojnë me kaq pasion, mendoj me vete: këta njerëz lirinë e kombit të tyre e mbrojnë në fushat e minuara të Laosit dhe të Afganistanit, në gjetjen e varrezave masive të Ruandës e të Kosovës.

Pas një dite të lodhshme, po i frymëzuar nga pasioni i tyre, shënova në ditarin tim këto fjalë: Atdheu me siguri mbrohet dikund më larg nga kufijtë e tij fizikë. Nuk jam i sigurt se a do të na e largojë lufta e fundit prirjen për t'u mbyllur në vete dhe për të mos u ballafaquar me të keqen. Por, fjalinë e fshiva me një vizë të lehtë, sepse më duket qortim i rëndë. Ndjej se ende jam i traumatizuar.

Dje në fshatin Lisanë, derisa po bënim inspektim në një lagje të shkrumbuar, në njërën nga shtëpitë sërish gjeta një vitrinë të vogël me libra dhe me fletore, të cilat ishin nxirë nga shkrumbi, po nuk ishin djegur tërësisht. Duke shfletuar librat, dora më zuri edhe një fletore të trashë me kopertina të nxirosura. E hapa me ngut. Nuk e di as vetë pse me aq ngut. Ishte ruajtur mirë brenda kopertinave. Meqë doktor Hansi fliste me zë të lartë në oborr, e mora me mend se po shfaqte pakënaqësi për vonesën time. Prandaj, dola me ngut, duke e marrë fletoren me vete. Në mbrëmje, në shatorin që e ndaja me shoferin Naser, e hapa fletoren.

Fatkeqësisht, mungonte emri i autorit. Mbase mund të ishte në kopertinë, por ajo ishte aq e nxirë sa nuk mund t'i hiqej shkrumbi. U habita nga teksti. Nuk e kisha të njohur në kishte jetuar në këtë

vendbanim ndonjë shkrimtar. Pastaj m'u krijua ideja se mos aty është strehuar ndonjë shkrimtar gjatë furtunës së luftës dhe i ka ngelur aty dorëshkrimi?

Sot është data 14 qershor 1999. Në fshatin Gjethanë, ku jemi ndalur me ekspeditën tonë, është një shkretëtirë ngjethëse. Shtëpitë janë të djegura tërësisht. Vetëm oxhaqet e shumicës së shtëpive kanë ngelur të parrënuar dhe duken si fantazma. Dje një plak na tha se oxhaqet që kishin ngelur të parrënuara kishin qenë paralajmërim i mbijetesës së shqiptarëve në këto troje. Në fshatin ku jemi ndalur sot, enden disa lopë, që duken si të çoroditura, disa me litarë në qafë, disa me lëkurë të përcëlluara. Kur kaluam pranë tyre, ikën të tmerruara. Gjëja e parë që vura re ishin sytë e tyre të zmadhuar, në një shpërpjestim të tmerrshëm me kokën, disi të dalë nga mollëzat e të shqyer pjerrtas, gati deri te goja.

- E kanë nga frika- tha Naseri.- Kam parë këso pamjesh edhe në Somali. Mendoj se edhe kafshët e përjetojnë luftën në mënyrë dramatike. Gjithë ajo përmbysje pa dyshim shkakton vrragë në botën e tyre.

- Mundet- plotësoi doktor Hansi. Edhe në Gjermani, pas mbarimit të luftës, ka pasur shumë raste të tërbimit të lopëve.

- Kafshët janë pjesë e ambientit jetësor të njeriut dhe çdo çrregullim i atij ambienti, shkakton edhe çrregullim në botën e tyre, po ne nuk jemi të aftë ta kuptojmë - argumentoi Naseri.

- Biseda vazhdoi gjatë, ku ata sillnin shembuj të ndryshëm të çrregullimit të botës së kafshëve nga egërsia e luftës.

Të nesërmen i pamë sërish ato lopët që endeshin si të çakërdisura nëpër fshat, po askush nuk foli më për to.

Unë desha njëherë t'i tregoja se kisha parë një ëndërr të frikshme me disa lopë të përcëlluara, të cilat më ndiqnin nëpër një përpjetëze të madhe. Nga brirët e tyre dilte një tym dhe një flakë që më shkaktonte djegie erëshkrumbi në fyt dhe një rëndesë paralizuese në gjymtyrë. Klithja i tmerruar, po zëri nuk më dilte. Naseri e Hansi zgërdhiheshin në stom dhe i nxitnin lopët të më ndiqnin. Nuk ua tregova ëndrrën se mund të ishte një keqkuptim i panevojshëm mes nesh.

Tërë ditën u endëm nëpër fshat, duke hulumtuar në mos kishte mina, në mos ishin puset të helmuara. Fshati kishte gjithsej dyzet puse, të cilat u inspektuan një për një. Në dy prej tyre u konstatua se ishin hedhur disa trupa njerëzish, po numri nuk ishte e mundur të konstatohej. Puset u shënuan me shenja të posaçme, u vu mbi to nga një blombë e metaltë dhe u vunë rrethoja me shirita të kuq. Mua më merreshin mendtë tërë kohën, sa mezi qëndroja në këmbë. Dy gra plaka, që erdhën pas një kohe, rrëfyen se aty kishte qenë e stacionuar një ekspeditë policësh dhe ata kishin kryer dhunë të egër ndaj banorëve. Në puse kishin hedhur pesë femra, të cilat ishin përpjekur t'i dhunonin, po në tërbimin e tyre i kishin vrarë dhe i kishin hedhur në puse. Fjalitë e

grave ishin të shkurtëra e të prera, po unë mezi përktheja, se më merreshin mendtë. Përfytyroja tmerrin që kishin përjetuar ato gra fatmjera, të cilat i kishin ekzekutuar para njerëzve të familjes dhe pastaj i kishin tërhequr zvarrë e i kishin hedhur në puse. Klithmat e tyre më dukej se endeshin nëpër oborret e shtëpive të djegura dhe më qëllonin në kokë si gjilpëra të mprehta.

- Ku gjenden banorët e tjerë? - pyeti Hansi dhe unë e përktheva.

- Atje pas kësaj kodre - bëri me dorë ajo më plaka. Atje rrijmë ende fshehur. Po dikush na tha se lufta ka mbaruar.

- Sa banorë janë atje? - pyeti Hansi.

- Jemi rreth pesëdhjetë gra e fëmijë. Dy fëmijë na kanë vdekur nga sëmundja. Edhe një grua shtatzënë është duke hequr shpirt. Po dikush na tha se ka mbaruar lufta, prandaj ne plakat erdhëm deri këtu.

- U ngjitëm kodrës me hapa të shpejtë, sa mezi merrja frymë. Ato plakat ecnin më shpejt nga unë. Kur mbërritëm në luginën ku ishin fshehur, pamë një lemeri të parrëfyeshme. Në disa tenda najloni ishin shtrirë fëmijë e gra, me fytyra të zverdhura, me sy të shqyer nga frika, në një qetësi mbytëse. Shatorat e najllontë ishin ngjitur njëri me tjetrin, në madhësi të ndryshme dhe me disa hyrje të ngushta, si hyrje shpellash. Brenda disa shatorave futa kokën dhe pashë gra e fëmijë që rrinin shtrirë, po nuk pata kohë të merresha me ato pamje të lemerishme. Gruaja e sëmurë ishte e zverdhur tejmase, tha se kishte dy ditë me gjakderdhje. E morëm në një lese dhe u

nisëm kodrës tatëpjetë, bashkë me gratë e fëmijët që u thamë të vinin lirisht në fshatin e tyre, sepse më nuk do t'i vriste askush. Hutimi i tyre i përzier me një gëzim të turbullt, më dukej se varej si një re mbi kokat e tyre. Naseri e Ana e përcollën gruan e sëmurë për në spitalin e Prishtinës, ndërsa ne të tjerët, Hansi, Moameri dhe unë, u ndihmuam banorëve që të rregulloheshin disi në dy nga shtëpitë që ishin djegur më pak, aty ku eksperti i minave jepte lejen për vendosjen e tyre. Derisa po merreshim me gruan e sëmurë, për herë të parë e pashë një trubullim të fortë të Anës. Gjatë tërë kohës ajo belbëzonte "Maj God" dhe e fshihte fytyrën që të mos i shiheshin lotët. Banorëve të rikthyer në fshatin e tyre të bërë shkrumb, u lamë disa batanije e ushqime dhe në mbrëmje u nisëm për në fshatin fqinj.

Edhe pse jam i dërrmuar, u tërhoqa mënjanë në një kënd të shatorit që ta shfletoj dorëshkrimin që mbaj në çantë.

# Truri

Ky është një roman, në të cilin nuk do të rrëfej veten time, po dridhjen e fotografive të kujtimeve të ditëve të kaluara, e cila më shkakton tërmete të parreshtura në tru. Nuk e di ku gjendet ajo zonë seizmike që prodhon këto dridhje të përhershme, në cilin cep të trurit a në cilën pore të shpirtit. Është një luftë dridhëritëse mes njohjes dhe mosnjohjes, mes kujtimit dhe harrimit. Fotografitë e kujtimeve shpërthejnë si xixa të një zjarri që është në të shuar, ndërsa errësira e harrimit përpiqet t'i gllabërojë me gojën e vet të madhe.

Ndoshta kjo vorbull e ngjarjeve, e kohëve, e kujtimeve dhe e kuptimeve, që përplasen mbi njëra tjetrën, duke u përpjekur t'i shpëtojnë gojës së madhe të harrimit, mund të emërtohet si një vetëpërplasje, në përpjekjet për të zbuluar kuptimet më të thella të jetës, si fëmija që përpiqet të gjej gurin që i ka rënë nga dora në ujin e turbullt të lumit.

Këto fotografi të panumërta kujtimesh, herë të plota, herë të thyera, herë aq të deformuara sa mezi njihen, që më shfaqen krejt papritur në kujtesë, nuk di as çka janë në të vërtetë? Kujtime? Iluzione? Meditime? Mendime? Mesazhe? Pse shfaqen herë me

drojtje të madhe, sikur kanë frikë nga vetë ekzistenca e tyre, herë me kokëfortësi, sikur duan të më hakmerren për diçka?

Kaosi? A është fjala më e mirë për ta shprehur gjendjen e dridhjeve të vazhdueshme në tru nga fotografitë e kujtimeve, zakonisht të gjymtuara nga harrimi? Më duket se ky kaos ka lindur si pasojë e dhunimit që i është bërë shpirtit tim nga ndikimi i faktorëve të jashtëm. Pas një fëmijërie të qetë, në ambient të ngrohtë familjar, ka filluar dhuna e ideve të mbrapshta mbi shpirtin tim dhe me kohë ajo ka shkaktuar çrregullime të ndjeshme në ekuilibrin tim shpirtëror. Ka shkaktuar kaos. Kjo është fjala më e përshtatshme. Kaos. Në një anë dashuria për familjen, edukimi fetar, qetësia shpirtërore, devotshmëria, ndërsa në tjetrën presioni i ideologjive ateiste dhe antimorale, ngulfatja nga ritmi marramendës. Tamam kaos. Prandaj dhe këto dridhje në tru janë si protestë, si përpjekje për ta rikthyer ekuilibrin. Ndoshta edhe për të paralajmëruar rrezikun për ata që vijnë pas nesh.

# V

Këtu teksti bëhej i palexueshëm. Shkrumbi nuk mund të hiqej nga letra, e cila edhe m'u thërmua në duar. Çuditërisht, në një cep të saj shihej një datë, 16 shtator 199, po numri i fundit nuk shihej. Ishte përpirë edhe ai nga shkrumbi.

A thua cili vit ishte i shënuar ?! Vitet e nëntëdhjeta, që të gjithë kanë qenë vite të shqetësimit të madh. Në ato ditë kritike, kur rrija fshehur në bodrumin e shtëpisë në lagjen Vellusha, shpesh sillja ndër mend kujtimet nga vitet e kaluara, në përpjekje për të gjetur kuptimin e katastrofës që kishte mbështjellë jetët tona. Kujtoja mesditën e pesë korrikut 1990, kur tanket rrethuan godinën e Kuvendit dhe atë të Televizionit. Atë ditë unë isha në ëmbëltoren Elida me Ditën, e cila më ankohej se e vrisnin këpucët e reja, kur erdhi Xeni dhe më tha në vesh se tanket po e rrethonin Parlamentin. Ndoshta është mirë të shkojmë në shtëpi, tha Xeni. Nuk e di a i paguam akulloret a jo, po pas dy-tre minutash ne ishim afër hotelit Union, vetëm nja dhjetë metra larg godinës së Parlamentit, ku tri tanke kishin zënë trotuarin dhe hyrjen në godinë dhe ku qindra policë kishin krijuar një mur të hekurt në mes të rrugës

kryesore. Ky është grushtshtet - tha Dita dhe më shtrëngoi më fort llërën, ku mbahej tërë kohën. Jo, ky nuk është grushtshtet, ky është pushtim, thashë me zë të ulët. Dhe u kthyem mbrapshtë, sepse kordoni i policëve po mësynte drejt njerëzve që ishin tubuar aty. Më duket se të gjitha kujtimet e tjera për vitet nëntëdhjeta nisnin nga ajo pikë, nga dita e pushtimit me tanke të parlamentit. Pastaj vinin ditët me orë policore, e cila fillonte në orën 21 dhe zgjaste deri në orën 5 të mëngjesit, e shoqërohej me të shtëna automatikësh dhe sinjale alarmi të veturave të policisë. Vinin mandej arrestimet, gjykimet e grupeve ilegale, greva e urisë në Rilindje. Vinin pastaj kujtime të tjera për eksodin e të njohurve dhe të njerëzve të farefisit në vitet 1996, 1997, të cilët iknin larg e më larg Kosovës, ku mundnin. Po cilin viti e ka shënuar ky autor në dorëshkrimin e tij, a thua? Kjo ndoshta nuk do të merret vesh kurrë.

Pas dy faqesh të shkrumbuara tërësisht, vinin faqet e tjera, që edhe pse ishin të nxira pjesërisht, mund të lexoheshin pa vështirësi të mëdha.

# Dridhje

Edhe ky roman, të cilin po e shkruaj drejtpërdrejt në kompjuter, i shtyrë nga dridhjet e kujtimeve, është një përpjekje për të nxjerrë kuptimet e jetës nga ato fotografi të kujtimeve, të cilat shfaqen më me këmbëngulje dhe sikur duan të më japin ndonjë mesazh, që nuk e kam kapur me kohë. Por, kjo është një disfatë. Romani do të duhej shkruar për fotografitë e harruara, për t'i rikrijuar ato, për t'u dhënë trajtë e përmbajtje. Por, kjo tashmë nuk është e mundur, sepse ato i ka përpirë goja e madhe e harrimit. Prandaj, po e bëj atë që është më lehtë për t'u bërë, por që mbase më ndihmon për t'i qetësuar dridhjet në tru. Përshkrimi i këtyre fotografive të kujtimeve më krijon shumë mundim dhe shumë dilema. Nëse mua më duken të vlefshme kujtimet e mia, a duheshka që ta mashtroj edhe lexuesin me to? Megjithatë, kjo dilemë është e zgjidhshme. Unë tashmë jam i bindur se lexuesi nuk ekziston dhe vepra artistike shkruhet për vete e për askë tjetër. Po të mos ndieja nevojë vetë që t'i shkruaj këta rreshta, edhe pse kjo është një punë shumë e rëndë, sa për lexuesin as që do të merrja mundimin të rri gërmuqur mbi tastaturë dhe të

përjetoj strese të panumërta duke ndier gërryerjet nëpër kujtesë. Ajo që dikur na thonin në shkollë kinse shkrimtarët janë të përjetshëm, kinse veprat e tyre i shërbejnë kulturës dhe historisë, tash e di se ka qenë një ekzagjerim romantik. Edhe fotografitë e shkrimtarëve në librat e leximit dhe në librat e historisë së letërsisë, ishin të stampuar ashtu që të mbillnin një mbresë romantike, me atë shkëlqim të fshehtë, si të përtejkohshëm. Më vonë e mora vesh se e tëra ishte një mashtrim. Njerëzit asnjëherë nuk kishin pasur respekt e dashuri për shkrimtarët, po vetëm sa kishin gënjyer. Bashkëkohësit ua kishin nxirë jetën me lloj-lloj intrigash dhe ndjekjesh, duke ua nxjerrë edhe sytë, duke i shpënë shumë prej tyre në burgje ose në spitale psikiatrike. Është e sigurt se Homeri nuk ia ka nxjerrë vetes sytë, po dikush e ka verbuar. Pastaj e kanë detyruar të endet nëpër botë, me barrën e errësirës së përjetshme që t'i argëtojë bashkëkohësit e tij me këngë heroike! Pse nuk e ka lënë asnjë varg të vetëm ku të rrëfente verbërinë e vet? Sigurisht ia kanë censuruar veprën. Po Eskili?! A nuk ka qenë edhe ai i censuruar, i ndëshkuar dhe i dëbuar nga atdheu? E kanë ndëshkuar në atë mënyrë që edhe vdekjen ta ketë sa më banale. Po Dante Aligieri? Ka qenë i dënuar që të digjej i gjallë kudo që të kapej. Dhe është fshehur nëpër shpella si eremit dhe në errësirën e tyre e ka krijuar Komedinë Hyjnore. Po Servantesi? A nuk e kanë burgosur dhe mbajtur peng, madje edhe shqiptarëve u ka ra hise që ta mbajnë si rob në bodrumet e kalasë së tyre? Po Shekspiri, a nuk ka fjetur në shtalla kuajsh dhe madje

pas gjashtëqind vjetësh të vdekjes e kanë shpallur narkoman!? Po Pushkinit, a nuk ia kanë inskenuar vrasjen, që të dukej se gjoja ishte një dyluftim kalorsiak? Po Bodlerin a nuk e kanë bërë që të flasë me vetveten? Po Lasgush Poradecin, a nuk e kanë shpallur të çmendur? Në fund të fundit, cilin shkrimtar të vërtetë, nuk e kanë ndjekur, nuk e kanë dënuar? Hajt! E pas disa kohësh, pasardhësit janë shtirur kinse po i rehabilitojnë dhe i kanë shpallur "ndërgjegje e zgjuar e kombit". Megjithëse edhe ata janë tallur, duke i cilësuar si anakronikë. Jam fort i bindur se pothuajse të gjithë kanë një urrejte të fshehtë për shkrimtarët, sepse veprat e tyre u krijojnë shqetësime, me gjithë ata emra personazhesh, me gjithë ato ide të mpleksura e të fshehta, me ato kompozicione të ngatërruara. Ata nuk janë lexues po janë ndjekës, denoncues, persekutorë potencialë të shkrimtarëve. Unë, me kohë e kam kuptuar se si është kjo punë. E di saktësisht, se lexuesi i mirëfilltë nuk ekziston. Hej, a nuk i kanë falsifikuar edhe shpalljet e Zotit?! I kanë falsifikuar njërën pas tjetrës, sa kanë mundur, deri sa i Madhërishmi ka sjellë shpalljen e fundit, të cilën e mbron vetë me urtinë e Tij. Pra, fjalët lexuesi e falsifikuesi, më duket se kanë pothuajse të njëjtin kuptim. Prandaj, këtë roman po e shkruaj vetëm për veten time, për të shpëtuar nga ankthi i fotografive të kujtimeve, të cilat ngatërrohen vazhdimisht njëra me tjetrën dhe me pamjet e ngjarjeve të tashme, duke u dhënë atyre përmbajtje të keqe dhe duke ma ngatërruar identitetin. Këtë libër po e shkruaj vetëm

për vetveten, për të zhgatërruar atë mbrapshti rreth meje, të uroj që asnjë lexues të mos e ketë. Ç'më duhen lexues të cilët nuk do ta kuptonin mesazhin që do të doja t'ua përcillja?

# VI

Në fund të këtij teksti është një nënshkrim i padeshifrueshëm. Ndoshta germa e parë e nënshkrimit mund të ishte një M e përthyer, e cila mund të perceptohej edhe si një V ose një N e zgjatur. Po më tutje gjithçka ishte në formë të germës u të vogël, dhe vetëm në fund ishte një germë që mund të ishte i ose j e vogël e shkrimit. Po asnjë emër nuk mund të rindërtohej nga ajo firmë e ngatërruar. Aty ishte edhe një vizatim, një kodër e lartë që mbulonte anëpëranë faqen e fletores. Ishte e ngjyrosur me ngjyra druri, të cilat i përdorin nxënësit në klasat e ulëta të shkollës. Dominonte ngjyra e verdhë, ndoshta autori e kishte menduar si peizash vjeshte me gjethe të zverdhura. Po më shumë ishte një shkarravitje me ngjyrë, sesa një ngjyrosje e kujdesshme. Mos ishte bërë përngut?! Në majë të pikturës, atje ku mbase ishte maja e Kodrës së Arës, ishte i vizatuar një dru i tharë, edhe ai i ngjyrosur me ngjyrë të verdhë. A thua ku të jetë kjo Kodër e Arës, në cilin vendbanim, apo mos është vetëm një trillim autorial? Ndoshta ndonjëherë do të gjej kohë e ta kërkoj atë vend, nuk i dihet tash që jemi të lirë mund të shkojmë nga të duam dhe askush nuk na ndalon. Pas kësaj pune me

këtë ekspeditë të çuditshme, ndoshta do të kthehem në vendin e dikurshëm të punës. Atëherë mund të gjej kohë të lirë e të shkoj nga të më teket. Ndoshta do ta kërkoj edhe Ditën në Gjilan, e t'i them ja u ktheva pas dhjetë vjetësh, si Ago Ymeri, edhe unë isha në burg, të gjithë ishim të burgosur, e dashura ime, ja ku më ke, ai nuk ishte grushtshtet siç thoshe ti, po një pushtim i gjatë dhe i skëterrshëm. Bile do ta pyes se a mos i kujtohet asaj në i kemi paguar akulloret a jo, se mua s'më kujtohet kurrqysh. Edhe tash çuditem si ndodhi që nuk u takuam me Ditën më kurrë, që nga ajo ditë kur u ndamë, pak metra larg kordonit të policisë dhe të tankeve që kishin rrethuar parlamentin?!

Oh, sa jam i lodhur! As truri më nuk po më punon. Figura e Ditës po deformohet, po shpërbëhet si platstmasë, po përzihet me helmetat e policëve, me zinxhirët e tankeve. Po ky vizatim ç'është, kjo kodër e shtrembër dhe kjo firmë misterioze. Ku jam? Eudhibilahi mineshejtanirr-rraxhim!

## Testatura

Jam përballë ekranit të kompjuterit dhe me të dy duart e mbaj testaturën, thua se do të më ikë dikah. Nuk kanë nga të më ikin as testatura e as rrëfimi. Germat në testaturë duken krejt pa kuptim në këtë radhitje që kanë: QËERTYUIOP/ASDFGHJKL/ZXCVBNM/. Kur e shikon këtë strukturë të tyre, të shkon mendja se me to nuk mund të bësh asnjë fjalë të vetme, sa mund të krijojë memeci një fjalë të kuptueshme nga hungërimat e tij të palidhura e të çoroditura. Uh, m'u kujtua, në fshatin tim ka qenë një memec, i cili e kishte emrin njësoj si unë, i cili më lehtë mund të rrafshonte Kodrën e Arës se ta shqiptonte një fjalë dyrrokëshe. Kur ai përpiqej të tregonte diçka, unë e shikoja i hutuar, i frikësuar dhe njëherësh kurreshtar. Më duket se shumë herët e pata hetuar se ato hungërimat e tij ishin njëfarë çelësi që zbulonte mrekullinë e të folurit tonë, atë dhuratë që na është e dhënë nga Zoti i Gjithëmëshirshëm. Radhitja e germave në testaturë, kur janë të shtangura, ma kujton atë pamundësi të shqiptimit të një fjale të vetme nga memeci i fshatit tim. Por, kur nisin gishtat të godasin mbi katrorët që dëftojnë shkronjat,

ato përnjëherë bëhen aq të mira sa të duket se vetë germat e sajojnë edhe rrëfimin.

Njësoj është edhe me fotografitë e kujtimeve. Ato shfaqen e rishfaqen të ngrira, të çrregullta, mu si germat në testaturë, sa më duket se nuk kanë asnjë lidhje njëra me tjetrën dhe aq më pak me mua. Notojnë dridhshëm nëpër syprinën e kujtesës, si gjethe a shkarpa që i bart vala e turbullt, të ngarkuara me kuptime dhe me mesazhe të fshehta, të cilat nuk mund të zbërthehen, pa i vënë në njëfarë lidhjeje njërën me tjetrën. Hajt çfarë lidhje ka ndërmjet këtyre pamjeve: një nuse e mpirë, e veshur me të bardha që rri në krye të odës; bora dhe këmbët e mia të skuqura; akulli marramendës përreth pusit të shtëpisë; aroma e papërsëritshme e mollëve në dimër; kotësia e trupit të lepurit të posanxjerrë nga strajca; lëvizja e drurëve gjatë udhëtimit me autobus, me babën; rruga e përbaltur e periferisë së qytetit dhe shikimi kurreshtar i një gruaje të bukur. Buzëqeshja e vajzës që shikon me ngulm nga banka e fundit; shkumësi kërcënues në dorën e profesorit; gërvimat e dërrasës së zezë; rrëzimi i kalit të aktorit kryesor, në një rrugë tërë pluhur. flokët e shprishura të femrës këmbëhapur, shtrirë në baltë; zgërdhirja e pijanecit në kafenenë e stacionit të trenit, pas mesnate; era e rëndë e çorapëve; klithma e një fëmije në turmën që ikë e tmerruar; kollitja artificiale pranë mikrofonit...

A është e mundur që këto fotografi kujtimesh të krijojnë harmoni si germat e testaturës dhe të

krijojnë rrëfimin që dua ta nxjerrë nga vetja? Si t'i lidh, si t'ua zbuloj enigmat?

Si ruhen këto fotografi kujtimesh, kur ngjarjet më nuk ekzistojnë. Nuk ekziston as kujtimi i plotë, po vetëm një fragment i tij, si copë e një qeramike të thyer. Kot përpiqem t'i gjej copat e tjera, ato i ka mbuluar dheu i harresës. Fjala vjen, ajo pamje kujtimi për nusen me pamje të ngrirë në odë, nuk ka asnjë lidhje me kujtimin e plotë: kur ka ndodhur, kush ka qenë ajo nuse, çfarë dite ka qenë, çfarë dasme është bërë, a ka qenë pasdite apo paradite... Gjithçka tjetër është pezull, përveç pamjes së ngrirë të nuses së panjohur. Lidhja ndërmjet fotografive është disi e mistershme. Lidhja artistike është shumë e fortë, si lidhja ndërmjet germave të tastaturës dhe kur duket se krijohet nga copa krejt të shkëputura të kujtimeve dhe të ëndrave të jetës sonë, ajo është unike. Nëse autori e ka kaluar rrezikun e mosnjohjes së vetes, atëherë e ka më lehtë. Por, mosnjohja mundet vetëm me njohje të sërishme, të vazhdueshme e të përhershme. Njohja e vetes kalon nëpër rrugën e vështirë të herrjes së bimëve të këqija që janë mbjellë në ndërgjegje, nga mësimet dhe ideologjitë e mbrapshta. Edhe ky rrëfim është një rrugë për të mundur mosnjohjen e vetes, për t'u kthyer në identitet.

# VII

Për t'u kthyer në identitet? Te kjo fjali e ndërpreva leximin. Sërish ndieva lodhje të madhe. Mbase dita e gjatë me plot tmerre që kisha parë me sytë e mi, jo vetëm që më kishte këputur, po më kishte shkatërruar edhe kërshërinë e zbulimit të të fshehtave të një dorëshkrimi, sado interesant që të ishte.

Gjatë leximit, nganjëherë më dukej se e njihja stilin e këtij shkrimtari, por për ta gjetur se kush mund të ishte autori, e kisha të pamundur. Askund nuk kishte ndonjë shënim për autorin. Kur e mbylla fletoren, Naseri u tregua kurreshtar të dinte se çfarë shkruante në fletoren që unë e bartja me vete ngado që shkonim. U përpoqa t'ia tregoja përmbajtjen, por nuk m'u duk se kuptonte. Anglishtja e tij vërtet ishte e mjerë, po as unë nuk mund të lavdërohem se e di shumë mirë. Nga ana tjetër, edhe po ta dinim të dy mirë anglishten, përmbajtja e prozës që lexoja ishte disi e pakapshme, e pashpjegueshme me fjalë të thjeshta. Ishte fjala për një rrëfim ku përziheshin koncepte estetike, etike dhe fetare. Kur e futa fletoren në çantë, edhe Naseri duket se e kuptoi se nuk kisha çfarë t'i shpjegoja më tutje. Çfarë t'i

shpjegoja atij kur as vetë nuk po kuptoja ndonjë gjë. Bëra një gjumë plot ankthe. Herë më dukej se isha i fshehur në bodrum dhe numëroja çastet e fundit të jetës sime, ngase policët po më gjurmonin, herë më dukej se i ngjitesha asaj Kodrës së Arës - Kodrës së Botës përpjetë dhe mbetesha pa frymë. Fytyra e një gruaje shtatzënë, puset e rrethuara me shirita të kuq, oxhaqet e nxira, muret e mbetura si gojë të vdekurish të mbetura hapur, të gjitha përziheshin e nuk më ndaheshin si një lukuni ujqish.

Pse po më rritej turbullimi më shumë këto ditë, në liri, se në ato ditë që isha i fshehur në bodrumin e shtëpisë në lagjen Vellusha dhe nuk e dija se a do të shpëtoja gjallë? Ato ditë i isha kthyer vetes më shumë, lutesha orë e çast dhe qetësia në shpirt me vinte si një fllad ere, e ndieja se si ma përshkonte edhe trupin. Ndërsa këto ditë, unë gati kam harruar të lutem. Më fal, o Zot!

# Baba

Ditëve të tregut baba kthehej pak para muzgut, kur ne të gjithë ishim ende nëpër oborr, nëna duke rendur pas punëve, ndërsa ne fëmijët të dhënë pas ndonjë loje të stinës. Zakonisht zbriste nga kodrina përballë shtëpisë, nga Shpati. Në atë zbritje të ngadaltë dhe të lehtë Shpatit, më dukej se më shumë lëvizte nëpër ajër se sa që ecte nëpër tërthoren e ngushtë. Gjithmonë ndieja një gëzim të lëngët dhe të ngrohtë kur e shihja babën që po afrohej oborrit të shtëpisë me atë lëvizje fluturuese. Dhe gjithherë e vëreja se në kokë i shndriste plisi dhe shalli i bardhë si bora. Atë plis të bardhë baba e vinte në krye vetëm ditëve të tregut, kur shkonte në Prishtinë, dhe ditëve të premte, kur shkonte në xhami. Ndërsa ditëve të tjera, në krye kishte një plis tjetër, të zhubravitur, të mbështjellë me një shami bojëkafe, në cepat e të cilës ishin të vizatuara, me ngjyrë të verdhë, ca forma gjethesh të kumbullës.

Por, kur kthehej nga qyteti, nuk i shkëlqente vetëm plisi i bardhë, po edhe fytyra. Ulej në oborr, nën kurorën e madhe të dardhanës dhe nëna ia sillte shpejt e shpejt ujin për të marrë abdes. Merrte abdes ngadalë, me një qetësi solemne, duke pëshpëritur

ndonjë lutje, po fjalët nuk i dilnin. I mbante duart të mbështetura në gjunj dhe këmbët vetëm në shputa, deri sa i rridhte uji i fundit prej tyre. Mandej ngrihej dhe futej në odë dhe falte akshamin. Ne rrinim ende në oborr nën kurorën e madhe të dardhanës dhe shihnim se muzgu gjithnjë e më shumë po e shtrinte gëzofin e vet të errët. Pastaj baba dilte sërish në oborr dhe ne fëmijëve na shpërndante bonbona të larme, të cilët i nxirrte nga zemili. Na i zgjaste në një mënyrë të veçantë, me një buzagaz dhe me një lëvizje dore të lehtë, ledhatuese. Fliste me një zë të ulët sa mezi e dëgjoja se çfarë i tregonte nënës për rrugën, për tregun që kishte bërë dhe për njerëzit e njohur që kishte takuar në qytet. Edhe pse muzgu shndërrohej në një rrëshirë të trashë, unë mund të them se e shihja fort qartë fytyrën e babës, me atë qetësi të shtrirë në tërë fytyrën e tij. Kjo fotografi më lëviz nëpër kujtesë më së shumti, kur kam një mall ose një mërzi. Ajo qetësi e babës dhe lutjet e tij, sikur më përshpërisin një mesazh të fshehtë vetëm për mua.

Netëve të dimrit baba rrinte në cep të shtratit, pranë stufës. Në drurin e gjerë e të lëmuar, që e ndante shtratin nga pjesa e pashtruar e odës, linte kutinë e duhanit, shkrepëse dhe kamishin e qelibartë. Pinte duhan në një qetësi të thellë, ndërsa jashtë era ulërinte dhe dera ciaste me një ankim të frikshëm.

- Nuk i vumë pak kallamaz kësaj dere!- ankohej nëna. Ai nuk përgjigjej. Jo vetëm ndonjë ankesë si kjo, po edhe ndonjë pyetjeje, ai i përtonte t'i përgjigjej. Ftohtësia e dimrit sikur kishte një lidhje të padukshme me fjalët e tij, ato ngrinin dhe nuk mund

të lëviznin, mësa hejet e akullit që vareshin nga strehët e shtëpisë. Dikur vonë merrte fenerin dhe shkonte në ahër, për t'ua mbushur grazhdin lopëve për natën e gjatë të dimrit. Kur kthehej, lëshonte ca klithma drithëritëse nga të ftohtit dhe i qepej stufës që ishte në të shuar, po prapë nuk fliste ndonjë fjalë. Edhe kur kishim mysafirë në odë, ai i ulur përballë tyre, i shikonte me një butësi dhe i dëgjonte disi i ngrirë. Fliste rrallë, disi duke u luhatur dhe duke i shikuar mysafirët si me radhë. Ama fliste shumë rrallë, thuajse fjalët e tij nuk po shkriheshin. E kishte zakon të hiqte plisin dhe të kruante kokën lehtë. Flokët e thinjura i vezullonin si borë e shtrirë mbi degë pemësh. Pyesja veten: a thua i ka pasur ndonjëherë flokët e pathinjura? Atë fotografi do ta ketë përpirë harresa, ngase deri tash do të duhej ta kishte shpërthyer terrin. A thua a kishte ndonjë lidhje ndërmjet asaj ngrirjeje të fjalëve të tij gjatë stinës së dimrit dhe vuajtjeve që kishte përjetuar në dimrin e vitit 1955 nga policia, në atë terrorin që e quanin aksioni i armëve? Nëna tregonte se kur ishte kthyer në shtëpi, tirqit i ishin ngjitur për lëkure, sepse kishin ngrirë. Nënës i ishte dashur që t'i lagte ngadalë me ujë të valë, për t'i shkrirë akujt e tirqve e për t'i shkëputur prej mishit të trupit të babës. Nëna tregonte se ai nuk kishte lëshuar asnjë klithmë, asnjë pasthirrmë.

- Rrinte krejt i ngrirë, as eh as oh, ndërsa mua më shkonte mendja se mos është bërë i tëri një copë e madhe akulli. Edhe kur shkrihej akulli nga tirqit e ndahej nga mishi i trupit të tij, ky mbetej i ngrirë, as

eh as oh, madje as frymë më dukej se nuk merrte, po edhe në atë derexhe e përkujtonte Zotin, përsëriste nëna.

# VIII

Ndiej kënaqësinë e këtij çasti i cili më mundëson që ta adhurojë All-llahun e Gjithëmëshirshëm, ndiej kënaqësinë e këtij çasti i cili më mundëson që ta adhurojë All-llahun e Gjithëmëshirshëm, Nuk nxjerr fjalë as nuk pëshpëris. Vetëm me mendim i them këto fjalë, vetëm me mendim i përsëris. Jo nuk i përsëris unë po ato përsëriten vetvetiu, ndërsa policët janë brenda në bodrum, as dy metra larg strofullës sime dhe mjafton të heqin dy dërrasa dhe të më kapin, të më gjejnë, të më rrjepin të gjallë. Njëri shan rëndë serbisht se nuk ka asgjë të hajrit në bodrum, vetëm miell, vaj, sheqer e kripë me thasë, e nuk ka as cigare as raki. Tjetri thotë se është mirë që ka miell e vaj dhe thërret dikë me radiolidhje, me zë të tmerrshëm, ulëritës si të ujkut sypërgjakur, jep adresën ku gjenden, thotë silleni shpejt një traktor se shtëpia duket si një depo mallrash, i treti, ( po po, tre janë) flet fjalë të ndyra për të zonjën e shtëpisë, diçka të nevertitshme për ta pranuar truri. I pari shtyn do dërrasa më tutje dhe sërish ankohet se në këtë shtëpi nuk ka raki.

Marr frymë ngadalë-ngadalë dhe rrallë përpiqem të mos mendoj për frymëmarrjen, se kur mendoj për

të, më duket se më mungon fryma, e frymëmarrja më shpejtohet, e ashtu mund të më shkaktojë ndonjë kollë, ndonjë lemzë a ndonjë hata tjetër. Mbaj sytë mbyllur se kështu më duket më lehtë, disi qetësia shpirtërore më ekuilibrohet me sy mbyllur dhe me mendime në lutje të thella. Edhe këto çaste janë pjesë e jetës sime që më është dhuruar nga Krijuesi im, këto çaste m'i ka dhuruar si sprovë, më sprovon me durim dhe nëse duroj, do të jem fitimtar. Në më mbulon frika, atëherë, jo, jo, nuk kam frikë, nuk kam aspak frikë, ndiej kënaqësinë e këtij çasti i cili më mundëson që ta adhuroj All-llahun e Gjithëmëshirshëm, ndiej kënaqësinë e këtij çasti i cili më mundëson që ta adhuroj All-llahun e Gjithëmëshirshëm. Më duket se më lëviz nëpër tru verseti 152 i sures El-Bekare "Pra, ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shpërblime), më falënderoni e mos më mohoni.", dhe më qetëson e më bën të durueshëm, të bindur se nuk do të më gjejnë, se do të shpëtoj. Në bodrum bëhet rrëmujë e madhe, dëgjoj shumë hapa që zbresin e ngjiten shkallëve, bartin thasët, shtyhen me njëri-tjetrin, shajnë, zgërdhihen, rrapllojnë. Nuk ua vë veshin shumë, marr frymë ngadalë e rrallë, mbaj sytë mbyllur dhe thellohem në lutje. Këtu ku jam tash me mendje e me shpirt, kurrë nuk mund të më gjejnë e aq më pak të më prekin me dorë. Kështu shpëtova e jam këtu ku jam.

Naseri më shikon me habi, dredhë kokën e buzëqesh hutueshëm.

- Si e krijove atë fjali në kokë?- më pyet.

- U krijua vetë. Dhe kur u krijua e plotë, e fuqishme, si një ujë i rrëmbyeshëm që me ushtimën e vet pushton gjithçka, vërtet ndieja kënaqësinë e secilës sekondë që jetoja, i trimëruar dhe i bindur se nuk do të më ndodhte asgjë. Ishte e çuditshme.

- Po policët nuk rrotulluan dërrasat?

- Jo. Isha i bindur se i pengonte lutja ime.

- Po kur dolën ata, a ndjeve ligështim?

- Ku e di ti?

- Thonë se kur kalon rreziku direkt, njeriu ligështohet më shumë.

- Vërtet, pastaj pata një dridhje të tërë trupit, dhembje të muskujve. Isha i rraskapitur, mezi ngihesha frymë. Pulsin mezi e numëroja, sepse ishte dobësuar e ishte ngadalësuar shumë puna e zemrës. Këmbët më ishin ftohur aq shumë sa kur i prekja me dorë, më dukej se prekja copa akulli. Është e pamundur të përshkruhet se si ndihesha.

- Natyrisht që është e pamundur.

- Po pse?

- Sepse ne nuk e kemi në dorë atë punë - tha Naseri me një zë triumfues.

# Nëna

Nëpër oborrin e pjerrtë të shtëpisë nëna lëvizte vazhdimisht, sa në një skaj - në tjetrin, si një flutur vere. Shamia bojëkafe ia mbulonte vetëm njërën pjesë të kresë, ndërsa flokët e ngjyera me kanë i jepnin një shkëlqim të lehtë tërë fytyrës së saj të gjerë. Më dukej se ajo e mbulonte tërë oborrin e shtëpisë sonë me pamjen e saj dhe me lëvizjet e saj të pandërprera, sa te koteci, sa tek ahuri, sa te bunari, sa te cungu i druve. Nxitimi i saj bëhej më i shqetësuar sa më afër që vinte muzgu. Sikur të ishte një marrëveshje e fshehtë e saj me kohën. Më dukej posaçërisht fluturuese kur shkonte drejt qilerit me kusinë plot me qumësht. Ishte një gëzim i saj të cilin unë e ndieja megjithëse nuk e kuptoja arsyen. Falej dhe pastaj dilte me një hap të lehtë, disi më e gëzuar dhe na e shtronte sofrën, duke folur për gjëra të ndryshme me babën. Netëve të verës, në të njëjtën kohë e hanim darkën dhe pastaj binim herët në gjumë. Gati duket e pabesueshme, po sa herë shoh ndonjë oborr të gjerë, të rregulluar dhe disi të pjerrët, është e pamundur të mos më shfaqet kjo fotografi kujtimi për nënën.

Netëve të dimrit, kur binim për të fjetur dhe era fishkëllonte jashtë, nëna na tregonte përralla mua dhe vëllait tim më të vogël. Ishin disa rrëfime të çuditshme, me kuçedra, me kallakangja, me dragonj dhe me një motër me nëntë vëllezër, e cila ishte shndërruar në qyqe, me një vëlla të vogël që kalonte nëntë bjeshkë dhe e merrte nusen më të bukur në botë... Ajo fliste prajshëm, me një zë disi të mekur, që mua nganjëherë më dukej se dilte nga errësira e natës. Për dallim nga baba, të cilit i kyçej goja në stinën e dimrit, nëna ishte më e gjallë, fliste tërë ditën duke na treguar edhe për gjëra, të cilat unë dhe im vëlla as që i kuptonim plotësisht. Nga të gjitha ato, tregimet i mbaja mend dhe më silleshin nëpër mendje tërë kohën. Në një mënyrë të pakuptueshme. Mendja ime prodhonte variante të tjera nga ato që më tregonte nëna dhe pas njëfarë kohe mua më dukej se unë isha ai që i kisha sajuar vetë ato rrëfime.

- Ajo që i bën të përbashkëta fotografitë e kujtimeve për babën dhe për nënën është ndjenja e unitetit të vetvetes, njohja e vetes. Jo vetëm tash, po këtë ndjenjë e kam pasur sa herë kam qenë pranë tyre. Edhe në këtë kohë të vështirë, kur nuk i dihet se a më çelë dita, fotografitë e kujtimeve për ta më mbajnë gjallë.

# Dardhana

- Nga Shpati për orë të tëra e shikoja kulmin e gjatë dhe të mbuluar me tjegulla të kuqe, me tre oxhaqe të larta, gjithë të nxira në majat e tyre dhe më dukej se ishte aty prej fillimit të fillimit, kur kish nisur jeta në tokë. Ky kulm shtëpie, që nga fillimi i fillimit ishte shtëpia jonë, shtëpia e Hasanit të Ajvazit, Hasan Gjakovës. Kushdo që kalonte nëpër Shegëz, e njihte atë kulm me tri oxhaqe të larta dhe e dinte se ajo ishte shtëpia jonë. Kurrë askush nuk kishte nevojë të pyeste e kujt është kjo shtëpi, madje as udhëtarët që kalonin për herë të parë nëpër Shegëz. Unë këtë e dija pa ma thënë. E shikoja me orë shtëpinë tonë nga Shpati dhe zemra më mbushej me një gëzim që më dukej se buronte nga kraharori e shpërndahej pastaj në të gjitha anët. Filloja të zbërtheja fshehtësitë që dija për çdo skutë të shtëpisë sonë dhe të bëja pyetje pse është kështu e pse ashtu. Pse baba e linte një kënatë me ujë dhe një gotë çdo mëngjes në pjesën e jashtme të murit të shtëpisë? Kalimtarët shpesh ndaleshin, pinin ujë dhe pastaj e vazhdonin rrugën e tyre me ngut. Pse dardha plakë (gjyshi i thoshte dardhanë) ishte aq e vjetër me trung të gërryer në mes, po askush nuk mendonte se duhej

prerë? Çfarë lidhje kishte mosha e saj me fatin tonë? A thua vendi ynë me të vërtetë është quajtur Dardhana a Dardana, sipas emrit të kësaj dardhe?

- Sa herë që këto pamje më lëvizin në kujtesë, e di se duhet të analizoj, se mos ka ndryshuar bindja ime rreth rëndësisë së vatrës, të shtëpisë, nën trysninë e kësaj që e quajmë jetë urbane. Jetë urbane?! A thua u bëka jeta jonë më urbane vetëm pse jetojmë në rrokaqiej të lartë, pa kulme, pa oxhaqe, pa oborre, pa pemë të vjetra, pa mure rrethuese të shtëpisë? Me Agimin, njëherë po bisedonim në këtë temë dhe ai kaq shumë ngulmonte se duhet të braktiset e kaluara, se duhet të "urbanizohemi". Atij i dukej se me zërin që sa vinte e i ngrihej, po më çarmatoste krejt.

- Prej nga është njeriu që ka lindur në Klinikën Gjinekologjike? - pyeta në një çast, kur ai po bënte njëfarë rezymeje të idesë së tij.

- Urdhëro? A! Kjo nuk është edhe aq e rëndësishme. Njeriu lind këtu e aty dhe varet se çka bën më tutje. Kjo është puna.

- Po a nuk është fare me rëndësi se prej nga është?- ngulmova, i bindur se po binte në rrjet.

- Nuk është me rëndësi!- ma ktheu i revoltuar. Isha i bindur se nuk mendonte ashtu, po pyetja ime kishte qenë krejt e papritur dhe ai nuk po e gjente një përgjigje.

- Është shumë me rëndësi, Agim! Nuk ka identitet njeriu që nuk e ka një vendlindje, që nuk e ka një shtëpi, nga e cila buron identiteti i tij për të tjerët dhe për veten e tij. Për hunjtë e gardhit mund

të jetë pa rëndësi se ku ngulen, por për njeriun është me rëndësi se ku e ka rrënjën. Kriza e identitetit e ka një shkak të fortë pikërisht në këtë pikë.

- Frojdi nuk e ka analizuar dhe nuk i ka kushtuar ndonjë rëndësi kësaj rrethane.

- Frojdi?! Çfarë Frojdi, Agim? Njeriu i parë, Ademi, sapo ka zbritur në tokë, ka ngritur një shtëpi dhe një familje. Ka pasur identitet të vetes dhe të familjes. Një identitet të vatrës. Ndoshta nuk i beson përrallat se njeriu i parë ka jetuar në shpella, në drunj e ku ta di unë!

- Pse të mos i besoj. Ajo është shkencë.

- Cili shkencëtar paskësh jetuar në atë kohë për të lënë dëshmi të argumentuara, Agim? Ajo nuk është shkencë, ato janë trillime. Identiteti i njeriut është i mbrujtur në qenien e tij që nga fillimi i fillimit. Në materien me të cilën është krijuar njeriu është i njësuar vetë kuptimi i jetës dhe i misionit të tij.

- Nuk di. Por jeta urbane është kjo që e kemi sot dhe nuk mund të rikthehemi në të kaluarën.

- Vlerat themelore të jetës sonë nuk mund të ndahen në të tashme dhe të kaluara, Agim. Ka disa vlera që janë të përhershme. Familja është e tillë.

- Nuk e di! - ma ktheu Agimi dhe u ngrit për të më dhënë të kuptoja se po largohej disi i fyer nga kjo bisedë.

Derisa po e mbyllja storien me Agimin, më dukej se vërtet isha ulur në Shpat dhe po e shikoja ngeshëm kulmin e shtëpisë dhe tri oxhaqet e larta të tij, që ngriheshin si karakollë mbrojtëse të jetës sonë.

Jashtë qarkut të saj, asgjë nuk ishte ashtu si duhet. Më dukej se një fantazmë e frikshme zgjaste kthetrat e saj drejt meje, duke ma mbushur shpirtin me frikë, pasiguri dhe mosnjohje. Jashtë saj bota ishte e kthyer me kokë teposhtë.

# IX

Naseri mezi pret që unë të mbyll fletoren dhe t'i tregoj se si vazhdon rrëfimi. Filloj t'ia shpjegoj me fjalë më të zgjedhura dhe me një mënyrë më të koncentruar. I tregoj se është një përshkrim i kujtimeve për familjen shqiptare, për ambientin e qetë dhe të dashur të fëmijërisë së këtij shkrimtari të panjohur. I tregoj se ndihet prirja fetare islame e autorit dhe ai habitet shumë.

- Kam menduar se këtu është mbjellë fara e komunizmit dhe nuk ka pasur asgjë tjetër - tha Naseri.

- Familjet në fshat kanë qenë më rezistuese dhe kanë ruajtur vlerat e veta - i thashë.

- Ne nuk e kemi një ide të qartë për këtë komb - foli ai mendueshëm. U desh të ndodhte gjithë kjo tragjedi që ta njihnim. Dhe në fakt ne as tash nuk e njohim shpirtin e tij. Ja ky libër rrëfen më shumë se këto shtëpi të shkrumbuara.

Nuk di çfarë t'i them. Pas pak Naseri fillon të gërhasë. Është 15 qershor 1999. Në fshatin ku jemi sonte banorët tashmë kanë filluar të kthehen. Edhe këtu gjatë ditës pamë skena të dhimbshme. Në një familje që u kthye nga Shqipëria mungonin tre

burrat e shtëpisë, të cilët i kishin ndarë nga familja më 28 mars dhe nuk dinte askush gjë për ta.

- Djemtë ku i kam, amani! - na lutej plaka e shtëpisë. A janë kund a më ka mbuluar zia për gjithmonë, oj loke!

- Ne nuk dimë për këtë, ne jemi vetëm për ndihma humanitare - përpiqesha t'ia shpjegoja, po ishte e kotë.

- Nuk më duhen batanija, po djemtë, oj loke! - ngulte këmbë plaka me një zë të dridhur e inatçor nga dhimbja.

- E kisha të pamundur të mos qaja. Dhe si mu gjet ky dorëshkrim, që të ma lehtësojë një grimë mërzinë.

# Darvini

Kur mësonim në lëndën e biologjisë për prejardhjen e njeriut nga majmuni, mbaj mend se pas mbarimit të orës së mësimit, të gjithë shokët dhe shoqet e klasës dukeshin të trishtuar. Cingërima e ziles nuk na e shkaktonte atë padurimin e rëndomtë, me të cilin turreshim për të dalë nga klasa në oborr, duke zënë në thua nganjëherë edhe në arsimtarët tanë. Ishte një topitje, e cila na i vështirësonte edhe lëvizjet e gjymtyrëve. Kisha frikë t'i shikoja duart e mia, nga frika se mos ishin deformuar dhe mos ishin pushtuar nga leshra të trasha e të murrme. Madje edhe Sania, çupa më e bukur e shkollës, dukej si një fotografi e zhubravitur, dhe ishte gati të shkrehej në vaj. Vetëm fytyrën e saj guxoja ta shikoja më gjatë, sepse vazhdonte të ishte shumë e bukur, edhe pse ishte tërësisht e përmbytur nga trishtimi. Sania endej e hutuar nëpër oborr në pushimin e gjatë në mes të orës së dytë dhe të tretë dhe unë e shikoja me një pikëllim që më dukej se më dilte nga bebëzat e syve dhe ma errësonte pamjen, ku humbte jo vetëm shoqja e bukur e klasës po edhe peizazhi i fshatit në atë stinë pranvere. Edhe nxënësit e tjerë endeshin nëpër oborr disi të shushatur dhe pa atë gjallërinë e

zakonshme që sillte pushimi i gjatë në mes të orëve. Vetëm Nazi, të cilin e konsideronim si të marrin e klasës, vejevinte sa te njëri sa te tjetri, me gajasjen e tij të pandryshuar dhe prirjen për të ngucur me gjeste secilin që mund ta mbërrinte.

Prej nga vinte ky hutim i përgjithshëm i tërë klasës? Arsimtari na kishte thënë se "njeriu e ka prejardhjen prej majmunit" dhe kishte folur për "ligjin e evolucionit", për "Darvinin e darvinizmin", për dofarë fosilesh e gjëra të tjera që nuk kam mundur kurrë t'i ndjek me vëmendje deri në fund. Fjalët e tij fillonin e shndërroheshin në një ungurimë të frikshme dhe pamja i bëhej gjithnjë e më e rëndë. Kur vizatonte në dërrazë të zezë majmunin, trupi i dridhej nga lëvizjet e shpeshta dhe kërrusej gjithnjë e më shumë, derisa bëhej gati krejt kruspull, (oh, gati sa i përngjante ...atij!). Merrte frymë gjithnjë e më rëndë, aq sa dikur ajo i shndërrohej në një dihatje të frikshme. Arsimtari i biologjisë ishte astmatik, sepse ishte nga ata duhanxhinj, të cilët vetëm sa nuk flejnë me cigare në gojë. Por, mua më dukej se dihatja e tij më shumë se me sëmundjen e astmës, kishte të bënte me atë vizatimin e shëmtuar që bënte në dërrasë të zezë, duke u gërmuqur për tmerr.

- Si është e mundur? - pyesja veten.

- Nuk është e mundur!- më thoshte një zë, që kreshpërohej tërë inat brenda meje.

- Arsimtari nuk gënjen!- nxirrte krye një mendim tjetër idhnak.

- Arsimtari nuk gënjen, por e tregon një gënjeshtër të atij Darvini. Ai Darvini po e merrte në qafë ar-

simtarin tonë të biologjisë, i cili detyrohej të gërmuqej dhe të dihaste nga mundimi, aq sa i përngjante... atij!

Askush nuk pajtohej me këtë gjë, por ishte e vështirë ta shprehje me fjalë, t'i jepje kuptim e formë pakënaqësisë, mospajtimit. Me cilat fjalë mund të shprehej ajo dhembje e shpirtit, ai hutim ngulfatës që të topitte trupin? E shikoja gjatë e gjatë fotografinë e majmunit në librin e biologjisë në faqen 124, dhe mundohesha të kuptoja diçka. Sytë e tij të përhumbur, që dukej se lëviznin edhe në fotografinë e murrme, nuk kishin asgjë njerëzore. Koka leshatuke, e pjerrtë dhe vezake, mund të ishte gjithçka tjetër, veçse jo një formë që mund të shpërndërrohej në një kokë njeriu. Jo vetëm qindra miliona vjet sa thoshte arsimtari se kishin kaluar për t'u bërë ai shpërndërrim, por as mija miliona vjet nuk do të ndihmonin, që ajo kokë e shëmtuar të shndërrohej në një kokë të bukur, si të Sanies.

- Po pse ai farë Darvini e kishte sajuar atë gënjeshtër të tmerrshme, me të cilën e bënte të trishtohej secilin njeri? - pyesja veten dhe buza më shkonte në vaj. Përfytyroja mijëra e mijëra forma të shndërrimit të një mase në një formë të fytyrës njerëzore, të bukur si fytyra e Sanijes, vetëm e vetëm që të shkulja me rrënjë atë mendimin për prejardhjen e njeriut nga majmuni i shëmtuar, që zgërdhihej me tërë inatin çnjerëzor në librin tim të biologjisë, në faqen 124. Por, ishte e vështirë ta shkulja atë mendim torturues. Për më tepër, më ndodhte që fytyrat e shumë njerëzve që vinin mysafirë në shtëpinë tonë

t'i krahasoja pa dashje (oh, sa gjë e turpshme!) me vijat e fotografisë së majmunit të faqes 124 të librit të biologjisë. Kishte ndonjë burrë, si Xufi, që ishte përherë i parruar dhe fytyra i dominohej nga leshrat e ashpra e tmerrësisht të zeza, dhe vetullat që i dilnin nga plisi i bardhë pothuajse i prekeshin me flokët dhe prandaj... kisha frikë ta shikoja më gjatë sepse mund të më përngjante me atë... Ndonjë tjetër kishte ca buzë të trasha e të murrme, si të enjtura dhe dhëmbë të verdhë, gati tërësisht të verdhë, me ndonjë zgavër në mes të tyre, në vendin ku ndonjëri nga dhëmbët i kishte rënë. Por, unë shpejt e hiqja shikimin nga ato fytyra provokuese dhe mendoja për diçka tjetër, më së shpeshti për fytyrën e bukur të Sanies, e cila më formësohej në mendje me një lehtësi të çuditshme.

Në orët e biologjisë lutesha e lutesha që kur të më vinte radha për notim, vetëm ajo temë për prejardhjen e njeriut nga majmuni të mos më binte, sepse kisha frikë prej fjalëve që duhej të thosha, sepse im atë, shpeshherë tregonte me zërin e tij të prajshëm, se njeriun e parë, Ademin, Zoti e ka krijuar nga dheu, ndërsa Havën e kishte krijuar nga brinja e Ademit. Rrëfimi i tij, për dallim ngë rrëfimi trishtues i arsimtarit të biologjisë, ishte disi solemn dhe i këndshëm. Baba thoshte se njeriun Zoti e kishte krijuar për ta vendosur si zëvendësin e tij në Tokë dhe të gjitha gjallesat shtazore e bimore i kishte krijuar që të ishin në shërbim të tij. Baba thoshte se njeriu ishte krijesë e dashur e Zotit, e pajisur me mendje dhe me udhëzime të qarta, se si duhej të jetonte e të fitonte

lumturinë në këtë botë dhe parajsën në botën e përjetshme.

Im atë rrëfente për njeriun e parë, Ademin, me një ton miqësor, si për një njeri që pothuajse e kishte njohur edhe vetë. Në përfytyrimin tim të një fëmije kurreshtar për gjithçka, kjo ndjejnë e babës, më jepte një besim se edhe unë isha me vlera të larta dhe se e kisha mbrojtjen e Krijuesit, të cilin e adhuroja me lutjet që m'i mësonte nëna. Por, vinte e marta dhe ora e biologjisë, e cila si një lopatë e stërmadhe përmbyste përfytyrimin tim për dhuntinë hyjnore të njeriut. Kurrë nuk e kuptoja se si nuk e harronte, të paktën një herë, atë copë mësimi, po gjithmonë sillej e mbështillej rreth saj? Pse i pëlqente të fliste për prejardhjen nga majmuni?! Për të na torturuar? Apo pse besonte në atë gënjeshtër? Arsimtarin e biologjisë fshatarët e quanin "Rremë majmuni" dhe "Rremë komunisti" dhe kur e thonin këtë shprehje, qeshnin me lezet, por disi shikonin anash si të frikësuar.

- Pse kanë kaq frikë këta burra, kur e përmendin emrin e arsimtarit të biologjisë? - pyesja veten, po përgjigje nuk gjeja. Arsimtari i biologjisë vazhdonte të fliste, në çdo orë, me zë të lartë për prejardhjen e njeriut nga majmuni dhe të gjithë e kishim frikë.

Në njërën nga orët e biologjisë arsimtari Rremë më tha të ngrihesha në këmbë dhe të dilja te dërrasa e zezë. Dola me një hap të dridhshëm dhe pamja disi m'u errësua. Mezi e gjeta shkumësin dhe zura vendin aty ku na urdhëronte arsimtari që të rrinim kur na pyeste për not. Trupi më dridhej nga frika, nga një frikë e çuditshme e lodhëse, që më errësonte pamjen

e syve dhe që më zhgrehte në vaj. Nuk e di pse isha krejt i sigurt se do të më pyeste për prejardhjen e njeriut, dhe vërtet zëri urdhërues i arsimtarit e tha pikërisht atë temë. U përpoqa ta shikoj arsimtarin, pastaj klasën, u përpoqa që të kujtoja mësimin, por ishte e pamundur. U zhgreha në një vaj me zë të lartë, i cili e çuditi edhe arsimtarin. E vërejta kur u nis drejt meje për të më goditur shuplakë, po nuk bëra asnjë përpjekje për ta ndalur vajin. Shokët dhe shoqet e klasës më shikonin të shastisur, përveç Nazit, zëri i të cilit bëhej gjithnjë e më i hareshëm. Arsimtari u afrua shumë, aq sa m'u duk se u ngjit për trupin tim, ma dha një shuplakë, e cila m'u duk si një unë e zjarrtë dhe më bërtiti:

- Shko në vend, majmun!

Me një hap të dridhshëm, gati pa e parë mirë hapësirën ndërmjet bankave, shkova dhe u ula në vendin tim. Vaji m'u ndal përnjëherë, si të ishte dikush brenda meje që e kurdiste si një orë muri. Në shpirt ndieja një gëzim të turbullt, të papërjetuar ndonjëherë më parë. Isha i lumtur që nuk kisha folur për prejardhjen e njeriut nga majmuni. Më dukej se kisha shpëtuar nga kthetrat e tij dhe nga ata sy të papërmbajtje, të cilët nga fotografia në librin e biologjisë, derdhnin një trishtim të papërshkruar.

# X

E mbylla fletoren dhe një kohë mbeta si i mpirë. Mpirja më filloi nga duart po pastaj më përfshiu edhe këmbët edhe kokën, e veçmas sytë ndienin një mpirje rënduese.

Ç'të ishte ky autor kaq i çuditshëm? Mos kishte parandier se do të ndodhe hataja, për shkak të çoroditjes së njerëzve që kishin përmbysur ligjet dhe kishin imponuar një rregull tërësisht çnjerëzor? Më dukej se e ndieja një zë që thoshte se ky ishte një paralajmërim, po askush nuk ia kishte vënë veshin derisa ndodhi hataja.

Sot nga mesdita në fshatin Shkurraj na u afruan dy pleq dhe na treguan hatanë që kishin përjetuar banorët. Vetëm ata të dy kishin mbetur të fshehur në një stallë, ndërsa të tjerët i kishin dëbuar policët serbë. Njëri plak na rrëfeu se i kishte shikuar nga një kënd i tavanit të stallës.

- Nuk bën vaki me pa aso egërsie, burra! Qëllonin gratë e fëmijët me shkelma e me çka mundnin dhe ulërinin si bisha. Njeriu nuk bën ashtu. Po ata nuk ishin njerëz, nuk di çka ishin. Gjynah të thuhet se ishin njerëz. Plaku ishte i zbehtë në fytyrë, i kërrusur tej mase dhe me një shikim të

përhumbur. Ai tjetri vetëm heshtte dhe miratonte me kokë fjalët e të parit. Mbahej për një kërrute me gjemba në mes dhe mua më dukej se çdo çast mund të përmbysej përtokë.

# Marksi

Fotografia e Karl Marksit zinte gjysmën e faqes së librit të historisë. Mjekra e madhe, e tëra e thinjur, si një bashkë leshi në furkë, flokët e kërleshura dhe sytë depërtues më bënin ta shikoja gjatë, me një përpjekje për të kuptuar diçka më shumë nga ajo pamje enigmatike. Përpiqesha të gjeja përgjigje se për çfarë shkaku flokët e tij ishin të kërleshura, ndërsa mjekra e krehur me elegancë. Përpiqesha të kuptoja pse ballin e kishte shumë të gjerë, të rrafshtë, si të mbushur me tul, ndërsa qafën e kishte të hollë, sa mezi e mbante tërë atë kokë të madhe? Dhe mbi gjithçka, ishin sytë e tij, tepër depërtues, që kur i shikoja më gjatë, më dukej se ma lexonin kurreshtjen dhe më qortonin.

Arsimtari i historisë e ngriste zërin shumë më lart kur e shqiptonte emrin e Karl Marksit. Kollitej më parë dhe pastaj thërriste: "Karl Marksi", si të thërriste ndonjërin nga nxënësit për ta pyetur, e mandej fliste sërish me zë më të ulët, por shumë solemn.

- Kur të përmendet emri i Karl Marksit, duhet të lëvizni nga vendi! - udhëzonte kërcënueshëm arsimtari i historisë dhe na shikonte disi me inat.

- Arsimtar, nëna më ka thënë se kur të përmendet emri i Zotit, duhet të lëviz nga vendi!- i pata thënë unë hutueshëm, duke u ngritur në këmbë, siç ishte zakoni kur i drejtoheshe arsimtarit.

- Ti e dëgjon fjalën e nënës sate analfabete, apo fjalën e arsimtarit?!

- Jo, arsimtar...

- Pse vjen në shkollë, nëse nëna jote ditka më mirë se unë?

- Arsimtar, unë vetëm...

- Idiot! Dil jashtë!

- Pastaj m'u afrua me hapa të shpejtë, ma ngrehi veshin me forcë dhe më dha një flakaresh, derisa unë po dilja nga klasa i tmerruar. Përplasjen e derës mbas meje nga ana e arsimtarit e shoqëruan disa fjalë shpotitëse të Nazit dhe disa të qeshura.

Në orën tjetër unë rrija kokulur dhe nuk guxoja as ta shikoja tinëz arsimtarin e historisë. Ai përsëriste me zë të lartë emrin e Karl Marksit, shpjegonte zbulimin e materializmit dialektik, thoshte se nuk ekziston kurrgjë tjetër përveç materies, thoshte se baza materiale e determinon vetëdijen shoqërore dhe prapë përsëriste se kur të përmendet emri i Karl Marksit duhet të lëvizet nga vendi.

Unë nuk e ngrija kokën, sepse kisha frikë nga pamja triumfuese e arsimtarit të historisë. E ndieja shikimin depërtues të tij, të cilin vetvetiu e krahasoja me shikimin depërtues dhe enigmatik të fotografisë së Karl Marksit.

- Ti, a more vesh?! - bërtiti arsimtari i historisë në çastin kur ra zilja. Unë sërish mbaja kokën ulur, megjithëse e ndieja se më ishte drejtuar mua.

- Hej, ti idiot, a more vesh?

- Po, arsimtar! - u përgjigja unë i frikësuar.

Në orën tjetër, arsimtari i historisë vazhdoi shpjegimin e tij për "materializmin dialektik" me një pasion edhe më të madh. Ndërsa, unë gjatë tërë orës, mbaja kokën ulur, se nuk guxoja ta shikoja as arsimtarin, as Marksin. Sytë e tyre ishin bashkuar në një urrejtje të madhe kundër meje, sepse pata thënë se duhej të luanim nga vendi vetëm kur përmendej Zoti. Sytë e tyre e shtrëngonin klasën me një hetim të përhershëm, si në një stacion policie.

# Tito

- Ngrihuni të gjithë në këmbë! - urdhëroi arsimtari në njërën nga orët e historisë, në gjysmëvjetorin e dytë, në muajin maj më duket. Ne u ngritëm në këmbë rrëmujshëm. Kur u qetësuam të gjithë në një pozitë gatitu, ai foli me zë të lartë:

- Kush është në fotografinë që e kemi në mur?

- Shoku Tito! - bërtitëm të gjithë, megjithëse me disa zëra të çakorduar.

- Përsëriteni edhe një herë!

- Shoku Tito - gjëmoi klasa, kësaj here si me një komandë të ushtruar mirë.

- Shumë mirë! - bërtiti arsimtari i historisë dhe fytyra i ndriti nga një gëzim i madh.

- Sot do të flasim për figurën e shokut Tito! Uluni!

Të gjithë nxënësit u ulëm me ngut dhe ia ngulëm sytë arsimtarit të historisë, i cili e shikonte fotografinë në mur, duke mbajtur dorën e djathtë në cep të ballit, si ushtar. Atë fotografi të varur lart në mur, në anën e majtë të stufës, ne e shikonim për çdo ditë, sepse ajo ishte e madhe dhe me një kornizë me ngjyrë të artë. Por tash, që arsimtari e përshëndeste ushtarakisht, e shikova me më shumë kurreshtje.

Meqë isha në bankën e parë, mund ta dalloja më mirë atë rrezëllimin e syve të tij depërtues, njësoj si të syve të Karl Marksit. Për një çast m'u duk se i lëvizën sytë dhe na përthekoi me një shikim kërcënues, aq sa ndjeva frikë. Por, fjalët e arsimtarit ishin qetësuese.

- Shoku Tito është biri më i madh i kombeve dhe kombësive tona, i të gjitha kohëve, është nxënësi më i madh i Karl Marksit, mësimet e të cilit i ka shndërruar në praktikë dhe i ka përparuar edhe më shumë. Sa herë do të përmendet emri i shokut Tito, duhet të ngriheni në këmbë! - urdhëroi në fund të orës arsimtari i historisë.

- Në orët e historisë që pasuan, sa herë përmendej emri i Titos, ne ngriheshim në këmbë, si me një komandë të rreptë ushtarake.

Culi, një shok i klasës që rrinte në bankën e parë, në rreshtin te dritarja, tregohej veçanërisht i zellshëm për të përmendur emrin e Titos në orën e historisë. Edhe nëse i binte tema për epokën e gurit, ai bënte ç'bënte, dhe nuk e linte pa e përnendur emrin e Titos dhe ne që të gjithë, bashkë me arsimtarin (nëse qëllonte i ulur) ngriheshim në këmbë. Dhe arsimtari i historisë e donte fort Culin dhe e lavdëronte me fjalë të zgjedhura. Por, Culi na e nxinte jetën edhe në orët e tjera, e madje edhe në pushimet ndërmjet orëve. Kur e shihte ndokend ulur në oborrin e shkollës, në kohën e pushimit, i afrohej dhe thërriste me zë të lartë: "Rroftë shoku Tito!". Nëse ndokush nga nxënësit nuk ngrihej, ai ia

shënonte emrin dhe në orën e historisë i tregonte arsimtarit.

Edhe në orët e edukatës muzikore ne mësonim këngë për Titon, të cilat i këndonim me aq zë të lartë, sa ndiheshin në fund të katundit. "Shoku Tito ne të betohemi/ Se nga rruga jote nuk largohemi/, ishte refreni i një kënge që e këndonim rregullisht në ditët e festave.

- Duhet ta ngrini zërin sa më lart, kur ta këndoni shokun Tito!- na mësonte arsimtari i muzikës me zërin e tij të përdredhur. Ai ishte një plakush që kishte qenë edhe partizan. Gati në secilën orë të edukatës muzikore, ai e nxirrte librezën e luftëtarit dhe e lëkundte në ajër për të na bindur se kishte qenë partizan. Me një pasion të madh na tregonte për luftën heroike që kishte bërë brigada e tij kundër ballistëve "me urdhërin e shokut Tito".

Orët e historisë e të muzikës kalonin disi, po natën, kur nuk më zinte gjumi, më shkonte mendja në fotografinë e shokut Tito të varur në anën e majtë të stufës dhe më dukej se tymi dilte nga qyngu dhe e përshkllinte pamjen e tij. Ai nxihej i tëri nga bloza, por sytë i mbeteshin po ata, kërcënues dhe enigmatik tejmase. Tmerri më kapte edhe më shumë kur më dukej se arsimtari i historisë ishte dikund aty pranë meje dhe përgjonte mendimet e mia.

- Kij kujdes, se bëri e mendove diçka keq për shokun Tito, do të ta nduk veshin, idiot! Ne e dimë që babai yt është armik, është kundërrevolucionar. Prandaj ti je një farë e keqe. Po mos mendoni se

mund t'i shpëtoni syrit vigjilues të partisë. More vesh, idiot!

Strukesha edhe më fort dhe e fusja kokën nën jorgan gati tërësisht. Por, edhe me kokën e fshehur, me sytë e mbyllur dhe me frikën në palcë, më vinte ndonjë përfytyrim disi i shfytyruar për portretin e shokut Tito.

- Kij kujdes, idiot! - më dukej se lëvizte nëpër errësirë kërcënimi i arsimtarit të historisë. Dhe sa më shumë që më kaplonte frika nga prania e padukshme e arsimtarit të historisë, aq më shumë deformoheshin përfytyrimet e mia për Titon, po edhe për Karl Marksin. Flokët e kërleshura të kallakangjës mbinin në çast mbi mjekrën dhe mbi kokën e Karl Marksit, e mbulonin të tërin, i futeshin në gojë, ia mbulonin sytë depërtues dhe enigmatik, e shndërronin të tërin në një krijesë të frikshme.

Pastaj i vinte radha shokut Tito. Mbi ballin e tij të gjerë, nguleshin dy brirë të mëdhenj, të kuq, si të ndonjë demi mbas një dueli të ashpër, ku ai del fitimtar, po me brirë të gjakosur nga trupi i demit të mundur, ndërsa nga sytë i rridhte një lëndë viskoze dhe djegëse, si kallamazi me të cilin baba lyente rrotat e qerres. Më kapte lemeria nga frika, sepse prania e arsimtarit tashmë bëhej krejt e vërtetë. Përsërisja me vete refrenin e këngës, që t'i largoja disi përfytyrimet e frikshme. Por, nuk ndihmonte as refreni i këngës. "Shoku Tito ne të betohemi. Se nga rruga jote do të largohemi", tingëllonte në mendjen time një zë i ashpër, që vërtet ishte imi, por unë kisha frikë ta dëgjoja. Pse e ndryshonte tekstin

dikush brenda meje me aq kokëfortësi? Heqte ndajfoljen nuk vargjet ndërronin krejt kuptimin, bëhej hataja. Arsimtari i historisë shpurdhte si zorra në prush, më kërcënonte e përpiqej të më kapte për fyti.

Vetëm kur e pëshpëritja lutjen që ma kishte mësuar nëna "La ilahe ilallah" më hiqej frika dhe ndieja trupin të më lehtësohej. Më dukej se masa e frikës dilte nga trupi im dhe ikte e dilte nëpër oxhak e shporrej diku larg.

# Beria

Kur dukej Salihi i Islamit, me kapelën "leninovka" në kokë, duke ardhur drejt shkollës, arsimtarët zverdheshin në fytyrë. (Shumë vite më vonë, kur e kam parë fotografinë e Lavrenti Berias, jam tmerruar nga ngjashmëria e pamjes së Salihit të Islamit me atë të shefit të KGB-së). Nuk e di si ndodhte që unë vërtet e vëreja këtë ndryshim në fytyrat e disave prej tyre ose më mirë të them, nuk e di pse nuk e vërenin të gjithë atë ndryshim të madh. Përjashtim bënte arsimtari i biologjisë, i cili nuk zverdhej por skuqej nga njëfarë shpërthimi i emocioneve. Ndonjëri nga arsimtarët e zverdhur fillonte të na bërtiste neve nxënësve, që të mbanim qetësi, (në oborr) dhe që të futeshim në klasë, edhe pse zilja e Hamitit ende nuk po binte.

Salihi i Islamit vinte drejt shkollës me hap të ngadalshëm, thuajse i maste një nga një hapat që hidhte. Dimër e verë në këmbë mbante të mbathura çizme të llastikut, të gjata deri në gjunj, me një vijë të kuqe në pjesën e epërme.

- Këto janë çizme të komunistëve! - më tregonte Lala, një kushëriri ynë i largët, kur e bezdisja me pyetje për ato çizme. Gati gjithmonë u binte fort me

shuplaka të dorës, herë njërës këmbë e herë tjetrës, për të vënë në pah forcën e atyre çizmeve vizëlluese.

Kur mbërrinte te fusha e volejbollit, Salihi i Islamit ndalej dhe e përthekonte oborrin e shkollës me një shikim hetues. Arsimtarët që qëllonin në oborr, edhe pse të hutuar e të zverdhur në fytyrë, niseshin drejt tij dhe e përshëndesnin duke ia shkundulluar dorën. Ai rrinte vërenjtur dhe shikonte andej-këndej, sikur kërkonte që edhe të tjerët të vinin e t'ia shkundullonin dorën. Gjithmonë arsimtari i biologjisë gjendej pranë tij dhe e merrte për krahu dhe bashkë futeshin te salla e arsimtarëve. Ne futeshim në klasat tona dhe më tutje nuk dinim as çfarë thoshte as çfarë bënte Salihi i Islamit në sallën e arsimtarëve. Dikush thoshte se ai luante shah me arsimtarin e biologjisë dhe me drejtorin.

- Mos u bëj si Salihi i Islamit! - i pati thënë një herë baba një njeriu që po i tregonte diçka në lëmën tonë, ku ata ishin mbështetur për shtrege dhe pinin duhan një pasdite të verës. Më duket se po atë natë, pashë një ëndërr të frikshme. Salihi i Islamit, ishte ulur diqysh mbi gurin e çezmës së Shegëzës, e këmbët i lëvareshin mbi gyp dhe luante me ujë, duke e derdhur jashtë shtratit të drunjtë. Kur u afruan bagëtia, ai nxori revolen nga brezi dhe filloi t'i qëllojë me radhë, ato të cilat përplaseshin përtokë, ndërsa gjaku përzihej me ujin e çezmës. Salihi i Islamit kollitej me zërin e kaut dhe brirët i rriteshin mbi beretën e zezë.

- Qen bir qeni! - ngërmonte Salihi i Islamit, kollitej dhe ma drejtonte revolen në lule të ballit.

Ishte i parruar, syzgurdulluar dhe i mbuluar në djersë. Brirët mbi beretën e zezë i rriteshin me shpejtësi. Unë qaja me zë, shikoja lopët e vrara dhe ujin e skuqur nga gjaku i tyre dhe dëgjoja kërcënimin e tij " Qen bir qeni" të përsëritej gjithnjë me zë e më të lartë. E shtëna drejt meje, në lule të ballit ma nxori gjumin, po frika m'u zmadhua edhe më shumë në atë errësirë të thellë të dhomës, ku dëgjoja gërhamën e fortë të babës.

Pas asaj ëndrre të frikshme, sa herë e shihja Salihin e Islamit që vinte drejt shkollës, hyja në klasë me hapa të shpejtë. Po ai në shkollë vinte shpesh e më shpesh, rrinte gjatë e më gjatë, flitej se nuk luante shah vetëm me arsimtarin e biologjisë e me drejtorin po edhe me arsimtarin e historisë, i cili kishte filluar të krenohej nëpër shkollë e nëpër fshat se e kishte mësuar shahun bash prej dorës së Salihit të Islamit.

- Ai është Rankoviq! - i pati thënë një herë baba dikujt në odën tonë. Emri i askujt nuk u përmend më parë, po mua m'u krijua ideja se po fliste për Salihin e Islamit. Nuk e dija se çka do të thoshte fjala Rankoviq, po nga zemërimi që shpërthente në shqiptimin e kësaj fjale nga baba, përfytyroja se ishte diçka e pështirë.

Figura e Salihit të Islamit, i parruar, me sy xixëllues, me çizme të gjata deri në gjunj dhe me revole në dorë duke shtënë mbi lopët që i afroheshin çezmës së Shegëzes, më shfaqej në kujtesë me përmasa të frikshme sa herë që diçka nuk shkonte. Ajo figurë bëhej një prodhuese e bezdisë në përfytyrimet e mia të fëmijërisë, disi ngjashëm me figurën e majmunit nga libri i biologjisë.

- E pati edhe Salihi i Islamit! - kokoriste gëzueshëm një mbrëmje vere dajë Ceka, deri sa rrinte me babën në odë.

- Më duket se shpëtuam nga dora e Rankoviqit! - ia ktheu baba. Ndoshta tash na lënë rehat e nuk kërkojnë që të na dëbojnë nga vendi ynë. Baba pinte duhan me kamish dhe më dukej se edhe fjalët i dilnin nga kamishi.

- Kemi hequr kiametin! - fliste dajë Ceka dhe tundte kokën, duke dredhur një cigare. Hyqymet më i poshtër nuk bën vaki me ardhë! Ishalla ua dredhin kokën rankoviqistëve!

- Thiu thiun s'e han, o Cekë! Po ishalla na lënë rehat ne në hallin tonë! Mjaft mos të na ndjekin mbrapa, si zagarët!

Nga biseda e babës me dajë Cekën e kuptoja se Salihi i Islamit më nuk do të kapardisej në oborrin e shkollës. Por, çuditërisht e ndieja se ai mund të futej sërish në ndonjë ëndërr timen të keqe dhe të vriste lopët me revole pranë çezmes.

# XI

Në oborrin e një shtëpie të djegur, së cilës i kishin mbetur vertikalisht tri oxhaqe të larta, të nxira nga flakët, rrinte një plak rreth shtatëdhjetë vjeç i kërrusur e thatimë, i parruar e me rroba të zhubravitura si mos më keq. Kur na pa ne që po hynim në oborr, duket se u tremb në fillim, po mandej sikur e mori veten dhe filloi të na afrohet, duke u mbajtur për një kërrute. Ishte fillikat në atë oborr. Na tregoi se tërë luftën e kishte kaluar duke u endur nëpër shtëpitë-gërmadha të fshatit të tij, krejt i vetëm, ngase familja e tij dhe mbarë banorët ishin dëbuar nga fshati me dhunë dhe ai nuk e dinte se nga i kishin çuar. Dikur ikën edhe qentë nga fshati dhe unë mbeta krejt vetëm. Shumë çudi më vjen se si ikën qentë nga fshati. Ishte shumë vështirë ta kaloja natën pa dëgjuar asnjë lehje qeni. Jam rritur e jam plakur në këtë fshat dhe ne gjithmonë kemi mbajtur qen që ruanin shtëpitë tona. Po të mos ishin zhurmat e avionëve dhe eksplodimet e raketave, nuk e di se a do të shpëtoja me mend a jo. Familjen ma dëbuan nga shtëpia ushtarët me maska e me automatikë në duar. Shanin e bërtitnin si të çmendur. Po unë nuk luajta vendit. U thashë, në gjuhën e tyre, po deshët vramëni, po deshët mbytmëni, unë nuk e lëshoj shtëpinë i gjallë. Dhe, ata nuk më thanë kurrgjë tjetër, po ia dhanë flakën shtëpisë, u zgërdhinë e morën shpatit teposhtë në lagjet e tjera, të cilat i bënë shkrumb e hi.

Shikoja flakët se si e përthekonin shtëpinë si bisha të egra dhe as një kovë ujë nuk e nxora nga pusi. Thashë vetmevete si është shkruar, ashtu do të bëhet dhe s'ka tjetër. Zoti na jep e na merr. Vetëm robt' e shtëpisë të më shpëtonin, se sa për shtëpi do t'ia bëjmë hallin. Po thonë se janë në Shqipëri e se janë nisur për këndej. Po nuk di ku do të flejmë o mik, se jemi njëzet anëtarë të familjes, me djem e me nipa. Po shyqyr që u çliruam, se flejmë edhe në oborr. Mjafton që nuk na ngucë kush.

Plaku foli e foli, pa na shikuar asnjërin dhe më shumë bënte një monolog me veten, sesa një bisedë me ne. Mezi i dilte zëri.

Kur pushoi një grimë, Hansi më tha ta pyesja se a mos dinte në kishin vendosur mina serbët, dhe në mos kishin hedhur kufoma në puset e fshatit. M'u desh ta kapja për mënge lehtë plakun që t' i ndihmoja të kuptonte se çfarë po e pyesnim. Më shikoi hutueshëm dhe tërhoqi krahun si me hidhërim.

- E kemi pasur në fshat një bashkëpunëtor të serbëve. E kemi ditur që është qen, po jo në atë derexhe. Ai ka bërë me gisht se kush duhej të pushkatohej, cila shtëpi të digjej, cila shtëpi të plaçkitej.

- Ku është tash ai njeri? - pyeti Hansi dhe unë ia përktheva.

- Kush e di ku është. Me siguri diku në Serbi. Farë e keqe ishte, o mixhë. Mina nuk kanë vendosur, sepse këtu nuk mbetën as qentë, e lëre më njerëzit. Ata kanë menduar se do të mbeten këtu gjatë, prandaj nuk kanë vendosur mina. Plakut i lamë dy batanije, dy konserva dhe një bukë e një litër qumësht, edhe pse ai mezi i pranoi ato ndihma. Jam mësuar të bëj hall, mos u mërzitni për mua. Ndoshta dikujt tjetër i duhen më shumë- ngulmonte plaku derisa ne largoheshim. Mbaj

fletoren në dorë dhe mendohem : çfarë paralajmërimi paskësh qenë ky dorëshkrim?! Ai personazhi, Beria, ishte një njeri real, i cili u kishte prirë krimeve ndaj bashkëkombasve të vet në këtë fshat, sigurisht duke ua prishur edhe ëndrrat. Por, jam i sigurt se, edhe po të ishte botuar ky dorëshkrim para kësaj katastrofe, askush nuk do t'ia vinte veshin këtij paralajmërimi.

# Enveri

Në romanin "E kuqja dhe e zeza" të Stendalit, të cilin im vëlla e mbante në fund të arkës së të shoqes, ruhej e fshehur një fotografi e Enver Hoxhës. Atë fotografi im vëlla ma pati treguar një ditë, duke më porositur dhjetëra herë që të mos i thosha askujt se çfarë fshehte ai në fundin e arkës së të shoqes. Nuk e di pse ma pati treguar atë fotografi mu atë ditë vjeshte (shiu nuk prajti tërë ditën e lume dhe ne ishim si të ngujuar në shtëpi). Tash them se mos ka qenë festa jonë kombëtare, 28 nëntori, për të cilën atëherë unë nuk dija asgjë. Nga ana tjetër, nuk e di pse nuk ma kishte treguar atë fotografi edhe më herët dhe pse nuk më kishte treguar se kishte një shtet që e quanin Shqipëri, nga e cila ne ishim të ndarë me dhunë para shumë e shumë vjetësh. Ne ishim shqiptarë si ata, e flisnim të njëjtën gjuhë dhe ishim vëllezër të një gjaku. Por, ne ishim në një shtet tjetër, që e kishte emrin Jugosllavi, e në të cilin nuk ishim krejt të lirë. Im vëlla fliste ngadalë, më një zë disi të dridhshëm dhe më duket se ballin e kishte më të zbehtë se zakonisht. Por, ai fliste pa u ndalur, duke më shikuar drejt e në sy, me një shikim të butë, sa në çdo çast prisja se do të më përqafonte.

Fotografia e Enverit ishin me ngjyra, një ngjyrë e kaftë e çelët dhe në fund ishte firma e tij. Ishte i buzëqeshur me faqe të mbushura dhe me një shikim të tretur në lartësitë që në fotografi nuk dukeshin.

- Si të duket?

- Kush? A, po. Shumë i mirë.

- A është më i mirë se ai topuzi, Titoja?

- A? Ah, po, po. Ky është shqiptar a?

- Shqiptar si ne. Dhe kryetar i shtetit tonë amë.

- A është kryetar i yni?

- Po de.

- Pse nuk është fotografia e tij në klasë?

- Nuk na e lënë. Por, ti mos i trego askujt se e kemi në shtëpi! Mund të kemi probleme me polici.

- Nuk i tregoj askujt.

- Por, ky është kryetari i shqiptarëve, mbaje mend! Dhe mos i trego askujt se e kemi fotografinë e tij në shtëpi, more vesh?

- Po, po.

- Pas njëfarë kohe, im vëlla e mori fotografinë, e futi në librin "E kuqja dhe e zeza", e mbështolli në një rrobë dhe e futi në fund të arkës, duke kënduar me zë të ulët një këngë, ku dalloja vetëm fjalët "Enver Hoxha t'u ngjattë jeta". Pastaj m'i ledhatoi flokët dhe sërish më porositi të mos i tregoja askujt për fotografinë që ai e mbante të fshehur.

- Kur të rritesh, do të mësosh më shumë, tash duhet të dish vetëm kaq!- foli im vëlla dhe pastaj iu afrua dritares dhe qëndroi duke e shikuar shiun që nuk prante. Edhe unë shikoja për dritare dhe shikoja në largësi, duke u munduar të lidhja disi mendimet për atë vend që quhej Shqipëri, që ishte atdheu ynë dhe që e kishte atë burrë me faqe të mbushura e me shikim të tretur në lartësi, Enver Hoxhën. Bëja përpjekje të formësoja disi në mendje se si dukej Shqipëria (më e madhe se Shegëza e Shpati bashkë?), se si dukeshin shqiptarët e saj? Figurat që më krijoheshin në mendje ishin të përmasave fantastike, si Muji e Halili, për të cilët nëna na tregonte përralla të gjata netëve të dimrit. A thua do të niseshin ata një

ditë si Muji e Halili dhe të vinin te ne e të shporrnin nga fshati ynë Mirko tagrambledhësin dhe ata policët fytyrëzalli, të cilët na trokisnin me derë dhe e kërcënonin babën, se do t'ia merrnin bagëtinë dhe tokën nëse nuk e paguante "porezin". Hajt, hajt se vjen Enver Hoxha dhe ua tregon qejfin, mendoja. Ne fotografinë e tij e kemi në shtëpi, më shpëthente një mendin kryengritës, sa më kapte tmerri se mos më dilte edhe ndonjë fjalë nga goja. Por, ata as që më shikonin mua. Me sy të çartur, me damarë që u dilnin në të dy anët e qafës dhe me nofulla të shtrënguara, kërcënonin babën me fjalë që unë nuk i kuptoja, sepse flisnin në gjuhën e tyre serbe. Pamjet e ngërdheshura dhe të frikshme të Mirkos dhe të policëve të tij i krahasoja me pamjen e Enver Hoxhës nga fotografia, ku ai ishte i qetë dhe me shikim në lartësi dhe ndieja se triumfoja mbi ta. Por, dalngadalë më krijohej bindja se as Enveri dhe as ata shqiptarët e tjerë të Shqipërisë nuk do të vinin kurrë, si Muji e Halili për të na shpëtuar.

- Fotografia le të rrinte aty në fund të arkës, në romanin e Stendalit "E Kuqja dhe e zeza", që unë të dija se kishte një president shqiptar dhe një Shqipëri, që ishte atdheu ynë i vërtetë, nga i cili na kishin ndarë me dhunë. Edhe pse askujt nuk guxoja t'i tregoja, ajo fotografi më bënte që të mbahesha më të madh para shokëve që nuk i dinin nga ato gjëra të fshehura.

- Edhe sot pas më shumë se tridhjetë vjetësh atë fotografi të Enverit e mbaj në dorë dhe e shikoj gjatë derisa shkruaj këtë tekst. Koha ka lënë gjurmët e veta edhe në fotografinë e tij, sado që tërë kohën ka ndenjur e ruajtur në atë libër dhe në fund të arkës. Por, ngjyrat vërtet janë bërë krejt të zhgjyera, sa mezi dallohen vijat e portretit. Tash di shumë e shumë gjëra për Enver Hoxhën, që nga rrërfimet e

miqve të mi që kanë vuajtur ferrin e burgjeve të tij, e deri te literatura e botuar këto vitet e fundit, e cila e tregon Enverin si një diktator - përbindësh. Lexoj ngadalë titujt e kapitujve të librit të Ilir Malindit, duke e ndërprerë leximin me shikime të gjata mbi fotografinë që mbaj në dorë. Komunizmi sllav dhe pansllavizmi i Enver Hoxhës... Enver Hoxha nxjerrë thonjtë e diktatorit... Përrenj gjaku. Vrasje dhe vetëvrasje... Kthetrat e mprehta të djallit... tentakulat e përbindëshit... Krerët e folesë së djajve... Roja e kryedjallit dhe disa kurdisje të Sigurimit... Epopeja sllave në Shqipëri... Epopeja ruse... Përkrahja e organizatave terroriste... Lufta kundër fesë... Puna e Sigurimit me shqiptarët në Jugosllavi... Vrasja e Mehmet Shehut... Arrestimi i Kadri Hazbiut... Vrasja e djemve të Kosovës... Herë shikoj përmbajtjen e librit herë fotografinë e Enverit, duke ndjerë si më djersitet dora dhe si më rëndohet nga pesha e saj. A thua ka qenë e mundur që të kem adhuruar një njeri të tillë, një krijesë aq monstruoze që ka shkuar aq larg sa e ka mohuar edhe vetë Zotin?!!!

- A e sheh? - i them vëllait.

- Po. Por, ashtu ishte ajo kohë. Ne e kishim një shpresë tek ai.

- Shpresë e kotë kishte qenë. Sa për të, Mirko e policët e tij do të na piqnin në hell.

- Megjithatë, ne e kemi forcuar veten, duke e krijuar iluzionin se e kemi dikë që na mbron, që është i yni. Kështu duhet të shikohet ajo punë.

- Por, kemi qenë të mashtruar, pranoje.

- Të mashtruar prej tij, po. Por, ne jemi mbajtur gjallë me shpresë. Kjo nuk është pak. Pa atë iluzion, ndoshta do të ligështoheshim krejt e nuk do të mund t'i bënim ballë terrorit.

- Por, edhe ne jemi viktima të tij, pranoje. Jo si ata të Burrelit e Spaçit, por viktima po.

- Im vëlla më shikon me butësi, si atëherë kur ma tregoi për herë të parë fotografinë e Enverit dhe sërish ballin e ka të mbuluar me djersë të ftohta, të cilat i notojnë nëpër rrudhat e thella. Më shumë se tridhjetë vjet nga ajo ditë vjeshte (që mund të ketë qenë dita e festës sonë kombëtare) koha ka gdhendur në ballin e tij edhe formën e pashlyeshme të dëshpërimit.

# XII

Kur e mbylla fletoren, pashë se doktor Hansi ishte ulur pranë meje në tendë dhe po më shikonte me ngulm. I buzëqesha dhe pa më pyetur asgjë, fillova t'ia shpjegoja përmbajtjen e kapitullit. Doktor Hansi pa u përqendruar në atë që i thashë, filloi të tregonte se kishte lexuar dy romane të shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare, po emrat e veprave i kishte harruar. Nga ajo që i kujtohej, mora vesh se kishte lexuar romanet "Prilli i thyer" dhe "Pallati i ëndrrave".

- Shumë mister ka kultura juaj! - përfundoi doktor Hansi.

- Varet si e sheh njeriu - i thashë.

- Ato romanet që kam lexuar unë, ashtu më janë dukur. Vrasje dhe ëndrra të frikshme.

- Jeta jonë ka qenë shumë dramatike, doktor Hans. Ju e patë në këtë luftën e fundit.

- Po, po.

- U desh të ndodhte gjithë kjo hata, që të na njihni sado pak. Mosnjohja e madhe krijon idenë se jemi një mister - i thashë gati me inat.

- Për shqiptarët unë dija se janë një komb komunist dhe se i përkasin kampit të Moskës. Ndërsa unë urreja komunizmin nga thellësia e shpirtit, sepse ko-

munistë qenë ata që ma vranë nënën e motrën në parkun Tiergarten. Ata që e shkrumbuan Berlinin mbanin kapela me yllin komunist. Dhe ju shqiptarët ishit në kampin komunist. Çfarë të dija më shumë?

- Ne ishim për të na vajtuar, e jo për të na injoruar - i thashë si në tym.

- Nuk jam i sigurt se keni qenë të injoruar prej nesh. Është e kundërta, vetë ju shqiptarët keni pasur fajin e madh që nuk keni bërë më shumë për veten tuaj. I jeni nënshtruar diktaturës dhe jeni sjellë sikur jeni komb i lumtur. Flas për Shqipërinë në këtë rast. Nuk kishte opozitë, nuk kishte disidencë, asgjë nuk kishte. Ju e patë vetë në Kosovë: kur u rebeluat kundër robërisë, ne erdhëm dhe ju ndihmuam. A nuk është kështu?

- Për këtë ndihmën e fundit keni të drejtë. Por, ne na dëmtuan në të kaluarën shumë, na ndanë dhe na lanë një pjesë këndej një andej. Po të ishim komb i bashkuar, as diktatura në Shqipëri nuk do të ishte aq e egër dhe as Kosova nuk do të përjetonte tragjeditë që përjetoi.

- Kjo është një temë tjetër, megjithëse edhe ndarja juaj e ka brenda vetes shkakun se ju nuk keni qenë të formuar si komb dhe nuk keni pasur një projekt të qartë për të ardhmen. Kam lexuar disa dokumente për Lidhjen e Prizrenit dhe kam parë se kërkesat politike nuk kanë qenë të qarta. Apo nuk është kështu?

- Nuk di. Më shumë mund të thuhet se nuk ka pasur vullnet që të zgjidhet problemi shqiptar. Në atë

kohë ishin në ekspansion shtetet sllave, të cilat i përkrahte Rusia.

- Në fund të fundit, asgjë nuk ndreqet duke vajtuar për padrejtësitë e të kaluarës. A pak padrejtësi i janë bërë Gjermanisë? Po ne kemi ecur përpara dhe nuk jemi gjunjëzuar asnjëherë. Me këtë luftën e fundit edhe ju keni filluar të silleni si një komb që nuk ndalet. Por ju pret rrugë e gjatë. Doktor Hansi shikoi orën dhe u ngrit.

- Ta lëmë historinë se nesër kemi punë - tha dhe doli duke bërë një shenjë përshëndetjeje me dorë. Unë mora dorëshkrimin sërish.

# Anatomia

Skeleti që rrinte në ballë të klasës, gati i mbështetur për dërrasën e zezë, vinte gjithmonë bashkë me profesorin e anatomisë, sa dikur më dukej se ata ishin të pandashëm. Dikur mua më dukej se nuk ishte profesori ai që e tërhiqte zvarrë skeletin, po skeleti i ndihmonte profesorit që të dinte se kur saktësisht kishim orët e anatomisë. Për ndryshim nga skeleti, profesori ishte një njeri i trashë, me faqe të kuqe dhe me një trup muskuloz, si një sportist. Kur e vendoste skeletin në vend, (edhe skeleti mu si ne nxënësit e kishte vendin e vet!) profesori e maste klasën me shikim dhe sytë i ngatërroheshin në bankën e dytë, te Meri dhe për disa çaste ai ngrinte i tëri, sa i përngjante bashkudhëtarit të tij, skeletit. Tërë klasa e dinim se ai e kishte merak Merin, se e kishte lutur që të bënte dashuri me të, se i kishte premtuar gjithëfarë gjërash, edhe se do ta merrte për grua... Meri të gjitha këto ia kishte treguar Ritës, ndërsa Rita të gjithë ne të tjerëve, megjithëse secilit veç e veç, as sa mund të thuhej se nuk kishte dëshmitar që të pohonte se ajo e kishte thënë një fjalë të vetme. Profesori i anatomisë e merrte veten shpejt dhe bëhej shumë nevrik duke na akuzuar se ne ishim

një grup injorantësh që më mirë e kishim pasur po të kishim ruajtur lopët në katund se që kemi ardhur për të humbur kohë në shkollë, për të cilën ne nuk ishim. Pastaj fillonte të na pyeste herë njërin e herë tjetrin, sa në njërin rend sa në tjetrin (Merin gjithmonë e provokonte me pyetjet më të ngatërruara si ajo për Muskulus sternokleidomastoideus-in dhe për penisin). E nxirrte Merin te skeleti dhe e pyeste se nga shtrohet ai muskulus sternoideomastoideusi. Pastaj bënte edhe ndonjë pyetje tjetër, pak më të lehtë, po gjithsesi e pyeste se ku ishte dhe si ishte penisi, e kështu me radhë. Meri skuqej flakë dhe djersët ia mbulonin fytyrën e bukur. Skeleti dridhej një kohë nga të prekurat e lehta të Merit dhe mua më dukej se edhe profesori po ashtu dridhej. Mandej më dukej se ato të dridhura më përfshinin edhe mua dhe ndoshta të gjithë nxënësit e tjerë, aq sa më dukej se e tërë klasa shndërrohej në një hapësirë të dridhshme. Epiqendra e atij tërmeti të vogël, ishte dora e Merit, e cila prekte lehtë atë pjesë të skeletit ku duhej të ishte ai, penisi, për të cilin profesori i bënte pyetje vazhdimisht, sa, kur, si...

Në njërën nga orët e anatomisë, profesori dhe skeleti hynë si zakonisht në klasë, po Meri mungonte. Shikimi i tij pyetës u ngri për disa çaste në bankën ku duhej të ishte Meri, pastaj u ul dhe filloi të pyeste se kush mungonte, pse mungonte... Atë orë ai as nuk pyeti kënd as shpjegoi ndonjë pjesë të re të skeletit. Na tha të hapnim librin në faqe 140 dhe të lexonin në heshtje mësimin. Ishte një leksion

për anatominë e boshtit të kurrizit më duket. Ne rrinim kokulur, gjoja duke lexuar ndërsa ai tërë orën u end nëpër klasë i menduar dhe duke fishkëlluar nganjëherë njëfarë melodie. Kaluan ditë e javë e Meri më nuk erdhi në shkollë. Më në fund Rita na e solli lajmin se Meri e kishte lënë shkollën për shkak të ngacmimeve që i bënte profesori i anatomisë. Një natë ai ia kishte zënë udhën para banesës dhe i kishte thënë se o do të flinte me të, o nuk do të kalonte klasën kurrë. Dhe ajo kishte vendosur që të braktiste shkollën. Më as e kam parë Merin dhe as kam dëgjuar gjë për të. Në njërën nga fotografitë e hershme të shkollës, që e ruaj në album, është edhe Meri. E bukur dhe me një të qeshur që duket se të përpin. Profesori i anatomisë ka vite që ka vdekur në një aksident komunikacioni dhe fotografinë e tij e kam parë disa herë në gazeta, ku e përkujtojnë familjarët e tij, gruaja dhe fëmijët, kolegët dhe miqtë. Në të gjitha ato përkujtime është gjithmonë e njëjta fotografi e tij, një pamje serioze, gati e përvuajtur. A thua çka do të jetë bërë me skeletin që e bartte me vete, si ta kishte një gjymtyrë të veten? Do të jetë shpërbërë edhe ai me kalimin e viteve ose me djegien e shkollës gjatë viteve të luftës. Sigurish nuk ka mbetur asgjë prej tij. Dhe s'ka mbetur asgjë tjetër nga orët e anatomisë, të cilat shndërroheshin në ankth, në sëmundje, në lojë të ndjenjave perverse. Ka mbetur veç jeta e shkatërruar e Merit dhe kujtimi i hidhur për profesorin, i cili bënte që vendin e anatomisë ta zinte patologjia e ndjenjave. Dhe kush e di se çfarë perversioni kolektiv ka prodhuar me vite

ai njeri dhe shumë të tjerë si ai? A thua mund t'i shkulet rrënja asaj bime të keqe, të mbjellë në mendimin e qindra dhe mijëra njerëzve, vit pas viti, apo helmi i saj do të na e zë frymën me kutërbimin e vet?! Kam frikë se...

# Burgu

Kjo ndodhi shumë vite më vonë.

Gardiani filloi ta hapte derën me një tërsëllimë të frikshme hekurash të zi e vende-vende të ndryshkur. Me njërën dorë sillte çelësinë e madh, ndërsa me tjetrën shtynte, me sa fuqi kishte, paraportën e rëndë. Pastaj hapi portën e stërmadhe të hekurt, më kapi për krahu, duke ma shtrënguar llërën fort, sa ndieva dhembje, dhe pastaj më shtyu edhe më fort. Deri sa porta e stërmadhe e hekurt po mbyllej pas meje me një tërsëllimë edhe më të frikshme, unë u gjenda brenda dhomës, pa guxuar të ktheja kokën prapa e ta shihja fytyrën e gardianit. Dhoma ishte e gjatë dhe e ngushtë, madje tepër e ngushtë për tërë atë gjatësi, që andej nga fundi dukej se ngushtohej si një grykë kënate.

Askush nuk e ngriti kokën, derisa unë po e masja me shikim atë dhomë. Të mbështetur me shpinë për muri, të burgosurit që ishin në atë dhomë, të cilët në fillim m'u duk se ishin rreth tridhjetë veta, po më vonë doli se ishin vetëm njëzet, po hanin drekën. Gjëja e parë që më bëri përshtypje nga dreka e tyre, ishte krismënaja e lugëve dhe e pjatave të aluminta. Kaq shumë përplaseshin ato lugë dhe ato

pjata, sa nuk mund të merret me mend, megjithëse më vonë e kuptova edhe vetë se ajo vinte nga uria kronike e të burgosurve. Gjëja e dytë që më shkaktoi habi ishte mbajtja e kokës gati përngjitur me pjatat. Të burgosurit ishin kërrusur tërësisht mbi pjatat dhe hapësira ndërmjet gojëve dhe pjatave as që ekziston-te. Megjithëse u thashë edhe mirëdita edhe u bëftë mirë, askush prej tyre nuk ma ktheu përshëndetjen me një fjalë të vetme, madje as me një gjest. Një kohë ndenja në këmbë si hu afër derës. Mandej bëra disa hapa dhe u ula në një kënd të dhomës. Nuk vonoi dhe dera u hap sërish me tërsëllimë. Të burgosurit, pa pritur asnjë fjalë, u ngritën në këmbë me pjatat dhe lugët në duar dhe u nisën drejt derës që rrinte e hapur. Gardiani më urdhëroi, me një zë të egër, që të ngrihesha edhe unë. Në lokalin ku u futëm, kishte disa nevojtore, dhe një radhë lavamanësh, ku të burgosurit po i lanin pjatat dhe lugët e tyre. Disa me pantallona të shpërthekuara prisnin në radhë para dyerve të nevojtoreve. Gjithçka e bënin pa fjalë dhe me ngut. Bëra përpjekje të hyja në radhë në njërën nga dyert e nevojtores, por sa afrohesha, gjendej ndo-njëri që më dilte përpara dhe unë mbetesha jashtë.

Gardiani bërtiti me zë urdhërues “dosta!”, dhe të gjithë të burgosurit u nisën të dilnin nga nevojtorja-banjë, shumica prej tyre me pantallona ende të shpër-thekuara. Kur hymë brenda, nën breshërinë e britmave të gardianit, sërish u dëgjua tërsëllima e egër e portës së hekurt, gërvimat e çelësit në bravë dhe pastaj hapat e gardianit që po largohej. Këto

procedura do të përsëriteshin në ditët që do të vinin, pambarimisht, deri në ditën e lirimit tim.

- Nga të patëm, bre jaran? Hej, me ty po flas, o hajvan!

Disa burra qeshën me zë të lartë. Dikur e kuptova se pyetja më ishte drejtuar mua dhe ndjeva një drithmë të ma përshkonte tërë trupin.

- Unë a?!

- Jo babëgjyshi yt! Pej kahit je?

- Prej Breznie - gjegja me gjysëm zëri.

- Po pse nuk po kallzon si njeri?

- Le bre se s'qenka për kurrgjë. A nuk po e sheh që po duket si pulë e nuktë a!

- Sërish shpërthyen të qeshura dhe kollitje që m'u dukën të frikshme.

- Pej Breznie a? Po çka ke ba?

- Kurrgjë! - thashë me zë që sa vinte e shndërrohej në vaj. Më vinte inat që zëri më dridhej ashtu, po nuk mundja të frenoja shkulmet e pikëllimit që po mblidheshin si re të zeza. Sërish shpërthyen të qeshura, kollitje dhe gajasje të llojllojshme.

- Mos i ke zbrit pelës prej bishti? - tha njëri që ishte më afër meje.

- Unë, unë kam dashur të dal në Shqipëri! - mezi e mbarova fjalinë.

- Qy, qy, qy! Ky qenka politik!- tha njëri.

- Shihe ti çfarë trimi! Ky as macen prej përsheshi nuk mund ta trembë, e paska pasë dashur të kalojë kufirin e të dalë në Shqipëri!

- Luaje macë kryet e buallit!

- Sa të jetosh, do të dëgjosh gjithfarë budallallëqesh!

- Qe de!

- Unë nuk e di pse i bien në burg këta tipa. Më së miri është që të pushkatohen në kufi!

- Hajt bre bac se shteti e di më mirë çka duhet të bëjë! Ti po të dije, do t'i kishe vetë punët më mirë.

- Pse çka kam unë? Avokati më ka thënë që do të dal i pafajshëm!

- Po a? I pafajshëm? E ai që tash han baltë prej dorës sate, a do të shpallet i pafajshëm edhe ai?

Filloi një zënkë ndërmjet tyre, e pastaj u përzien edhe disa të tjerë në atë zënkë. Dikush thoshte se Ramushi (ashtu e kishte emrin), e kishte bërë vrasjen në vetëmbrojtje, dikush tjetër thoshte se vetëmbrojtja nuk mund të provohet lehtë, e ku ta di se çfarë.

Mua më harruan krejt, si të mos isha aty. Nja dy veta e nxorën një tabelë shahu dhe u ulën përballë njëri-tjetrit, duke u lavdëruar me gjithëfarë fjalësh, si "Unë për ty jam Fisher", "Unë për ty jam Kasparov". Disa të tjerë filluan të luajnë letra, edhe ata duke u lavdëruar e duke premtuar se do të fitonin. Në dhomë vinte erë e rëndë, një kutërbim që më zinte frymën gjithnjë e më shumë.

Pastaj u ndez drita e madhe në ballë të dhomës, një dritë verbuese, e cila ma kujtoi figurën e syrit të ciklopit. Më duket se askujt nuk i bëri përshtypje ndezja e dritës dhe as hapat në korridor dhe britmat e dikujt që më dukej se po e tërhiqnin zvarrë.

Nuk fjeta pothuaj tërë natën nga gërhamat e frikshme, nga kollitjet dhe nga të folurit e përçartë të të burgosurve, që më shkaktonin rryma frike në trup.

Pranë meje ishte njëri që tha se e kishte emrin Remzi. As ai nuk flinte. Shikonte andej-këndej, pastaj disa herë u ngrit dhe seç kërkonte në fund të dhomës, atje ku ishin teshat dhe gjërat e të burgosurve.

- Unë jam këtu për të njëzetën herë. Më kanë marrë pa faj. Kam qenë fjetur kur kanë hyrë policia në dhomë dhe më kanë lidhur - filloi të fliste Remziu, me një zë pëshpëritës. – Më thonë se ia kam vjedhur pëllumbat djalit të Xhemajl Agës, po unë as me sy nuk i kam pa, sepse tjetër kush i ka dërguar në Turqi me aeroplan. Ndoshta më lëshojnë nesër se jam i pafajshëm. Remziu foli gati tërë natën për pëllumbat e djalit të Xhemajl Agës, për mënyrën si i kishte dërguar tjetërkush në Turqi dhe për shpresën se do të lirohej të nesërmen si i pafajshëm, megjithëse kur dola unë nga burgu, ai mbeti aty dhe më pati dhënë një porosi për një kameriere në një kafene të kryeqytetit.

Ditët e tjera ishin krejt të njëllojta me të parën. Dallimi i vetëm ishte se edhe unë kërcisja me pjatë e me lugë dhe shtyhesha në rend me pantallona të shpërthekuara para derës së nevojtores dhe kur vija në radhë, luaja herë me letra e herë me shah. Pas disa ditësh, kutërbimin e ajrit në dhomë as që e ndieja fare. As drita e fortë që rrinte tërë natën e ndezur si një sy ciklopi nuk më pengonte aspak për një gjumë të rëndë dhe pa ëndrra.

Ajo që më habiste më së shumti në fillim, ishte se përditë e më rrallë e kujtoja të dashurën time, Dritën. Fytyra e saj përditë e më shumë më

shprishej, si një pamje në ujin që e turbullon dikush. Në fillim bëja përpjekje që ta formësoja të plotë pamjen e saj, ashtu të brishtë e të bukur, po dikur hoqa dorë. Ajo pamje që formësohej, formësohej, megjithëse gjithnjë më e papërcaktuar dhe më e paqartë. Por, ajo ishte dhe s'kisha se çfarë të bëja. Po të humbisja kohë në përpjekje të dhunshme për ta krijuar të plotë pamjen e saj, mund të bëja ndonjë gabim me figurat e shahut dhe ta humbisja lojën. Si të durohej pastaj gallata e kolegëve! E vetmja pamje e plotë që më shfaqej ishte figura e nënës, me një pamje qortuese dhe me lot në sy. Ajo pamje e saj, sa herë më shfaqej, më torturonte pa masë dhe më bënte që të tërhiqesha në vetmi, në skaj të dhomës. Askush nuk më pyeste se çfarë kisha, sepse të gjithëve u ndodhte që të ndaheshin ashtu në skaj të dhomës së paku një herë brenda ditës.

Pas disa ditëve më nuk dija as cila ditë dhe as cila datë ishte. Koha ishte ngrirë në një pikë dhe nuk lëvizte. Ndoshta priste që të dilja nga burgu që t'ia niste sërish të lëvizte, aty ku kishte ngrirë ajo vetë dhe jeta ime. Po Shqipëria? E mbuluar me mjegulla, e mbajtur pezull në ajër, e shtypur nga të katër anët nga duar të përgjakura, me një formë që i përngjante lëkurës së regjur të dhisë së therur, ajo lëvizte nëpër trurin tim torturueshëm dhe këndshëm. Aty nuk mund ta gjenin as hetuesit, as gjykatësi, as gardianët. Ishte e imja.

# XIII

Sot është 18 qershor 1999. Po e shënoj në ditar rrëfimin që e dëgjova sot në fshatin Lumth. Meqë nuk mora fletore me vete kur u nisa në këtë ekspeditë, jam i shtrënguar të mbaj shënimet e mia në fletoren ku është dorëshkrimi i romanit që e gjeta ditë më parë. Kjo mund të mos jetë korrekte nga ana ime, po nëse e gjej autorin, do t'ia kthej fletoren e tij, bashkë me shënimet e mia, si dhuratë.

Duke na rrahur e sharë, na nxorën nga shtëpitë e na bënë grumbull në oborrin e shkollës së fshatit. Aty na mbajtën nja dy orë grumbull e mandej filluan t'i ndajnë burrat në një anë e gratë e fëmijët në anën tjetër. Fëmijët qanin me ngashërima që të këputnin shpirtin, gratë luteshin, ndërsa burrat ishin të shtangur, si të ishin të ngrirë. As lëvizjet nuk i kishin si të njerëzve të gjallë, po më shumë dukeshin si trupa lisash të krasitur. Dukeshin të vdekur, para se t'i korrnin plumbat. Pasdite burrat filluan t'i shtyjnë e t'i qëllojnë me shkelma e kondakë dhe i nisën teposhtë kodrinës së fshatit. Një kohë i pamë se si lëviznin, më shumë si trupa të krasitur a si hije, sesa si njerëz të gjallë. Mandej i përpiu lugina. Pas disa çastesh dëgjuam disa të shtëna automatiku, të

zgjatura dhe të thekshme. Filloi një vaj dhe një pështjellim që nuk ka si të rrëfehet. Qanin gratë, qanin fëmijët, më dukej se edhe kulmi i shkollës po qante. Por, një polic shkrehu automatikun në drejtim të turmës dhe disa gra e fëmijë u plandosën për dhe. Ne të tjerët ndalëm vajin e frymën. Nuk na linin as t'i kthenim mbarë të vdekurat. Mandej na dhanë udhë përtej Bjeshkëve të Nemuna, për në Shqipni. Atje na pritën e na strehuan si mundën e si ditën, na ndihmuan e na bën nderF. Vëllai të gjendet në ditë të vështirë.

E tash u kthyem, po ku të kthehemi. Shtëpitë shkrumb e burrat kurrkund. Nuk di si do të jetojmë. Ende i kam në vesh klithmat e grave e të fëmijëve që i korri automatiku në oborrin e shkollës dhe atë lëvizje të burrave kur po i përpinte kodrina.

Si këmbana të çrregullta e torturuese më kumbojnë në vesh këto fjalë të një gruaje që intervistuam sot, sapo u kthye në gërmadhat e shtëpisë së vet me tre fëmijë të vegjël. Derisa ajo fliste me zë të përvajshëm, me fytyrë të nxirë e pa asnjë lot në sy, mua më dukej se ato fjalë të saj i kisha dëgjuar edhe diku tjetër, edhe diku tjetër... Ndoshta në bodrumin e shtëpisë ku fshehesha, në lagjen Vellusha, edhe e kam krijuar në mendje këtë pamje të dhimbshme, në ato netët e pambarim të vetmisë e të frikës. Por, tash kjo grua nuk është personazh i përfytyrimeve të mia, po një grua që rrëfen tragjedinë e jetës së saj. Fytyra e saj është aq e ngurtë, sa më duket si një masë argjile, e murrme dhe e ngurtësuar në dhembje.

Sonte nuk nuk kam fuqi të lexoj më asnjë rresht nga dorëshkrimi. Dhe, as të shkruaj më, as edhe një rresht të vetëm.

# Spitali

Klinika ishte në një ndërtesë të madhe, gati e pafund, plot me korridore që u ngjanin labirintheve, që i kisha parë në filma. Në bodrumet e saj qenë vendosur morgu për të vdekurit, lavatorja, makinat e ngrohjes qendrore, reparti i fiziatrisë, zyra e pranimit, depotë, ofiçina e elektricistëve dhe e hidraulikëve dhe disa kthina ku hidheshin mbeturinat në disa kontejnerë gjigantë.

Në fillim unë mezi e gjeja zyrën e pranimit, ku më caktuan me punë, ndërsa për të tjerat mora vesh më vonë. Zyra e pranimit ishte në pjesën veriore të Klinikës. Sapo hidhja hapin e parë në teposhtëzen që shkëputej nga trotuari, më dukej se fillonte të më përpinte një thellësi e ftohtë dhe e frikshme. Dera e stërmadhe ishte gjithnjë e hapur, ndërsa gjithë ai korridor ishte pa një dritare të vetme. Megjithëse githnjë dritat ishin të ndezura, mungesa e dritareve më dukej një punë pa mend e atij që e kishte konstruktuar ndërtesën.

Në zyrën e parë, ku bëhej pranimi i të sëmurëve, ishte një tavolinë e gjatë e mbuluar me çarçaf të bardhë, në skaj një tavolinë e vogël e me një libër të madh përsipër, që ishte libri i protokollit, dhe asgjë

më shumë. Edhe sot në atë libër të madh, nëse është ruajtur, mund të gjenden emrat, mbiemrat dhe të dhëna të tjera të qindra pacientëve, të cilët i kam regjistruar në ditën kur janë pranuar në Klinikë. Me librezën e pacientit në dorën e majtë, kërrusesha paksa për të shkruar në librin e protokollit dhe gjithherë e ndieja pas disa çastesh një mpirje të lehtë në kurriz, sa më qe mbushur mendja se kisha një lidhje të çuditshme me të sëmurët, ngase një pjesë e dhimbjeve të tyre sikur kalonin në mua. Kjo bartje e dhimbjeve më duket se pati filluar që nga pacienti i parë që e regjistrova në librin e pranimit. Ishte një burrë i vjetër, tërë rrudha në fytyrë, i mbuluar nga djersë të ftohta, tepër i zbehtë, me sy gati tërësisht të mbyllur, ndërsa buzët i kishte të mbuluara nga shkrumbi. Kur e shtrimë në tavolinë, u mundua me njërën dorë që ta rregullonte disi plisin e bardhë që e kishte në kokë, po plisi iu bë lëmsh dhe i ra nga koka anash. Njëri nga njerëzit që e shoqëronin, një djalë i ri, e mori plisin dhe u mundua ta fusë në xhep, po kur nuk ia zuri xhepi, e futi nën sjetull. Plaku ia kërkoi plisin, po mjeku i tha me njëfarë zemërimi:

- Plak, nuk ka çka të duhet plisi këtu.

- Më është mësuar kryet...po më nerth kryet...

- Është dashur ta ruash kokën më herët, e jo plisin tash!

- O bir, mbuloma kryet me diçka se po më nerth - tha burri me një zë edhe më të ulët.

Djali që e shoqëronte, ia mbërtheu disi plisin në kokë, ndërsa unë e regjistrova emrin e mbiemrin, Mehmet Manxholli quhej, e mbaj mend si sot, dhe

ndjeva një dhimbje në kurriz. Ai burri kishte rënë nga pullazi i shtëpisë dhe e kishte lënduar kurrizin, aq sa nuk mund të lëvizte asnjërën këmbë. Nuk mund të them se ndieja gjithnjë qartë atë dhimbje, tek shkruaja në librin e pranimit emrat e pacientëve, po për ta ndier shpesh, vërtet e ndieja.

Ajo ditë prilli filloi pothuaj si të gjitha ditët e tjera. Hyra në zyrën e pranimit dhe pasi përshëndeta motrën Anita, e cila atë ditë m'u duk më pak e mërzitur sesa herave të tjera, u ula në karrigen time, ku bëja regjistrimin e të posapranuarve. Në fillim m'u duk sikur dikush po trokiste në ndonjë gjë në korridor. Mandej krismat filluan të vijnë më të shpeshta dhe disi më të qarta. Anita u ngrit në këmbë dhe doli jashtë, pa më lënë mundësinë që ta pyesja se çka mund të ishte ajo krismënajë. Kur dola në korridor, duke mbajtur me njërën dorë kurrizin, që më ishte mpirë, ekipi i ndihmës së shpejtë, po e nxirrte pacientin nga autoambulanca. Ajo që më zuri syri menjëherë, ishin njollat e gjakut në kraharorin e tij. U afrova me ngut dhe e mbajta njërën dorëz të lesës. E futëm brenda zyrës së pranimit, e shtrimë në shtratin provizor dhe motra Anita filloi t'ia zhvishte me shpejtësi rrobat e përgjakura.

- Kanë rifilluar demostrata në qytet! - tha shoferi i autoambulancës.

- Demostrata?! - pyeti doktor Luli.

- Po bëhet hataja! Kanë filluar të qëllojnë me armë në turmë!

- Kush? - pyeti sërish doktori.

- Policia, kush tjetër! Po bëhet hataja! Mund të ketë shumë të vrarë e të plagosur.

Shoferi e rroku lesën në mes të saj me të dy duart dhe e nxori jashtë. Në dysheme mbetën njollat e gjakut që kishin rrjedhë nga lesa. I plagosuri nuk lëshonte asnjë zë, ishte i alivanosur. Mjeku filloi t'ia shikonte plagët, pastaj me një zë të dridhshëm i tha motrës Anita që t'u thoshte ekipit, se pacienti menjëherë duhej të futet në sallën e operacionit. Anita doli, ndërsa unë vazhdoja të rrija në krah të doktor Lulit, pranë të plagosurit. Ishte një djalë i ri, megjithëse zbehtësia që e kishte pushtuar fytyrën e tij, nuk linte ndonjë mundësi që të dihej mosha e tij. Një tis i djersëve i ishte shtrirë ballit. Plaga në anën e djathtë të kraharorit, nga ku rridhte currili i gjakut, dukej fare e vogël, si të ishte një e shpuar me majë gozhde. Por, currili i gjakut rridhte me ngut. Doktor Luli e mbajti vendin e plagës me gisht, më kërkoi një gazë, pastaj e vendosi gazën dhe filloi ta shtypte. Krismat megjithëse të paqarta dëgjoheshin vazhdimisht. Zyra e pranimit u mbush në çast me motra e mjekë, madje edhe disa të sëmurë kishin zbritur nga dhomat e tyre për të parë së çfarë bëhej poshtë. Pastaj u dëgjua sirena e autoambulancës, mandej edhe një tjetër pas saj dhe zyra e pranimit u mbush me të sëmurë. Më dukej se mbinin nga dheu dhe dilnin aty para këmbëve të mia, të gjakosur, të zbehtë, të alivanosur, me sy të mbyllur, me këmisha të përgjakura, me nga një tis djerse ballit... Nganjëherë më dukej se shihja një film të frikshëm, po kjo ide zhdukej shpejt. Sekush kërkonte ndonjë

fashë ose kërkonte që një i plagosur të nxirrej jashtë zyrës e të nisej për në sallat e operacionit. Njëri prej të plagosurve, një djalë krejt i ri, kur e ngrita lesën që ta nisnim për në njërin nga repartet, më shtrëngoi krahun dhe më tha me një zë lutës:

- A ma kryen një amanet?

- Po - ia ktheva, duke u mundur që ta shikoja më me vemëndje.

- Jam nga Bregmali. Nëse më ndodh diçka, të shkosh dhe t'i thuash babës se e kreva porosinë e tij!

- Nga Bregmali? Mirë. Po mos kij dert. Ti do të shkosh vetë në shtëpi. Plaga jote nuk është serioze.

- Ma kryej këtë amanet, të lutem!

Atë të plagosur e vendosëm në repartin e kirurgjisë torakale, sepse edhe ai kishte plagë në kraharor. Kur u ktheva në zyrën e pranimit, rrëmuja ishte e plotë. Dhjetra të plagosur dergjeshin të shtrirë nëpër korridor, duke pritur që t'u konstatohej diagnoza dhe të përcilleshin në reparte ose në sallat e operacionit. Korridori ishte mbushur edhe me policë të armatosur, të cilët çirreshin, flisnin me interfona, jepnin e merrnin komandë dhe shtynin herë andej, herë këndej njerëzit që gjendeshin në korridor. Ishin të egërsuar.

Pasdite u ndalën ardhjet e autoambulancave të ndihmës së shpejtë, megjithëse krismat dhe brohoritjet e klithmat e demonstruesve dëgjoheshin ende. Na erdhi lajmi se policia kishte urdhëruar që të plagosurit të liheshin nëpër rrugë, aty ku qëlloheshin dhe që të mos u jepej kurrfarë ndihme mjekësore. U mpimë të gjithë. Askush nuk dinte se çfarë të thoshte. Pastaj dikush, më duket Hakiu, tha se duhet

të shkojmë e t'i marrim vetë të plagosurit. As vetë nuk e di si rrodhën punët në ato çaste, përveç se e di që pas disa çastesh isha në rrugë me doktor Safetin, me veturën e tij, diku pranë Qendrës së kryeqytetit. Tankset si kafshë parahistorike rrëshqisnin në të dy krahët e rrugës kryesore, duke lënë prapa vetes zhurmë dhe tmerr. Disa vetura digjeshin anash rrugëve. Tymi e kishte mbuluar qendrën e kryeqytetit. Pastaj u ngjitëm drejt Parkut, atje ku ishin protestuesit. Një zhurmërimë e mbështjellë me klithma gëzimi, me duartrokitje dhe me zëra të gëzueshëm - ishte pritja që na u bë në mesin e protestuesve. Por, në atë vend nuk kishte të plagosur, sepse i kishin evakuuar, i kishin fshehur nëpër shtëpitë e afërta. Pastaj u nisëm drejt veriut, te Kodra e Trimave. Shenjat e konfliktit të protestuesve me policinë atje ishin më të qarta. Disa vetura të policisë ishin në flakë. Aty morëm dy të plagosur dhe me shpjetësi u nisëm drejt Spitalit. Brenda asaj dite disa herë i ramë kryq e tërthor qytetit, në mes të tankseve dhe të turmave të egërsuara të policisë. E vetmja gjë që i hutonte ata ishte uniforma jonë.

Të nesërmen, dikur nga mesdita, u ngjita në repartin e kirurgjisë torakale, që ta shihja atë djalin që më dha amanetin. Nuk e di as vetë se çfarë më shtyri të shkoja e ta kërkoja, megjithëse ishim në rrëmujë të punëve. Pyeta motrën kryesore të repartit, ajo më shikoi hetueshëm, më pyeti se mos e kisha farefis, pastaj më tregoi se djali kishte vdekur në mesnatë nga një gjakderdhje pasoperative. I mora emrin dhe mbiemrin, emrin e vendlindjes ia kisha mbajtur mend dhe zbrita poshtë. Tërë ditën më nde-

nji në kujtesë ajo fytyrë e tij dhe fjalët e tij më tingëlluan në vesh. Prej nga e kishte ai parandjenjën se do të vdiste? Pse më la atë amanet për babën e tij? Çka është ajo forcë që na paralajmëron? Kaq shumë pyetje më silleshin në kokë. Pas dy javësh, edhe pse nuk ishte hequr shtetrrethimi, ia mësyva Bregmalit dhe e gjeta shtëpinë e Astritit të ndjerë, për t'ia çuar amanetin babës së tij. Më pritën sipas zakonit, pa më pyetur kush isha e nga isha, edhe pse askush nuk më njohu. Pak para se të largohesha, babës së tij ia përcolla fjalët e të birit, që më kishte lënë amanet. Mbaj mend atë qetësi të thellë që ra në odë, e që nuk mund të përshkruhet. Ishte një qetësi si të jesh në fund të pusit, atje ku nuk ka as ajër, as dritë, as jetë.

- Falemnderit, mik! Po unë e kam ditur. E kam ditur si një e një që bëjnë dy se kështu do të përfundonte kjo punë. I kam pasë thënë që të vazhdonte rrugën time. Dhjetë vjet kam qenë në burgje. E kam pasë lënë tri vjeç e e gjeta gati burrë. I thosha që ta vazhdonte amanetin.

Zëri vinte duke iu dobësuar deri sa iu shtor. Rrinte kokulur dhe dukej si një shtatore e ngrirë. Kur më përcolli deri te dera e oborrit, më falënderoi dhe në fund më tha:

- E kam ditur. E kam parandier!

Edhe sot, pas njëzet vjetësh, e kam para sysh atë pamje të kërrusur burri, me atë pikëllim të skalitur në fytyrë dhe me atë shkëlqim të fshehtë në dritat e syve. As sot nuk mund ta shpjegoj atë kontrast, atë pikëllim të pamatë të ngjizur me një gëzim të fshehtë. Dhe s'ka se si shpjegohet. Si është e shpjegueshme kur djemtë e rinj i dalin përballë vdekjes, dhe bien në lulen e rinisë?

Tash në këtë moshë, në prag të pleqërisë, në këtë përpjekje për të rikthyer njohjen e vetes, për të mundur mosnjohjen e shtresuar nga mashtrimet e pasuesve të djajve, e kam më të qartë: ai është mision që u jepet atyre nga Krijuesi ynë, për të na e ndriçuar rrugën me dritën e vdekjes së tyre. Po ne as atëherë e as tash nuk marrim vesh.

# Frika

Derisa unë po flisja me telefon me një mikun tim në Gjermani, Flamuri ma bëri këtë fotografi, të cilën ma dha pas shumë kohësh, kur e kishte zbrazur arkivin e tij të fotoreporterit. Kjo fotografi më përngjet shumë me pasqyrën. Kur ishim të vegjël na thonin: "Mos u shikoni gjatë në pasqyrë se mund të çmendeni!". Nuk e di se a është bezdia ime e përhershme nga pasqyra, pasojë e kësaj vërejtjeje të frikshme, po mua më ka mbetur një frikë nga shikimi i gjatë në pasqyrë tërë jetën. Fotografia e bë-rë nga miku im, Flamuri, një paradite në redaksinë e gazetës, dhjetë vjet pas largimit tim nga spitali, më bën të mendoj për veten me një brengë.

Njeriu fsheh gjithmonë diçka edhe nga vetvetja. Nën pamjen e një fotografie të një burri të buzëqeshur, dinjitoz, mendjemadh, mund të ketë qenë një njeri i frikësuar e i deprimuar, por ajo gjendje është fshehur me një buzëqeshje të shpifur. Mos është kjo fshehje në fotografinë e bërë nga Flamuri? Ah! Një herë, derisa po kthehesha nga shkolla, dhe nuk e di pse isha pa asnjërin nga shokët e klasës me të cilët e bënim rrugën bashkë, m'u vërsul qeni i Ademit të Ramës. Ai doli nga oborri me

një të lehur të mbytur dhe më ndiqte rrugës së përbaltur. Ishte një qen i zi, të cilin e kisha parë sa e sa herë, e kishim gjuajtur me gurë dhe e kishim vënë në lojë me imitim të lehurash, unë e shokët e tjerë të klasës, po tash ishte shumë më i madh dhe si një qenie e dalë nga ato tregimet e frikshme të nënës, një kuçedër që të përbinte me një kafshatë. Mora në thua dhe rashë përmbys, duke qarë me një zë të thekshëm që më dukej se e mbushte tërë luginën e Shegëzës më frikë. Qeni i zi m'u afrua, më preku trupin me hundë dhe u largua menjëherë, si ta kishte rrahur dikush me litar të lagur. Sa herë shkoj në vendlindje dhe kaloj pranë shtëpisë së Ademit të Ramës, më duket se del përnjëherë nga oborri ai qeni i zi dhe vërsulet drejt meje me ata sy xixëllues dhe me atë tkurrje të frikshme të muskujve. Mundohem ta harroj, por e kam të pamundur. Bashkudhëtari mund të flasë plot pasion, për Hiroshimën dhe Nagasakin, por mua pamja e qenit që më ndjek në një muzg vjeshte në fëmijërinë e largët, më dominon ato çaste në kujtesë.

Ndërsa një herë deri sa po ecja nëpër rrugën kryesore të një qyteti të madh, të huaj, dhe isha përhumbur pas vitrinave që reklamonin gjithfarë mallrash, në çastin kur po e ndjeja njëfarë relaksimi, përnjëherë vitrinat vezulluese filluan të më shfaqin pamjen e deformuar dhe kërcënuese të dikujt tjetër. Lëvizjet e asaj pamjeje njeriu ishin të frikshme dhe kërcënuese, më afroheshin aq sa dukej se do të më kapnin për fyti, me ato duar, që ngriheshin me një forcë të nëndheshme inatçore dhe hakmarrëse. Ajo

nuk ishte pamja ime e thyer dhe në përmasa më të mëdha në pasqyrat e vitrinave vezulluese. Ishte një tjetër pamje e dikujt që shfaqej e shpërbëhej me një mision hetues dhe ndjekës deri në lemeri. Më duket se një herë, shumë më herët e kam parë në ëndërr atë pamje të frikshme dhe më ka dalë gjumi pa e zënë një sekuencë të vetme peng të pjesës së ndërgjegjshme. Mirëpo, më duket se ishte po ajo pamje që dilte për të vazhduar aty ku e kishte lënë hetimin dhe ndjekjen time. Në një vitrinë të një librarie kjo pamje m'u ngatërrua me emrat e shumë shkrimtarëve: Sabato, Markes, Bukovski, Gëte, Ygo, Eliot, Jejts, Marlo, Sartër, Ulo, Breht... Përpiqesha të përqendrohesha tek emrat e shkrimtarëve, të kujtoja biografitë e tyre, veprat e tjera që i kishin bërë të pavdekshëm, vitet e lindjes dhe të vdekjes, vendin ku gjendeshin ata që rronin ende. Për Sabaton e gjeja se përveç Tunelit, që ishte aty, kishte edhe një roman me titull të jashtëzakonshëm: Për heronjtë dhe varrezat, e gjeja se ishte me një prejardhje që mund të quhej edhe shqiptare, se kishte qenë anëtar i një komisioni shtetëror për gjetjen e të zhdukurve në kohën e diktaturës... Por, në një çast pamja kërcënuese e dikujt nga vitrina ma errësonte kujtesën dhe krejt çka dija ishte lakmia që kisha për Sabaton që ishte pothuajse i verbër. Po të ishte ai përballë kësaj vitrine, do të qëndronte krejt i qetë dhe qetësia e tij do ta tërbonte atë pamjen në xhamin vezullues të vitrinës. Kurrfarë kërcënimi i asaj pamjeje nuk do të pinte ujë. Emri i Markesit në një libër me shkronja të arta më qetësoi për disa çaste, po sapo m'u kujtua pamja e vajzës së vdekur

me flokë disa metra të gjatë, e cila ishte zhvarrosur pas shumë e shumë vjetësh, më kapi tmerri dhe pamja në xhamin e vitrinës lëvizi me një fuqi të përbindëshit. Desha të mbrohesha me idenë se Markesi është mik i Fidel Kastros, se i ka do mustaqe kurrfare, se intervistat e tij janë shumë agresive, ku ai gjithmonë mundohet të shfajësohet për diçka që askush më duket se nuk e akuzon (Kolumbia është një vend me mjegulla që i ngjan tymit të marihuanës - kjo fjali më qe ngjizur në kujtesë atë çast dhe kurrë nuk e kam harruar këtë krahasim!), por para asaj pamjeje kërcënuese në xhamin e vitrinës gjithçka u çarmatos. Shikova emrin e Bukovskit në një libër me kopertina të trasha ku shkëlqente pamja e një gruaje lakuriqe. Përshkrimi i skenave erotike, duhma e alkoolit, tymi i cigares që të zë frymën dhe të errëson pamjen, ngasja e veturës me sy mbyllur, prapë gruaja lakuriqe e shtrirë në shtrat duke pritur që t'i hidhet përsipër burri i dehur që zhvishet me përtesë pa e hequr cigaren nga goja, më kaloi nëpër kujtesë me një shpejtësi marramendëse. Por, të githa këto përfytyrime të mbajtura mend nga leximi i atij romani dhe të sajuara nga asociacionet, shpërbëheshin e binin të vdekura para asaj pamjeje kërcënuese që villte tërbimin e vet ndaj gjithçkaje që kishte përballë vetes. Ajo që ndodhi pastaj, nuk ishte largim. Ajo ishte ikje me një vrap të pakontrolluar. Hapat më dukej se nuk ishin të mitë, po të dikujt tjetër që ikte. Si në motivet e poezive të Oktavio Pazit. Detyrohesha të ikja dhe vetë, ngase isha i lidhur me atë tjetrin si me pranga. Shfaqja e qenit të zi, që sa

vinte e rritej në përmasat e përbindëshit, të lehurat e tij të nëndheshme, kërcëllimi i dhëmbëve, prekja me hundët e përjargura në këmbët e mia, derisa po bija përmbys, qenë gjithçka që mbajta në mend, para se të më rikthehej kujtesa në shtratin e spitalit të qytetit të huaj e armiqësor.

Pse frika nganjëherë shfaqet e nganjëherë nuk shfaqet? Asgjë nuk varet prej meje, po nuk varet as prej frikës. Ajo vetvetiu nuk mund të shfaqet as të më bëj gjë. Tash e di: Krijuesi na tremb me frikë, që të përkujtojmë e të mos gabojmë në pafundësi. Ne e kemi të programuar frikën në ndërgjegje dhe ajo aktivizohet sa herë duhet të na përkujtojë se jemi në kufi të stërngarkimit me mëkate e me të këqija. Dhe kur na paralajmëron për diçka.

Lexuesit e mundshëm do të mund të thonin nën hundë, ç'është ky mistifikues i gjërave, pse ka nevojë të na shet mend, thuajse e ka zbuluar Amerikën, por unë nuk do t'ua japë atë kënaqësi. Le ta zbulojë secili këtë të vërtetë të madhe: frika është një sprovë dhe një paralajmërim para se të zhytemi në fatkeqësi.

# XIV

Në fillim trupi m'u shtang nga një shtrëngim që përfshinte muskujt e këmbëve dhe muskujt e shpinës, aq sa më vinte të ulërija nga padurimi. U përpoqa t'u bëja një masazh muskujve të këmbëve me duar, eca si i çartur nëpër dhomë, bëra disa ushtrime gjimnastikore që i dija nga koha e gjimnazit, po gjithçka ishte e kotë. Shtrëngimi sa vinte e bëhej më i egër, më i padurueshëm. Pastaj m'u shfaq njëfarë hije para sysh, e lehtë në fillim po erdhi duke u errësuar në njërën anë derisa u shndërrua në helmetë. E pashë qartë se kishte formën e helmetës së policisë dhe deshifrova edhe emblemën me flamurin trengjyrësh. Fërkova sytë disa herë, po nuk ndihmonte asgjë që të largoja frikën që më kaplonte si një vrushkull i ftohtë uji. Si t'ia bëja, nga t'ia mbaja, ku të fshihesha, mendimet më vlonin në kokë të përziera me përfytyrime të frikshme, mbi të cilat shquhej kërcënuese pamja e helmetës me emblemën me flamurin trengjyrësh. Muhamet zbrit poshtë, fshehu, fshehu! Nuk e di a ishte vërtet një thirrje e brendshme që më detyroi të zbrisja shkallët, apo këtë variant e krijova më vonë në mendjen time, por e vërteta është se si i urdhëruar

nga një forcë e panjohur u nisa korridorit dhe pastaj shkallëve teposhtë për në bodrum. Nuk e di si u bë që shmanga disa thasë e disa dërrasa dhe në thellësi krijova një strehimore të vogël, ku u futa si me komandë. Ende pa e kuptuar mirë se çfarë po bëja, dëgjova rrapëllimën e derës së hyrjes së shtëpisë dhe hapat që vërshuan nëpër korridor, e pastaj shkallëve teposhtë drejt bodrumit. Më e madhja çudi ishte se kur policët gjendeshin në bodrum dhe po bënin rrëmujë duke plaçkitur, unë isha shumë më i qetë sesa kur as mendja nuk më kishte shkuar se ata mund të futeshin në shtëpinë time. Lutesha me mendje, lutesha me shpirt dhe kjo më qetësonte më shumë se gjithçka. Frika që m'u shfaq vetëm gjysmë ore para se të vinin policët në shtëpinë time, ma shpëtoi jetën. Dhe, sot jam gjallë, me këtë ekspeditë humanitare në terren, dhe me këtë dorëshkrim në dorë si një mesazh i lënë nga një autor i çuditshëm.

# Mbreti

Baba e përmendte nganjëherë, megjithëse shumë rrallë, dhe më duket vetëm kur ishim krejt vetëm në shtëpi. Mbretin Zog. Emrin ia thoshte disi shpejt, si për të fshehur diçka. Dhe sikur ta ndiente hutimin tim, ai nuk harronte të thoshte "mreti i Shipnisë". Fytyrën ia përflakte njëfarë shkëlqimi, kur fliste për mbretin Zog dhe kur tregonte se ai ishte i vetmi burrë që e kishte mashtruar "kralin e Serbisë". Rrëfimi i babës gjithnjë ishte i ngatërruar dhe unë nuk e kuptoja se për çka ishte tamam fjala, sepse përzihej Vermoshi, Shën Naumi, Peja e Gjakova, Londoni, Parisi, përziheshin kohët dhe krejt çka më mbetej e qartë në kujtesë ishte figura e Mbretit Zog, "mretit të Shipnisë", e mjegullt, po në përmasa gjigante, me një buzëqeshje të shtrirë tejpërtej fytyrës. Baba më kishte treguar se çka është mbreti, megjithëse unë vetëm e përfytyroja një njeri të madh, gati sa Kodra e Arës, hija e të cilit shtrihej në të katër anët dhe e zinte krejt Shegëzën. Babë, a mund ta takoj unë mbretin Zog?- e pata pyetur një natë papritmas. Më saktë, as që e di se si më dolën fjalët. Baba më shikoi me habi, kruajti kokën nën plis dhe tha prerazi:

- Jo. Nuk ke ku e takon as ti dhe askush.

- Pse?

- Mbreti nuk asht as në Shipni s'e le ma. As aty nuk i kanë lanë vend komunistat - tha baba më njëfarë pezmi të çuditshëm.

- Po a është diku?

- Po, biro, po. Mbreti edhe nëse vdes, e ka trashëgimtarin. Po nuk kemi si ta takojmë ne, o bir!

- Dini më ka thënë se Enver Hoxha është kryetar i Shqipninë- i thashë me zë të dridhshëm.

- Kryetar po, ama ai është komunist e nuk ka hajr prej tij. Mreti i duhet Shipnisë. Baba pinte duhan me kamish. Hoqi plisin dhe e vuri në gjurin e majtë, e lëmoi plisin me dorë si të ishte plisi një lidhje e fshehtë e tij me shpresën për kthimin e mbretit në fronin e Shqipërisë. Dhe nuk foli më.

Pas shumë e shumë vitesh nga ajo natë dimri, derisa Leka i Parë, Mbret i Shqiptarëve, po priste t'u përgjigjej pyetjeve të mia në një intervistë, të cilën ia merrja në vigjilje të festës sonë kombëtare, ai përfytyrim fëmijërie, po më bezdiste. Mbreti pinte duhan dhe shikonte diku në skaj të sallonit, ndërsa fytyra e tij ruante qetësinë vërtet mbretërore.

Unë po i vonoja pyetjen, sepse pamja e "mretit të Shipnisë", ajo pamje e imagjinuar në fëmijëri, në ato përmasa të papara, nxirrte kokë në përfytyrimin tim real e më bllokonte gojën. Edhe zëri i prajshëm i babës tek përsëriste fjalët "Po nuk kemi si ta takojmë, o bir!", më dukej se më dilte nga veshët dhe e mbushte hapësirën e sallonit me një ajër më të ngrohtë.

Pastaj biseda me mbretin rrodhi krejt e qetë. Zëri i prajshëm i tij, fjalët e thëna me ndërprerje, si për t'i matur sa më mirë (pa e hequr asnjëherë shikimin nga një pikë në skaj të sallonit), arritën të më nxirrnin disi nga atmosfera e kujtimeve dhe e përfytyrimeve të fëmijërisë. Brengat e mbretit për fatet e kombit tonë, edhe pse të thëna me fjalë disi të buta dhe me një zë të ulët, si të druajtur, nguliteshin në ndërgjegjen time, në një formë gati materiale.

Fytyra ime në ato çaste nuk mund ta kishte atë krenarinë që e vëreja në fytyrën e babës, sa herë që rrëfente për Mretin Zog, "mretin e Shipnisë", sepse unë isha para mbretit, e jo para përfytyrimit për Mbretin. Ah, po të ishte gjallë baba! Si do t'ia kujtoja pyetjet e mia dhe përgjigjet e tij të dikurshme për takimin tim me mbretin! Në të vërtetë, baba më paskësh përgatitur shpirtërisht ta kërkoja mbretin e Shqipërisë.

# Gazeta

Ende pa u ulur mirë në karrige, hyri drejtori dhe më përshëndeti me një ton që shkiste disi turbullt ndërmjet solemnitetit dhe kërcënimit. Ai tha se redaksia e gazetës më mirëpriste dhe se ata të gjithë prisnin prej meje korrektësi, punë dhe përgjegjësi. Pastaj drejtori doli, ndërsa unë mbeta vetëm me kryeredaktorin. Ai ishte gërmuqur i tëri mbi një tekst, thuajse përfytej me autorin. Dikur ngriti kokën, ndezi një duhan dhe tha gjithë mërzi:

- Ky autor është analfabet. Ma hëngri shpirtin!

Unë nuk fola kurrgjë. Nuk e dija as kush ishte ai autor dhe as e dija se çfarë duhej të thosha. Flitej shumë në atë kohë për kryeredaktorët si njerëz të ashpër, të cilët kryenin punën sipas urdhërave të partisë. Me atë bindje dhe me atë druajtje isha edhe kur konkurova për atë vend pune, por s'kisha se çfarë të bëja. Puna në administratë më mërziste jashtë mase. E shikoja zyrën si një përbindësh të frikshëm, që më merrte frymën. Dhe dëshiroja që të ikja prej saj sa më larg. Gazetaria ishte profesioni më i përshtatshëm për të ikur nga zyra-përbindësh. Ishte një profesion i terrenit dhe i kafeneve. Prandaj dhe u gëzova fort kur më pranuan në gazetë.

- Hë? - m'u drejtua kryeredaktori, kur unë nuk thashë asgjë në ankesën e tij.

- Nuk di.

- Do të dish shpejt. Dhe do të tmerrohesh nga shkalla e analfebetizmit të atyre që zakonisht quhen intelektualë.

- Po pse është kështu?

- Si pse? Po këta janë disa njerëz të partisë, të cilët kanë marrë grada shkencore e tituj akademikë për shkak të pozitave partiake. Emrat i stolisin me shkurtesat DR ose MR po në fakt janë analfabetë. Kjo është puna. Shijoje pak këtë tekst!

- U afrova dhe e mora tekstin në dorë. Ai ishte i gjithi i mbushur me korrigjime me laps kimik mbi radhët e shtypura me makinë. Kryeredaktori kishte fshirë rreshta të tërë dhe i kishte zëvendësuar me ndonjë fjali të veten ose thjesht e kishte shkurtuar tekstin.

- A e sheh? - pyeti kryeredaktori, dhe e zgjati dorën që të merrte tekstin.

- E habitshme! - gjegja. Ky autor është shumë i njohur. Të gjitha tekstet i ka kështu?

- Të gjitha. Dhe unë e lektorët bëjmë një punë të rëndë, për t'i sjellë në gjendje normale. Realisht ne jemi autorë të teksteve që botohen me firmën e tij.

Figura e autorit të atij teksti m'u shfaq e plotë në kujtesë, nga një konferencë partiake që ishte transmetuar në televizion. Ai kishte përvjelë mëngët e këmishës, e kishte shpërthekuar jakën dhe pas çdo fjalie pinte ujë mineral. Fliste me zë të lartë, veçmas kur përmendte sintagmat "nacionalizmi shqiptar", " separatizmi shqiptar", "fundamentalizmi shqiptar". Në ato raste ndodhte që edhe e qëllonte tavolinën me grusht, zakonisht me grushtin e dorës së majtë,

sepse dorën e djathtë e mbante ngjitur me gotën me ujë mineral. Kishte gradën doktor i shkencave, ishte profesor universiteti, autori i shumë teksteve shkollore dhe universitare..

- Të këtillë janë të gjithë këta funksionarët! - foli sërish me inat kryeredaktori. E kishte përfunduar redaktimin e atij teksti.

Në ditët dhe muajt që rrodhën unë takoja shumicën e atyre autorëve në redaksi, ku ata sillnin tekstet e tyre. Hynin me hapa të rëndë, gjithë solemnitet, disa prej tre me pallto krahëve, ndaleshin dy-tre hapa brenda redaksisë dhe nuk lëvizninn pa u ngritur ne dhe pa u afruar që t'ua zgjasnim dorën. Pastaj merrnin dhe uleshin rëndë-rëndë, shikonin orën, përgjigjeshin kur i pyesje për shëndetin e për punën dhe hapnin çantat e nxirrnin tekstet e tyre dhe ia zgjasnin kryeredaktorit. Pinin kafe dhe pastaj nxitonin për në ndonjë mbledhje, për në ndonjë konferencë shkencore ose për në ligjërata. Pamja e tyre e jashtme ishte mbresëlënëse. Por, vinte momenti kur duhej të ballafaqoheshe me tekstet e tyre dhe aty ata ishin njerëz të tjerë. Fjali të përdredhura me citate nga kolosët e marksizëm-leninizmit, nga rezolutat e kongreseve të partisë, nga konkluzionet e plenumeve të komiteteve, me gabime të panumërta drejtshkrimore, me shenja të pikësimit të hedhura pa asnjë logjikë, tekstet e tyre ishin një torturë e vërtetë. Në fillim nuk më dukej edhe aq e rëndë puna me ato tekste, po pas disa muajsh unë e ëndërroja punën time në spital.

Një egërsim i vazhdueshëm hetohej në tekstet e atyre autorëve. Dita-ditës shtohej numri i citateve të kolosëve të marksizëm-leninizmit dhe i konkluzioneve të plenumeve. Por, numri i gabimeve drejtshkrimore dhe të interpunksionit rritej

dhjetëfish më shumë. Tekstet shndërrohershin në një mishmash gjuhësor, sa dikur as Lami, lektori më i përkushtuar, nuk ishte në gjendje të formonte fjali nga ata rreshta të çakërdisur. Mu në kohën kur çakërdisja e atyre teksteve ishte bërë një torturë e papërballueshme për të gjithë ne, plasën demonstrata të mëdha politike në kryeqytet dhe në tërë vendin. Policia përdorte gazin lotësjellës në fillim, e më pas edhe plumbat për të thyer protestat. Mirëpo ato vetëm sa zgjeroheshin dhe bëheshin gjithnjë e më masive. Pikërisht në ato çaste kritike, në televizion filluan të dilnin me radhë dhe të jepnin intervista e të bënin apele 'për qetësimin e gjendjes", ata autorët e teksteve të çakërdisura që ne përpiqeshim t'i redaktonim. Të veshur mirë, të pudrosur dhe të krehur nga ondulueset e studios së televizionit, me gotat e ujit mineral përpara, ata flisnin e flisnin për liritë që i kishte populli ynë, për të drejtat që na i kishte dhënë partia e tyre dhe për interesin "që të qetësohej situata". Në fillim e tëra më dukej vetëm një prezentim banal, një humbje kohe që bënte televizioni dhe ata vetë. Por, pas disa ditësh, demostratat po vinin duke u shteruar dhe numri i pjesëmarrsëve po binte. Atëherë e kuptova se ekzistonte një lidhje ndërmjet intervistave në televizion të atyre autorëve dhe rënies së intensitetit të protestave. Nuk ishte ky kurrfarë zbulimi, sepse lidhja ishte e dukshme dhe krejt e logjikshme. Njerëzit që ishin mësuar që për vite e vite që të lexonin tekstet e atyre autorëve, që t'i shihnin në katedra, në konferenca dhe më televizion, tash stepeshin para fjalëve të tyre. U turbullohej pamja e ngjarjeve. Studentët thërrisnin për protesta, ndërsa profesorët e tyre thoshin se ato nuk ishin në interes të popullit. Profesorët e dinë më mirë se si ishin punët, mendonin

njerëzit dhe stepeshin. Pas serisë së paraqitjeve në televizion të autorëve të njohur dhe pas shterjes së demostratave, filluan arrestimet e aktivistëve. Sërish ishin autorët tanë, të cilëve ne u redaktonim tekstet në gazetë, ata që arsyetonin veprimet e shtetit ndaj "armiqve të popullit".

Megjithëse me vonesë të madhe, më në fund e kuptova se për çfarë shkaku shteti i kishte mbajtur aq mirë ata autorë, për çfarë shkaku u kishte dhënë grada shkencore, u kishte lejuar që të botonin libra e të ishin anëtarë të forumeve të larta partiake dhe universitare. Me intervistat dhe me apelet e tyre, shteti kryente punën më lehtë se me gazin lotësjellës dhe me plumbat, për të thyer popullin tonë. Më therte zemra se edhe ne të gazetës, duke përmirësuar gabimet e atyre autorëve, kishim ujitur bimësinë e krimit.

# Vetmia

Agimi flet me një zë të ulët, ritmik, dhe ka kohë që sikur pret që ta ndërpres me ndonjë pyetje ose me ndonjë plotësim.

- Nju Jorku është simboli më i madh i vetmisë njerëzore, përsërit Agimi. Mund të jetosh me vite në atë qytet dhe mos të të njohë askush dhe mos të njohësh askë. Unë tash dhjetë vjet jetoj në Bronks, dhe mund të them se askë nuk e njoh. Askujt nuk ia di emrin, nuk e di nga është e me se merret. Megjithëse ka shumë shqiptarë në Bronks, unë nuk i njoh dhe as ata më njohin. Na mbulon mosnjohja, si mjegulla e vjeshtës, vëlla!

Ndez cigaren dhe e thith disa herë ngjim me kokën ulur, sa më duket se është krejt i shpërqëndruar. Vërej se flokët i kanë rënë në majë të kokës më shumë, i janë holluar disi dhe më shumë duken si të ishin artificiale.

- Nuk mund ta marrësh me mend se çfarë ritmi i jetës është ai që bëjmë ne atje. Ag e terr në punë, pa pasur kohë për asgjë tjetër. Duhen shumë të holla për jetë, vëlla. Askush nuk çan kokën për ty. Gjithçka duhet ta arrish vetë. Nga të gjitha anët të shtrëngojnë kërkesat për para: po s'pate para, s'ke

asgjë. S'je kurrkushi. As fëmija yt nuk të njeh. As gruaja jote nuk të respekton. Paratë dhe sendet kanë vlerë, vëlla. Paratë dhe sendet janë gjithçka.

Derisa Agimi flet, një figurë e panjohur në xhamin e dritares së odës lëviz një shkop të vogël. Ai farë fëmije andej, herë shfaqet e herë zhduket, varësisht nga lëvizjet e dritares.

- Kush e lëviz krahun e dritares?

- Kush është që shfaqet e zhduket në xhamin e saj?

- I kujt është xhami?

- E kujt është ajo pasdite e verës?

- Pse jam vetëm në shtëpi?

- Çka është vetmia?

- Tërë jeta është një vetmi, çka kujton ti?

- A ke lindur vetëm apo me krejt dynjanë?

Pas një heshtjeje të gjatë, e cila mbulohet nga pyetjet e shumta si një udhë parku nga gjethet e vjeshtës, me një zë të pavendosur, jo se nuk jam i bindur për mendimin tim, po ngase e marr me mend se Agimi e ka të vështirë ta kuptoj lehtë idenë time, i them: Puna është te njohja e vetvetes. Ajo njohje është e mundur vetëm nëse arrin ta kuptosh të vërtetën absolute se, bota në të cilën jeton dhe gjithçka që ekziston, është vepër e një Krijuesi të vetëm dhe se ka një harmoni dhe përsosuri të plotë. Edhe ti je pjesë e asaj vepre të përsosur të Zotit, dhe ke ardhur në këtë botë për të kryer një mision adhurimi dhe sprovimi. Lidhja jote me adhurim dhe obligim ndaj Tij, është kuptimi më i thellë i jetës që të është dhënë. Për gjithçka që të ndodh duhet ta

kuptosh se ajo ka të bëjë me ty në mënyrë shkakore, për arsye se ti je adresë, je vetvetja e regjistruar si e tillë në librin e madh të Krijuesit të botëve. Nëse e kupton se je vetvetja dhe se je në mëshirën e Krijuesit tënd, atëherë të hapen të katër anët e horizontit, nuk je vetëm, po je një zë i ëmbël në simfoninë e përsosur të gjithësisë...

Agimi më shikon i hutuar, fik cigaren në taketuke, e nxjerr tjetrën dhe e mban në dorë. Shikimi i është i mjegullt, si xhami kur hukatet.

- Nuk më duket se mund të shpjegohet kështu koha moderne që e jetojmë. Ky është më shumë një meditim poetiko-filozofik. Ndoshta më shumë një frymëzim fetar.

- Jo Agim. Është një rrugë për ta njohur dhe për ta kuptuar vetveten, e për ta drejtuar në rrugë të vërtetë. A nuk e the vetë se paratë dhe sendet janë gjithçka.

- Deshe-s'deshe, ashtu është.

- A nuk është absurde që paratë dhe sendet të kenë vlera më të larta se mendimi, se morali, se idetë?

- Por, ato nuk hahen! - qesh hidhët Agimi.

- Hahen, hahen. Shpirti ushqehet me to. Nëse shpirti nuk e ka ushqimin e vet, atëherë lindin çrregullimet brenda tij dhe pastaj rrënohet edhe trupi, megjithë të hollat dhe sendet përreth.

- Nuk di, vëlla.

- Agim, tërë jetën më përsëritet pamja ime në xhamin e odës, nga mosha trevjeçare. Ka qenë një vetmi e plotë dhe një mosnjohje e plotë e vetes që është bartur nëpër vite. Shumë më vonë e kam

kuptuar se për ta arritur njësimin e vetes, duhet vetëm një veprim i përhershëm dhe i përjetshëm: adhurimi ndaj Krijuesit. Mirëpo, bota që na rrethon është e dyzuar: në njërën anë është prirja e brendshme për ruajtjen e njësimit të vetes, ndërsa në anën tjetër është ambicia pas gjërave konkrete, që të largon vazhdimisht nga prirja themelore e shpirtit. Ndarja shndërrohet në mosnjohje të vetes, në një rrugë plot me mëkate dhe me rreziqe. Vetmia është vetëm njëra nga format e dukshme të kësaj ndarjeje dhe të këtij mjerimi shpirtëror.

Agimi më lë përshtypjen e njeriut të lodhur nga kjo bisedë. E ndjej se ka një nevojë të brendshme që të vetërrëfehet, që të shpalosë vetminë e tij, edhe pse e di se nuk është as afër që ta gjejë shkakun e saj.

- Ja ciniku!

- Aspak! Vetmia e Agimit është pasojë e mosnjohjes që ai ka për veten.

- Si nuk e njeh veten kur tërë kohën po të thotë se është i vetëdijshëm për këtë e për atë?!

- Ato janë fjalë të kota. Nuk mund ta njohësh veten, pa u përkulur para urdhërit të Krijuesit tënd.

- Vetmia është konkrete, zotëri.

- Është vetëndëshkim dhe kurrgjë tjetër. Një rrugë e gabueshme të nxjerrë në një vend të gabueshëm. Njeriu është vetë fajtor për të këqijat që e gjejnë në jetë.

- Vetë fajtor?! Kjo është tepër cinike!

- Aspak. Kjo është tepër e vërtetë. Po t'u përmbaheshim udhëzimeve të Krijuesit tonë, nuk do të na gjente asnjë e keqe, as në këtë botë dhe as në

botën tjetër. Do të arrinim të kuptonim plotësisht vetveten dhe të tjerët, do të arrinim kulmet e lumturisë njerëzore në këtë botë dhe do të fitonim shpërblim në botën e përjetshme.

- Poezia e Bukovskit e shpreh atë tjetërsim dhe atë vetmi të pafundme, e cila të kapë për fyti dhe shtrëngohet si një litar i lagur, duke ta vështirësuar frymëmarrjen, edhe kur është ajri krejt i pastër, si në mëngjes kur kthehesh nga turni i tretë. Tematizimi aq ekstrem i seksit, po ashtu është shpalosje e tjetërsimit dhe e vetmisë ekstreme të njeriut - flet e flet Agimi. Më duket gjithnjë e më i lodhur nga rrëfimi i tij për vetminë. Dhe më vjen keq që ai gjithnjë e më shumë do të jetë i dërrmuar nga mosnjohja e vetes, nga mosnjohja e shkakut të vetmisë së tij. Pastaj Agimi shkon në punën e tij. Jam i bindur se sapo e kalon pragun e zyrës, ai sërish është në thonjtë e vetmisë, i hutuar dhe i frikësuar tejmase.

# Ikje

Pas një ore, në zyrë më vjen Agimi, një bashkë-fshatari im, më i ri se unë me moshë, po me të cilin nganjëherë shkëmbejmë takime. Ende pa u ulur mirë, Agimi fillon të ankohet se në fshat po e ha vetmia.

- Dal e shtëtis vetëm nga shtëpia e deri te Shegëza dhe gati kurrë nuk e takoj një njeri me të cilin mund të ndërroj dy fjalë. Fshati është shkretëruar aq shumë sa të mos e besosh, burrë. Breznia është shndërruar në simbol të vetmisë, o burrë! Banori më besnik ka mbetur Husa i Alimit, i cili përditë i nxjerrë te Kodra e Arës lopët e tij. Është një vetmi që po më han, o burrë. Sot dola pak në qytet e u ktheva të të shoh.

Agimi flet e flet, ndërsa mua më shfaqet e qartë dhe e kthjellët një fotografi me një pamje qielli të kaltër, një pasdite verore te Ledina e Kurtit. Retë lëvizin ngadalë, sa më duket se druajnë dhe u merren mendtë nga lartësia.

- Pse shikojnë retë me aq habi?

- A kanë qenë edhe para dyzet vjetësh të njëjtat re atje lart, apo kanë mbirë vetëm sot në sytë e mi?

- Çka janë retë?

- Pse hesht Ledina e Kurtit?

- Pse qesh Nora, kur nuk kuptoj kurrgjë?

- Çka është kuptimi?

Pas një heshtjeje të gjatë, e cila mbulohet nga pyetjet e shumta si një udhë parku nga gjethet e vjeshtës, me një zë të pavendosur, jo se nuk jam i bindur për mendimin tim, po ngase e marr me mend se Agimi e ka të vështirë ta kuptoj lehtë idenë time, i them: Puna është te njohja e vetvetes. Dhe, përsëris shumicën e fjalëve që ia thashë më herët Agimit tjetër, mikut tim të kohës së studimeve. Agimi më shikon hutueshëm, lëviz në karrige, heq pallton dhe shikon shpesh nga dritarja. Më shkon mendja se është penduar që ka ardhur tek unë. Ai ka pritur që unë ta ngushëlloj, ndërsa unë e akuzoj! Por, nuk flet asgjë.

Pamja e dikurshme e reve mbi kokën time, në moshën katërvjeçare, nuk më hiqet nga mendja për një kohë të gjatë, edhe derisa flas. Më bëhet se edhe atëherë e kam ditur se çka janë retë, kush i ka krijuar dhe për çka i ka krijuar. Me gjasë, mandej e kam harruar për një kohë dhe jam ngatërruar pas hamendjeve të mjegullta.

- Thuaj ç'të duash, por fshati po braktiset përditë nga të rinjtë. Do të ngelin vetëm pleqtë, plakat dhe varrezat e fshatit.

- Ku shkojnë ata njerëz?

- Ku?! Ku nuk shkojnë thuaj! Në të katër anët e dynjasë. Vetëm në vendin e vet nuk duan të rrinë, burrë.

- I njëjti qiell është kudo. Të njëjtat re...

- Urdhëro?

- Asgjë, asgjë. Thashë se ngado që të shkojnë nuk kanë ku të fshehen nga vetvetja. Prandaj, nuk kanë pse të ikin ashtu si pa kokë.

- Nuk e di, burrë.

- E di unë. Do të na gjejë një hata e madhe. Kjo është puna. Jam i bindur se do të na vijë një ndëshkim i rëndë.

- Nga kush?

- Si nga kush? Nga vetvetja. Njeriu i bën dëm vetvetes.

Agimi ngrihet, më jep dorën dhe del me një hap disi të rëndë. Edhe pse është disa vjet më i ri se unë, ai është plakur shumë këto vite. Më duket se vetmia që vërshëllen hapësirave të vendlindjes ku ai jeton, ia ka zbardhur flokët dhe ia ka shtuar rrudhat në fytyrë. Dhe më e keqja, duket t'ia ketë humbur shpresën, e bashkë me të edhe fuqinë që i duhet njeriut për të çuar ndershmërisht deri në fund jetën e dhënë dhuratë nga Sunduesi i Botëve.

# XV

E mbylla fletoren dhe i tregova Naserit shkurtimisht përmbajtjen.

- Duket se është fjala për një njeri të ditur. Këto tema nuk mund t'i trajtojë gjithësecili - tha Naseri i menduar.

- Ashtu më duket edhe mua. Po është e vështirë të dihet se çfarë stuhie e ka sjellë në atë fshat, larg kryeqytetit, ku zakonisht jetojnë shkrimtarët e njohur.

- A ka shkrimtar të vrarë në këtë luftë? - pyeti Naseri.

- Janë disa, megjithëse ende nuk dihet plotësisht.

- Humbje e madhe!

- Në jetën e kombit tonë disa shkrimtarë kanë bërë punë të mira, ndërsa disa të tjerë kanë luajtur role të mbrapshta.

- Keni një histori të çuditshme dhe mjaft të ngatërruar!- tha Naseri.

- Ndoshta nga shkaku që jetojmë në një udhëkryq të qytetërimeve e të besimeve. Duke qenë nën trysni nga shumë anë, na ka ndodhur të përplasemi andej-këndej e ta humbim ekuilibrin. Pastaj kanë pasuar ndëshkimet për gabimet e bëra. Kështu kemi qenë të përfshirë në shtjellën ngulfatëse të historisë deri në ditën e sotit. Ishalla tash e tutje e kuptojmë misionin tonë të vërtetë dhe kthehemi në identitet, aty ku mund ta marrim fuqinë që të

jetojmë të lirë e me nder. Dhe, me zë të qetë, i cili po më buronte nga thellësia e shpirtit, këndova: La ilahe il allah Muhammedun resul-lullah.

Prishtinë, mars 2002

# Shënime për autorin

I. Shkollimi:

Milazim Krasniqi u lind më 25 tetor 1955 në Breznicë, një lokalitet afër Prishtinës.
Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë.
Studimet për letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës, ku magjistroi në vitin 1988, me temën "Struktura e vargut të Ndre Mjedjes". Po në Universitetin e Prishtinës ka fituar gradën e doktorit të shkencave filologjike me tezën e disertacionit "Soneti në poezinë shqipe" më 15 shtator 2004.

II. Botimet:

## Poezi

1982 - *Imazhi gri*
1885 - *Pirg vegimi*
1987 - *Qeshje sardonike*
1990 - *Formula e Katonit*
1994 - *Kurs për pantomimë*
1996 - *Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat*
2005- Lulja e shpëtimit, poezi e zgjedhur

## Prozë (romane)

1998 - *Fijet e shpirtit*
2002 - *Fotografitë e kujtimeve*

## Dramaturgji

1990 - *Zbulimi,*
*Mos më merrni në qafë,*
*Punë Sizifi*
1996 - *Kur lindi partia*
1997 - *Kush i bie fyellit*
2001 - *Bryma e vdekjes,*
*Kosovë në ndërgjegje*
2003 - *Monedha e Gentit*
2004 - *Rulet rus për Ali Pashën*

2004 1999 Tragjedi shqiptare (trilogji)

- *Bryma e vdekjes( botim i dytë)*
- *Një Antigonë e re*
- *Kësulkuqja e shekujve*

## Publicistikë

1998 - *Horrat në krye të detyrës*
2000 - *Kosova pas 22 janarit 1998*

**Studime**
2005 Soneti në poezinë shqipe

III. Angazhimi profesional dhe publik

1975-1980: Teknik medicinal në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë,
1981-1986: Përkthyes po në këtë klinikë,
1987-1990: Redaktor i revistës për kulturë "Fjala",
1988-1999: Sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës,
1990-1995: Kryeredaktor i revistës "Fjala",
1995-1999: Redaktor përgjegjës për Kosovë i gazetës ditore "Bota Sot", 1999-2000:

Kolumnist i gazetës “Kosova Sot” dhe “Gazeta e Re”,
2001: Kryeredaktor i revistës “Interesi Nacional”,
2001-2005: Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës dhe analist te Radio Europa e Lirë,
2003-2005: Bashkëpunëtor për lëndën Sociologjia e letërsisë dhe Publicistika letrare në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë,
2005: Bashkëpunëtor për lëndën Dramatologjia në Fakultetin e Arteve në Prishtinë

Në vitet 1989-2001 ka qenë i angazhuar edhe në politikë, por nga marsi i atij viti është tërhequr tërësisht nga jeta politike.

Jeton në Prishtinë.